

1 E martë, 5 shtator 2023

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 [I akuzuari Krasniqi paraqitet përmes
5 videolidhjes]

6 -- Seanca fillon në orën 09.00

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

8 Sekretare, paraqisni lëndën.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi, të
10 nderuar Gjykatës, kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori
11 i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
12 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vërej se të
14 akuzuarit janë të gjithë të pranishëm në sallën e gjyqit, me
15 përjashtim të z. Krasniqi, që na ndjek përmes videolidhjes.

16 Përpara se të vazhdojmë me dëshminë e dëshmitarit të
17 Prokurorisë, 4018, Trupi Gjykses dëshiron që të trajtojë një
18 çështje.

19 Dje, ZPS-ja depozitoi parashtrimin e protokolluar F01759,
20 që është një kërkesë për konferencë me anë të videos për të
21 dhënë dëshmi për dëshmitarin 03827. Me sa e kupton Trupi
22 Gjykses, ZPS-ja synon që të thërrasë dëshmitarin 3827 javën që
23 vjen. Megjithatë Trupi Gjykses dëshiron që t'i kërkojë
24 Prokurorisë sqarime lidhur me rendin e paraqitjes së
25 dëshmitarëve në sallën e gjyqit.

1 Z. PACE: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës. Ka disa
2 ndryshime të vogla për shkak të ndryshimit të situatës.
3 Gjithsesi do t'ju bëjmë me dije Trupit Gjykues në qoftë se do
4 ketë ndryshime sa i takon rendit të paraqitjes së dëshmitarëve
5 në sallën e gjyqit.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbrojtja e
7 Dëshmitarëve [sipas përkthimit] ka diçka për të shtuar?

8 Z. LAWS: [Përkthim] Asgjë.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë gjë
10 nga Mbrojtja e të akuzuarve?

11 Z. KEHOE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, me thënë të
12 drejtën do e shoh -- nuk është se e kam parë këtë parashtrim
13 të protokolluar të ZPS-së, do ta shikojmë gjatë pushimit dhe
14 do ju themi mendimin tonë.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Emmerson.

16 Z. EMMERSON: [Përkthim] Nuk kam asgjë për të shtuar,
17 përveç asaj çfarë tha Mbrojtja e mëparshme.

18 Z. TULLY: [Përkthim] Do e shoh dhe unë dokumentin gjatë
19 pushimit dhe më pas do t'ju them në qoftë se kemi ndonjë gjë
20 nga ana jonë.

21 Z. ELLIS: [Nuk ka përkthim]

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutemi
23 përpiquni që të përgatiteni për komentet pasi të bëjmë
24 pushimin e radhës.

25 Znj. Sekretare, ju lutem tani mund të sillni dëshmitarin

1 4018 në sallën e gjyqit.

2 Më lejoni t'ju kujtoj të gjithëve që nuk ka masa
3 mbrojtëse në gjykatë për dëshmitarin dhe do të jemi gjatë
4 gjithë kohës në seancë të hapur.

5 [Dëshmitari vijon dëshminë]

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes,
7 dëshmitar. Mund të uleni.

8 DËSHMITARI: Mirëmëngjesi.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
10 sot do të vazhdojmë me pyetjet tuaja nga ZPS-ja. Do të doja
11 t'ju kujtoja që të mundoheni që të jepni përgjigje pyetjeve
12 qartë me fjali të shkurtra. Nëse nuk e kuptoni një pyetje,
13 lirisht mund t'i kërkonit Prokurorit që nuk e kuptuat pyetjen
14 dhe ata do të mundohen që të sqarojnë më tej pyetjen.

15 Po ashtu, ju lutem mbani mend që duhet të thoni se cila
16 është baza e njohurive dhe fakteve mbështetur te të cilat do
17 të jepni dëshmi përpara Trupit Gjykses.

18 Ju kujtoj se jeni nën detyrimin për të treguar të
19 vërtetën siç u deklarua prej jush në deklaratën solemne.

20 Po ashtu, mbani mend se duhet të flisni pranë mikrofonit,
21 duhet të prisni pesë sekonda përpara se të jepni përgjigje një
22 pyetjeje, dhe të flisni ngadalë në mënyrë të tillë që t'i
23 jepni kohën e nevojshme përkthyesve.

24 Nëse keni nevojë të bëni ndonjë pushim, lirisht mund të
25 na thoni dhe do të bëjmë organizimet e nevojshme.

1 Së fundi, në qoftë se ju kërkoj që të mos flisni,
2 përfundoni së foluri, ose në qoftë se e shikoni që ngre dorën,
3 mos flisni më, sepse kjo do të thotë që mua më duhet t'ju jap
4 udhëzime të tjera.

5 Z. Pace, mund të vazhdoni më tej.

6 DËSHMITARI: W04018 [Vijon]

7 Pyetje nga z. Pace [Vazhdim]

8 Z. PACE: [Përkthim]

9 PY. Mirëmëngjes, dëshmitar.

10 PË. Mirëmëngjes.

11 PY. Më lejoni t'ju kujtoj që dje pasdite Trupi Gjykses pranoi
12 në dëshmi deklaratat e mëhershme dhe lexova një pjesë të
13 përmbledhjes time të deklaratave tuaja. Sot, do të bëj disa
14 pyetje shumë të përqendruara dhe të shkurtra. Nuk është se do
15 t'ju pyes në detaje për gjithçka që keni dhënë në dëshmitë
16 tuaja.

17 Z. PACE: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares që të
18 paraqesë në ekran një dokument që është SPOE00093211 deri në
19 00093212. Dëshiroj që ky dokument të paraqitet përbri
20 përkthimit në anglishte që e ka të njëjtin numër ERN. Do ta
21 them edhe një herë, SPOE00093211 deri në 00093212-ET. Dua që
22 të paraqitet faqja e parë e të dy dokumenteve, ju lutem.
23 Faleminderit.

24 PY. Dëshmitar, a shihni dy dokumente përpara në ekran?

25 PË. Po.

1 PY. Dokumenti në të majtë është në serbisht, ndërsa dokumenti
2 në të djathtë është në anglisht. A mund t'i tregoni Trupit
3 Gjykues në qoftë se e kupton dhe e lexon serbishten?

4 PË. Jo, serbishten s'di me lexu.

5 PY. Kur jua kam treguar këto dokumente javën që shkoi --
6 megjithatë dua t'ju pyes, përpara se jua tregova unë këto
7 dokumente, a i kishit parë ju këto dokumente? Atëherë,
8 dëshmitar, edhe një herë a i ke parë ndonjëherë më përpara
9 këto dokumente?

10 PË. Po, po, po.

11 PY. Para se sa t'jua tregoja unë, domethënë, javën që shkoi?

12 PË. Po, po.

13 PY. A e mban mend që e ke parë javën që shkoi, kështu?

14 PË. Po, po.

15 PY. Por përpara javës që shkoi nuk e ke parë, kështu?

16 PË. Jo.

17 PY. Në fillim të dokumentit shohim që ky është një dokument i
18 cili është hartuar nga autoritetet serbe, datën e ka 29
19 dhjetor 1998. Në këtë dokument jepet një listë emrash të cilët
20 janë regjistruar për sigurinë lokale të komunës së Kaçanikut.
21 Dëshmitar, a e dini ju çfarë nënkupton siguria krahinore, ose
22 lokale, në këtë kontekst?

23 PË. Krahinore, s'e marr vesh çka është.

24 PY. Ky dokument e ka titullin "Lista e personave të
25 regjistruar për sigurinë lokale [ose vendore] të komunës së

1 Kaçanikut". A e dini se për çfarë e ka fjalën autori kur ka
2 thënë "siguri lokale" ose vendore. Në qoftë se nuk e di, mund
3 të thuash që nuk e di.

4 PË. S'jam bash i sigurt, veç nëse është qeshtu. Këto kishin
5 pas punu policë lokale, a çka është kjo. Paska emra shumë
6 këtu.

7 PY. Në 1999 apo në 1988 [sipas përkthimit], a e ke dëgjuar
8 ndonjëherë shprehjen "siguria vendore" ose "policia vendore"
9 në Kosovë?

10 PË. Jo, me këtë gjuhën s'jam mirë. Veç muj me ju rrej, se
11 s'kam pas ide me këto kurrë.

12 PY. Nëse do shohim pikën 13 sikurse e thamë edhe më përpara
13 në të majtë është dokumenti në serbisht, ndërkohë që në të
14 djathtë është dokument në anglisht. Numri 13 është Idrizi dhe
15 Agim, Idrizi është mbiemri, Agim është emri.

16 PË. Po.

17 PY. Dhe vendi është Llanishtë. Ti na the dje që jeni nga
18 Llanishta.

19 PË. Po.

20 PY. A e shikoni emrin, mbiemrin dhe vendin tuaj, dëshmitar?

21 PË. Po.

22 PY. Pyetja ime është kjo: A je regjistruar ti ndonjëherë për
23 sigurinë vendore të komunës së Kaçanikut?

24 PË. Jo, emri im kurrë nuk është i regjistruar kurrkund hiç.

25 Ka mundë që jena regjistru si fëmijë, e di që jena regjistru

1 aty, krejt populli është atje i regjistruar. Apo gjana të
2 tjera, punë e sende, kurrë s'jam regjistruar. Si fëmijë po, që
3 jena regjistruar aty në komunë.

4 PY. Tani, duke e lënë mënjanë idenë e regjistrimit për një
5 çast. A jeni kyçur ti ndonjëherë në sigurinë vendore përkrah
6 organeve ose institucioneve serbe siç pretendohet prej këtij
7 dokumenti që keni përpara në ekran?

8 PË. Jo, kurrënjëherë. Emri im nuk shkruan kurrë hiç.

9 PY. Dëshmitar, në qoftë se do shikojmë listën e emrave, do të
10 vërejmë që këtu përfshihen shumë persona të tjerë që gjatë
11 dëshmisë tuaj në çështje të mëparshme gjyqësore ju keni thënë
12 që kanë qenë të ndaluar me ju. Për shembull numrin 16, kemi
13 Rrahim Elezin, në numrin 20 kemi Nezir Topojanin, dhe pastaj
14 në fund me numrin 25 kemi Riza Kikin.

15 Pyetja që kam për ju dëshmitar është kjo: A e keni idenë
16 se pse emrat e këtyre personave do të ishin në një listë, pra,
17 janë në një listë të policisë serbe në vitin 1998? Si ka
18 mundësi që këto emra janë në një listë të policisë serbe?

19 PË. Unë jam kanë i burgosur. Me këta ku kanë ndejtë, e ku kanë
20 hy, ku kanë dalë, a kanë mbajtur mbledhje a janë kanë policë, a
21 çka janë kanë, unë s'kam kurrë njëfarë lidhje me këta. Veç i
22 burgosur që jam kanë, në 1999.

23 Z. PACE: [Përkthim] Znj. Sekretare, ju lutem na kaloni në
24 faqen tjetër të të dy dokumenteve.

25 PY. Dëshmitar, a shihni dy faqe të ndryshme në ekranin që

1 keni përpara tani?

2 PË. Po.

3 PY. Kjo është fleta e dytë e të njëjtit dokument. Në fund
4 mund të shohim që dokumenti është nënshkruar nga Radoslav
5 Ognjenovic, kryetar i këshillit të komunës. Dëshmitar, në
6 dëshmitë e mëhershme, keni dëshmuar që e njihni që një Rade
7 Organjovic [sipas përkthimit] ka qenë kryetar i këshillit të
8 komunës. Atë e keni diskutuar dhe e keni përmendur edhe në
9 pjesë të tjera të deklaratës.

10 Pyetja që kam për juve është kjo: A keni diskutuar
11 ndonjëherë me Radislavin ndonjë gjë që ka të bëjë me të
12 punuarin për organet apo institucionet serbe në vitin 1998 apo
13 në 1999?

14 PË. Po këta krejt kanë qenë, kanë pasë biseda me ta, nuk
15 është kanë njeri i keq, unë s'po them është kanë i keq. Se
16 është kanë për krejt i mirë. Ai sidomos për muajin e Ramazanit
17 kurrë policisë s'i ka lanë me dalë natën me këqyrë çka janë tu
18 bo. Kanë luftë, kanë kërcitë gjithë natën, veç komuna e
19 Kaçanikut. Kështu është kanë. A biseda, kush është, nga është,
20 kurrëkujna me gisht s'ia kam bo. Le të del dikush të kallëzojë
21 që e kam mshelë në burg ose ia kam lajmëru një armë, ose e kam
22 lajmëru diçka. Nji njeri të del dhe veç të folë, lirisht, që
23 ia kam bo nji të keqe.

24 PY. Do ta trajtojmë këtë pas një çasti, dëshmitar. Por tani
25 dëshiroj që të përqendrohemi tek pyetja që ju bëra. Pyetja

1 është kjo: A ke folur ndonjëherë me Radon, apo Radoslav
2 Ognjenovic për juve, për t'u kyçur me forcat serbe që mund të
3 ishin policia serbe, siguria serbe? A ke bisedu ndonjëherë me
4 këtë Radon lidhur me këtë gjë?
5 PË. Jo, këto veç mujna me folë se kurrë në jetë time nuk kam
6 folë për njerëzish, kush është, nga është. Ai është gjallë, le
7 të del të kallëzojë. S'më kanë interesu mu këto gjajna, se unë
8 i kam ditë ma mirë se krejt.
9 PY. Për të qenë të qartë, a është e saktë që ju për shembull
10 asnjëherë nuk keni dhënë pëlqimin tuaj për t'u regjistruar apo
11 çregjistruar në ndonjë polici ose siguri vendore dhe për t'u
12 kyçur apo për të qenë me institucionet serbe në vitet 1998 dhe
13 1999?
14 PË. E thashë dhe kam me e thanë gjithmonë: Unë nëse dikush
15 mundet me gjetë emrin tim që kam punu polic, qysh po ndij këtu
16 në dokumente shkrujt, se unë s'e kam ditë deri tash, ai është
17 hasmi jem ma i madhi që e ka shkru emrin tem. Ka thanë Agim
18 Idrizi është polic, edhe është roje pylli. Këto nuk janë të
19 vërteta. Mundeni me vetë në Kaçanik atje, ata i dinë ma mirë.
20 PY. Ju thatë që keni qenë roje pylli dhe që kjo është
21 tërësisht jo e vërtetë. A mund ta sqaroni, a ke qenë apo jo
22 roje pylli? Është e vërtetë kjo apo jo?
23 PË. Nëse jam kanë roje pylli, besën e shqiptarit po ia jap që
24 kam me dalë me u vjerrë para gjyqit. Veç nëse s'jam kush ka me
25 dhanë përgjigje me ma pagu mu jetën krejt? Se unë s'jam kanë

1 roje pylli, as polic. Tani familja ma ka bo mu këtë të keqe në
2 luftë. Por njerëzit nuk e dijnë. Po qe tash e dinë se ju kam
3 kallëzu krejt. Para se me ardhë këtë, e kam kallëzu. Edhe ata
4 janë befasu kur kanë ndi, ata me mund më kishin pa roje pylli
5 tuj rujtë, edhe polic. Kjo është gënjeshtër. Unë e di për çka
6 më kanë shti në listë edhe kush më ka shti në listë.

7 PY. Dëshmitar, a mund t'ju shpjegosh Gjykatësve se në vitin
8 1998 apo 1999, mund të të krijonte probleme ose mund të ishte
9 problematike fakti që dikush mund të ishte roje pylli? Pse
10 ishte kështu?

11 PË. Po ato i dinë kush është kanë roje pylli, unë jam kanë
12 dëmtuesi i maleve. Q'atë punë e kam prej 30 vjet. Sa
13 interesant.

14 PY. A po ju kuptoj drejt që po doni ta bëni të qartë që nuk
15 ke qenë roje pylli? Këtë po mundoheni të thoni?

16 PË. Jo, besën po jua jap qetu edhe atje janë tu ngu krejt
17 Kaçaniku, le të kallëzojnë le të çojnë mesazhe këtu direkt.
18 Nëse jam kanë unë shumari i pyllit, qysh i thojnë, roje e
19 pyllit. Nuk vend -- kurrë s'është kjo, këtë ma ka ba ai hasmi,
20 Enver Axhami me Habib Kokën. E di unë krejt qysh kanë ardhë te
21 [E pakuptueshme].

22 PY. Dëshmitar, në qoftë se dikush do ishte si puna jote që
23 ishte një shqiptar i Kosovës që jetonit në Kosovë në vitin
24 1998 dhe 1999, dhe në qoftë se dikush do thoshte që unë jam
25 pylltar, ose شمار, a mund t'i shpjegoni Trupit Gjykues se

1 pse ishte gjë e keqe kjo?

2 PË. Unë s'jam mirë dhe me kësi gjana, po këtë ma kanë shti
3 emrin atje se ai Habib Koka ka punu te policia serbe, deri që
4 atë ditë më kanë kidnapu mue, ai ka ikë. Edhe ka shti emrin
5 tem atje dhe q'atë ka mbetë atje. E di Kaçaniku që unë s'jam
6 kanë شمار. Edhe fëmijët me shku me vetë të kallëzojnë. As
7 polic, as شمار. Qysh po thojnë, harrova...

8 PY. Dëshmitar, ju lutem përqendrohuni te pyetja që po ju
9 bëjmë. Ju lutemi përqendrohuni te kjo që po ju pyes. Nëse
10 dikush ishte shqiptar në 1998 dhe 1999 në Kosovë dhe në qoftë
11 se ky person ishte شمار, të ishe شمار në atë kohë në
12 Kosovë, ishte gjë e mirë apo gjë e keqe?

13 PË. Po s'kam hy شمار more, kurrë s'kam hy. Ku e di unë çka
14 është ai شمار? Çka ka ba ai شمار?

15 PY. Do të vazhdojmë më tej.

16 Z. PACE: [Përkthim] Sekretare ju lutem, hiqeni këtë
17 dokument nga ekрани dhe në vend të këtyre dokumenteve do të
18 paraqesim në ekran dokumentin IT-05-87 6D00484-E dhe të
19 paraqitet gjithashtu dhe versioni në gjuhën tjetër IT-05-87
20 6D00484. Ju lutem faqen e parë të të dy dokumenteve.

21 PY. Dëshmitar, a shihni dy dokumente të ndryshme në ekranin
22 përpara?

23 PË. Po.

24 PY. A ju kujtohet që jua kam tregu këto dy dokumente javën që
25 shkoi?

1 PË. Po, po.

2 PY. Përpara se ju tregova këto dokumente, një javë përpara, a
3 i kishe parë ti më herët?

4 PË. Jo, këto s'i kam pa. Tash jam i gëzumë kur kam ardhë këtu
5 m'i keni lexu. Jam befasu, kanë shkru polic, شمار. Një Arkan
6 e përmendin shumë përmbi tokë. Qe kaq.

7 PY. Dëshmitar, dokumentet janë në serbishte dhe në anglisht.
8 Kështu që do ju them se çfarë thuhet në fund të faqes.
9 Dokumenti thotë që lidhet me një dokument të autoriteteve
10 serbe, mban datën 2 nëntor 1998, dhe përfshin një listë të
11 personave që kanë shkruar një kontratë për sigurinë vendore të
12 komunës së Kaçanikut.

13 Nëse do të shikojmë dokumentin, do vëmë re dhe një herë
14 persona të tjerë të cilët në një çështje të mëparshme
15 gjyqësore ju keni dhënë dëshmi që kanë qenë të ndaluar, të
16 arrestuar, bashkë me juve. Për shembull te numri 11 shikojmë
17 Riza Faik Kiki.

18 Dëshmitar, a e ke ndonjë ide se pse është shkruar emri i
19 Riza Kikit në këtë dokument?

20 PË. Unë kam qenë i burgostë me Riza Kikin dhe Faik Reçin, e
21 Rahim Elezin, një Nazif Topojani më kujtohet. Unë i kam pyetë
22 këta për çka ju kanë ndalu UÇK-ja. Rizai më ka thanë që "E kam
23 pasë një allti që kam bo roje te fabrikë e qiriçit në
24 Kaçanik". Edhe një ia kishte dhanë një komander që e kanë vra
25 në fshatin Gajre, e kish pasë bile një lopë prej një

1 shqiptari, 1000 euro, edhe ky i pat thanë, a i ki nji 1000
2 euro me m'i dhanë t'ia jap atij, për lopën që e ka ble. Tani
3 ia paska dhanë paret Rizai këtij komanderit edhe ia pat dhanë
4 atij allti, dy i pat [E pakuptueshme]. Qe kaq s'di qe ato
5 send.

6 PY. Çfarë kombësie kishte ky komandanti që sapo përmendët?

7 PË. Komandanti serb është kanë, Kaçanik, komander.

8 PY. Ky komandanti serb, e kishte blerë lopën nga Riza Kiki
9 apo nga dikush tjetër?

10 PË. Jo, nga dikush tjetër. Por paret ia kanë [E pakuptueshme]
11 prej Rizait.

12 PY. Kujt ia dha alltinë komandanti?

13 PË. Po Rizait ia kish dhanë.

14 PY. A e dini se pse kjo ishte problem, pra që Rizai kishte
15 një allti që i ishte dhënë nga një komandant serb? Pse ishte
16 problem kjo?

17 PË. Jo, unë nuk e di, veç më ka kallzu kështu, qeshtu jam tu
18 ju thanë edhe s'di tjetërsend për të.

19 Z. PACE: [Përkthim] Znj. Sekretare, na kaloni tek faqja e
20 dytë e këtyre dy dokumenteve.

21 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit, znj. Sekretare.

22 PY. A shikoni dy dokumente të ndryshme në ekranin përpara,
23 dëshmitar?

24 PË. Po.

25 PY. Në fillim të kësaj faqeje, shohim që kjo pretendohet që

1 të jetë një dokument i Sekretariatit të Brendshëm në --- dhe
2 kemi një listë të personave të cilët janë regjistruar për
3 sigurinë vendore në komunën e Kaçanikut dhe nuk kanë armë.
4 Data është 26 janar 1999.

5 Nëse do shohësh numrin 7 në këtë listë, emri që shkruhet
6 këtu është Agim Idrizi nga fshati Llanishtë. Sikurse ju pyeta
7 dhe për dokumentet e tjera, pyetja që kam tani është a e keni
8 një ide, apo keni ndonjë informacion se pse emri juaj është
9 pjesë e kësaj liste?

10 PË. Qe unë të kallëzoj tash për çka është. Ne kena kanë në
11 bela për një tokë, me Enver Axhamin, familjen Axhami. Këto
12 natën i kanë çu Habib Kokës, ia kanë mbush dubekin me mish, ia
13 kanë ble një Niva të kuqe, edhe të nesërit kena pasë me u taku
14 me Habib Kokën edhe Qazim Idrizin në kafe te Ismail Çormi me
15 pi çaj me kallëzu a po i çon paret a s'po i çon paret. Se
16 Enver Axhami i ka hy natën, ia ka flugë me dhunë Qazimit paret
17 edhe kanë ikë. E din Kaçaniku krejt dy vetë të parët
18 [fonetakisht] si kanë marrë Enver Axhamin. Prandaj unë i kam
19 shku te shtëpia me ia bajtë do dru me [E pakuptueshme] e Habib
20 Kokës, edhe atëherë jena kanë mirë me Habib Kokën. Edhe kur
21 kam shku atje kish dalë t'i lypë lopët ai, se ia kishin vjedhë
22 lopët. Në atë kohë vjedhshin shumë lopë. Edhe unë ma kanë
23 vjedhë lopën e mëzatin, por s'i kam çu në milici, këtë
24 familjen Axhami. E kam lanë. Edhe unë ia kam zanë mishin, ia
25 kam zanë Niva-n e kuqe, [E pakuptueshme] tha pse po i bi

1 llafin djalit edhe unë i thashë "E di që janë kanë familje
2 Axhami mbramë këtu?" Kanë hy atje në katër në sabah. E si ia
3 kam zanë qetë mishin edhe qetë Niva-n Habib Kokës, Sami Koka,
4 veç keq ka këqyrë me më ba mue. Mue m'i kanë lëshu sanksionet,
5 e dinë edhe Kaçaniku. Katër [E pakuptueshme] i kam për
6 pushkatim nga policia serbe që e kam pre malin. Habib Kokës,
7 Kemal Doganit, edhe ky i kësaj familjes Axhami. Këta edhe
8 atëherë kanë dashtë me më pushkatu. Po ata s'kanë pasë
9 argumente. E tash e gjetën si luftë, e ka shti Habib Koka në
10 listë emrin tim, ia ka dhanë Enver Axhamit. Enver Axhami e ka
11 çu në shtab, i ka thanë "Agimi është qeshtu e qeshtu" edhe ata
12 kanë thanë Habibi po i dika gjanat.

13 Tashti, këto shkojnë kush është kanë komandant në
14 Kaçanik, le të shkojë të merret me Habib Kokën edhe me
15 familjen Axhami. Sami Axhami ka thanë Agim Idrizi ka lypë
16 automat, më ka rrehë me një milic bashkë. Por unë e kam zanë
17 Sami Axhamin, se kam [E pakuptueshme] në Kaçanik mbas lufte
18 para se me dalë në gjyq. Jam shëtitë poshtë nalt. Kurrkush
19 s'më ka sha, përveç kjo familja Axhami. Edhe kam ndejtë në
20 Kaçanik por s'më ka shajt kurrkush. Këto janë shkaktarë që unë
21 sot jam qetu. Për qete kam ardhë qetu. Me ditë populli krejt
22 mos me ia ba me gisht jo polic, jo spiun, jo drej. Më kanë
23 qitë në mal më kanë qitë. Ma kanë rraskapitë jetën. Paret m'i
24 kanë marrë, 37 000 marka. Kush e pagun jetën teme këtu. Më
25 kishin [E pakuptueshme], je polic, je shumtar. Krejt kanë me

1 dhanë përgjigje. Se janë të shkrumë ata aty kush ka punu
2 polic, kush ka punu në atë ekonominë e pyllit, çka thojnë
3 ashtu.

4 Unë kurrë s'jam kanë në punë të shtetit, s'kam punu.
5 Gjithë në të zezë e kam punu jetën. E di Kaçaniku krejt. Jam
6 kanë i veshtë, i mbathtë, ai veç [E pakuptueshme] ka hangër
7 Enver Axhami. Ai është një rrugaç. Qeshtu më ka ba --

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
9 dëshmitar.

10 Z. PACE: [Përkthim]

11 PY. Do ju ndaloj sepse po përsërisnit gjërat që thatë. Nga
12 çfarë thatë, duam që të sqarojmë disa gjëra.

13 Ju filluat duke thënë që një person Axhami, ju ka -- pra
14 dua t'ju pyes në qoftë se ky pretendimi i këtij Axhamit që ju
15 e keni rrahë atë bashkë me një polic. Kur është bërë? Është
16 bërë përpara, apo pasi jeni arrestuar juve në mars 1999?

17 PË. Jo, këtë në e paç rrehë policia edhe Kaçaniku le të ngojë
18 mirë që ku jam. Le ta dinë mirë. Nëse e kanë rrehë Sami
19 Axhamin policia dhe Agim Idrizi me policë qysh thotë ai, unë
20 kam me e dhanë përgjigjen. Por në qoftë se s'e kanë rrehë, çka
21 do të bajë ai. Unë e kam zanë Sami Axhamin aty në katund. [E
22 pakuptueshme] janë tridhjetë gjind i kish marrë me mbajtë një
23 send ---

24 PY. Dëshmitar, do t'ju ndaloj këtu. Do ju kërkoj që të
25 dëgjoni pyetjen edhe jepni përgjigje për pyetjen që po ju bëj

1 unë, e kuptoni? --

2 PË. Nuk është e vërtetë.

3 PY. E kuptoj çfarë po thoni, por më dëgjoni pyetjen. Dëgjoni
4 pyetjen dhe pastaj përgjigjuni. Sami Axhami, që thotë që e
5 keni rrahë ju bashkë me një polic, këtë gjë Sami Axhami e ka
6 thënë përpara se sa të të arrestoheshe në 1998 apo pas kësaj
7 kohe?

8 PË. Sami Axhami e ka thanë para se me më arrestu, e ka thanë
9 në Dushkaj, Kaçanik, te shtabi i UÇK-së. Kjo s'është e
10 vërtetë. Kush do le të thojë çka të dojë, kaq.

11 PY. Dëshmitar, përmendët dikë me mbiemrin Koka. A mund t'i
12 thoni gjykatësve se si e ka emrin ky person?

13 PË. Ai është Habib Koka, gjeneratë e ime është. Edhe jemi
14 kanë shokë të ngushtë një kohë të gjatë.

15 PY. Habib Koka a ka qenë anëtar i UÇK-së? Ka qenë pjesëtar i
16 UÇK-së në 1998 dhe 1999 apo jo?

17 PË. Habib Koka ka qenë polic i Serbisë deri në q'atë kohën që
18 jam kidnapu unë, pastaj ka shku në UÇK, ma s'di për të
19 kurrëgjë.

20 PY. Dëshmitar, një pyetje të fundit për dokumentin që kemi në
21 ekran. Shohim në fund që ka firmën në emër të Selim Topojanit
22 që është Kryetari i Nismës Demokratike të Komunës, a ke
23 dëgjuar ndonjëherë emrin Selim Topojani apo Saip Zeka? Njeh
24 ndonjë prej tyre?

25 PË. Jo, jo.

1 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit Sekretares, mund të
2 hiqet dokumenti nga ekrani.

3 PY. Dëshmitar, përmendëm Radoslavin apo Rade Ognjenovic që
4 ishte kryetari i këshillit të komunës. Përveç këtij personit,
5 përpara se të arrestonin ty në mars 1999, ti -- a e njihni
6 ndonjë nëpunës tjetër serb në Kaçanik?

7 PË. Po, atje kanë punu edhe shqiptarë bashkë në komunë me
8 ata.

9 PY. E kuptoj këtë, por dëgjoje. E kisha fjalën, ndonjë zyrtar
10 tjetër serb a e njihje ti në Kaçanik përpara se sa të të
11 arrestonin në mars 1999? Pra, ndonjë zyrtar serb, apo nëpunës
12 serb, a e njihje?

13 PË. Po, ata i kanë njoftë, krejt i kanë njoftë, jo veç unë.
14 Aty është Kaçaniku, i vocërr.

15 PY. A ke njohur ndonjë person me emrin Vojo në 1998, 1999?

16 PË. Po, Vojo është kanë një djalë, një familje e mirë. E
17 njohin krejt shqiptarët, s'kam çka me rrejtë këtu. Ai shumë
18 herë ma ka ngjetë kerrin, drutë i kam dhanë ma lirë.

19 Nganjiherë ia kam dhanë pa pare. M'i ka nxjerr kamionat kur
20 m'i kanë nxanë, se s'na i dhanshin kamionat. Qe aq. [E
21 pakuptueshme].

22 PY. Fillojmë me kombësinë. Çfarë kombësie kishte Vojo?

23 PË. Serbe.

24 PY. A mund të shpjegosh për gjykatësit, pse ia shisje drunë
25 me një çmim më të ulët?

1 PË. Unë e kisha korisht se ai kur ma nxajshin kamionin ai
2 shkojke e nxjerrke, i merrke përmbi vete që janë drutë e atij.
3 Unë e kisha korisht me nxjerrë kamionat. Kështu është kanë
4 atëherë jeta.

5 PY. Shpjego për gjykatësit, pse ta merrnin kamionin?

6 PË. Po kamionin normal që ta merrnin se s'kam as letër, as
7 peçat [fonetikiisht], as kurrgjë, dru të vjedhta në mal.

8 PY. Çfarë kishe në kamionë?

9 PË. Po dru që i kam pre në mal, pa letra, pa [E
10 pakuptueshme].

11 PY. Përveç Vojos që të ndihmonte kur të merrnin kamionin, a e
12 ke pyetur ndonjëherë Vojon apo ndonjë person tjetër për ndonjë
13 ndihmë?

14 PË. Jo, s'ka pasë nevojë me pyetë për tjetër send. Kamioni
15 është kanë në pyetje me ma nxjerrë, se kamionin nuk ta
16 dhanshin. U dashke me pritë gjashtë muaj me të qitë në gjyq e
17 sende. Kaq është kanë kjo punë.

18 PY. Në Kaçanik, në 1998 dhe 1999, ishte e lehtë për
19 shqiptarët që të merrnin pasaportë nga autoritete serbe, e
20 kishin të lehtë shqiptarët?

21 PË. Këqyre, këtë punë e keni bo mirë po, kush ka pasë ndalesë
22 ai s'mund e ka marrë. Edhe normal edhe qetash që është shteti
23 jonë, ka ndalesë, s'ta jep pasoshi. Pasoshin e kanë nxjerrë
24 krejt. Kush ka dashë ka nxjerrë. Unë s'jam përzi.

25 PY. A je përpjekur të ndihmosh ndonjë shqiptar ti që të marrë

1 pasaportë në 1998, në 1999?

2 PË. Unë e kam ditë këtë punë që ka probleme e të gjithë i kam
3 ikë. S'kam shku me i nxjerrë kurrkujt pasosh. Tre pasosha i
4 kam nxjerrë në emër temin. Xhevahir Idrizit, nanën e Jeton
5 Qorrit, është kanë tu shku me një dasëm në Maqedoni, edhe [E
6 pakuptueshme] pasoshi për sot. Të nesërmen ma nxjerr. Qe asaj
7 i kam ndihmu. Ia kam nxjerrë. Edhe një është një farë Elezi,
8 është i Biçecit. Tjetërkush prej meje pasosh s'ka marrë. Se
9 s'jam përzi në kësi gjana. E kam ditë që ka probleme edhe
10 s'kam pasë nevojë me u përzi se unë e kam pasë biznesin tem.
11 Kam pasë pare boll.

12 PY. Me pak fjalë, a mund t'u tregosh gjykatësve si i ndihmove
13 ti këta njerëzit që të merrni pasaporta?

14 PË. Po -- për shembull, e njeh dikën atje, shkon i thu ndreqe
15 q'atij pasoshin, e ta ndreq. Nuk ka zahmet. Mos ta bajna të
16 madhe këtë punë se atë e dinë krejt Kaçaniku që i ka nxjerrë.
17 Kryesorja s'jam përzi unë në kësi gjana. Tre pasosha e di që i
18 kam nxjerrë, e ato janë njerëzit që s'kanë bo gjo. Janë q'atje
19 në Kaçanik janë.

20 PY. Dëshmitar, edhe një herë ta dëgjosh pyetjen. Më
21 konkretisht, si i ndihmove ti këta persona që të merrnin këto
22 pasoshat, pasaportat? Me kë fole, si e bëre të mundur që të
23 ndodhte kjo gjë?

24 PË. Po [E pakuptueshme] kjo nuk e di sa vjet i ka. Keq më
25 vjen më keni [E pakuptueshme] për këtë punë. Mundeni me shku

1 me i vetë ato, bre. Ata janë gjallë.

2 PY. Dëshmitar, a fole me Vojon ti që t'ju siguroje pasaporta
3 këtyre tri personave? Me Vojon fole?

4 PË. Vallaj, kam harru. [E pakuptueshme] është kanë kjo punë.
5 Para luftës është.

6 PY. Na the pak më përpara që asnjë s'ke kallëzu ndonjë person
7 edhe as nuk ke pasur gisht fare për arrestimin e ndonjë
8 personi. Dëshmitar, me aq sa di ti, ndonjë nga gjërat që ke
9 bërë ti, para marsit 1999, mos kanë bërë të arrestohet ndonjë
10 shqiptar, mos ke bërë ndonjë gjë ti para marsit 1999 që të
11 arrestohej ndonjë shqiptar, ndonjë veprim a ndonjë gjë?

12 PË. Unë me i arrestu? Për kënd bëhet fjalë?

13 PY. Dëshmitar, ti, me sa di ti, mos ke bërë -- ke bërë ti
14 ndonjë gjë -- ndonjë veprim, para marsit të 1999, dhe ky
15 veprimi i yt pastaj të ketë bërë që ndonjë shqiptar të
16 përfundojë në burg? Mos ke bërë ti ndonjë gjë para marsit 1999
17 që të çonte ndonjë shqiptar në burg?

18 PË. Jo, unë besën po ia jap. Veç një emër le ta kallëzojnë
19 kush ka shku prej meje në burg, unë jam përgjigjë. Unë për
20 qete kam ardhë këtu. Unë me pasë mshelë në burg, kisha mshelë
21 Enver Axhamin. Me krejt jam kanë mirë me tjerët.

22 PY. Dëshmitar, i ke thënë ti ndonjëherë policisë serbe t'i
23 digjnin shtëpitë komshinjve?

24 PË. Jo, jo, këtë s'vyjnë te unë këto punë. Unë kesi hakmarrje
25 nuk baj. As baj kurrë.

1 PY. Po a ka thënë njeri që e ke bërë ti këtë? Ka thënë njeri
2 që ai Agim Idrizi i ka thënë policisë serbe t'u djegin
3 shtëpitë komshinjve? E ka thënë njeri këtë gjë ndonjëherë?

4 PË. Jo, këto janë gënjeshttra. Se kurrë në jetë këto s'i kam
5 ba.

6 PY. E kuptojmë që janë gënjeshttra, por ne po pyesim: Ndonjë
7 person i ka thënë këto gënjeshttra? A ka thënë njeri me zë që
8 ai Agim Idrizi u ka thënë policisë serbe të djegin shtëpitë
9 kojshive? Ti ke dëgjuar ndonjë gjë të tillë ta këtë thënë
10 njeri për ty.

11 PË. Jo, jo, jo. Këto -- nuk shkrun kurrkund këto gjajna. Bile
12 mos i bani pyetje hiç për mu, se mu këto s'më kanë interesu.
13 As më ka thënë kurrkush. Unë jam kanë keq me qetë familje, me
14 tjetërkund s'jam kanë keq. Me familjen Axhami, edhe Habib
15 Kokën. Edhe Kemal Doganin.

16 PY. Pjesëtarët e familjes Axhami, a i kanë thënë ndonjëherë
17 këto gjëra për ty? Mos kanë thënë ndonjëherë këta pjesëtarët e
18 familjes Axhami që ti i thoje policisë serbe të digjte
19 shtëpitë e kojshive? Apo që ti i ke thënë policisë serbe të
20 fuste njerëz në burg?

21 PË. Jo, jo. Këto s'janë të vërteta këto. Këto unë ju
22 kallëzova, me pas dashtë me mshelë në burg e me ba keq, krejt
23 Kaçaniku e di. Edhe e kisha mshelë këtë Enver Axhamin. Por
24 edhe këtë s'e kam ba unë. Ata kurrë policia s'e kanë ndjekë as
25 kurrë te shtëpia s'i kanë shku, as në rrugë s'e kanë ndalë.

1 Familjen Axhami asnjë s'e kanë arrestu. Kurrë, as për armë as
2 për kurrgjë. Këto janë gënjeshtër. Ata kanë armë të serbëve,
3 te shtëpia i kanë.

4 PY. Dëshmitar, e kemi të qartë që po thoni që janë
5 gënjeshtër, po do të pyes dhe një herë: Këto gënjeshtër mos i
6 ka thënë njeri nga familja e Enver Axhamit, apo vetë Enver
7 Axhami, e kuptojmë që ti po thua që këto nuk janë të vërteta,
8 por mos i kanë thënë këta të familjes Axhami përpara se të
9 arrestonin ty në mars 1999? Ndonëse ju thoni që janë
10 gënjeshtër? Mos i kanë thënë?

11 PË. Unë jam tu ju thanë që këto emrin tem e kanë shti qetu
12 polic, shumar, edhe përmbi Arkanit që ia ka çu paret Enver
13 Axhamit për tokë. Qe kaq s'ka tjetër send këtu. Këtu s'bahet
14 fjalë as politikë, as armë, e as UÇK, e as kurrgjë. Kjo është
15 e kjartë, për tokë kena na në bela. Edhe tokën s'e kam shitë.
16 As kam ble. Ai ka hy me gjashtë vetë të familjes natën ia ka
17 gjujtë paret atij njërit, Qazim Idrizit, kushërinin tem. Dy
18 vetë si kanë marrë paret. Edhe ju kam kallëzu që kanë ardhë
19 njerëzit me na pajtu, ky i ka sha Enver Axhami i ka ndjekë.
20 S'ka ngu me u pajtu.

21 PY. Ata e kanë futur emrin edhe unë po të pyes, kjo ka
22 ndodhur përpara se të të arrestonin ty në mars 1999 apo pas
23 marsit 1999? Vetëm këtë doja të dija, para apo pas marsit?

24 PË. Në 1999 s'e di, mars qeshtu është kanë. Kanë ardhë dhjetë
25 vetë te shtëpia, me maska civilë të armatosë, kanë ardhë m'i

1 kanë thy xhamat, derët --

2 PY. Dëshmitar, më fal. Do të të ndërprers, nuk po i
3 përgjigjesh pyetjes. Këto ne po themi këtë: Këto gënjeshtat
4 për ty, i kanë shpifë para se të të arrestonin në mars 1999
5 apo këto gënjeshtat i kanë thënë pas marsit 1999? Pra, para
6 arrestimit apo pas arrestimit tënd?

7 PË. Po, po. E vërtetë është. Qe tash e kuptova. Këto para
8 arrestimit tim i kanë bo ato truqt, domethënë fjalët, krejt
9 për çka më akuzojnë. Edhe këta duhet me likuidu Agim Idrizin.
10 Familja Axhami e ka ba edhe Habib Koka. Se Habib Koka ka punu
11 te policia serbe, kështu ai ka njoftë njerëz.

12 Z. PACE: [Përkthim] Sekretarja e Gjykatës, a mund të
13 nxjerrë në ekran të lutem materialin që ka numrin 114873-
14 114873. Domethënë kjo është vetëm një faqe, edhe dua të
15 përqendrohemi të shohim fotografinë -- këtë fotografinë.

16 PY. Dëshmitar, e sheh këtë fotografi që të doli tek ekriani
17 përpara?

18 PË. Po.

19 PY. E njeh vendin ku është kjo fotografia?

20 PË. Po, po. E mbaj mend se jam kanë në shkollë që kam ardhë
21 këtu si i vogël, si fëmijë. E jam kanë në shkollë në Bob.

22 PY. Në cilin fshat është?

23 PË. Kjo është në fshatin Bob, nalt atje, i thonë Stanet e
24 Bobit.

25 PY. Në dëshminë e mëhershme ke thënë që të kanë mbajtur në

1 Bob. A e ke parë këtë vendin gjatë kohës që të kanë mbajtur
2 atje të arrestumë?

3 PË. Po. Është edhe një kolibe më poshtë, ku është kanë tu më
4 pritë Enver Axhami aty natën vetë. [E pakuptueshme] kësaj
5 shtëpisë poshtë është.

6 PY. Në kohën që të arrestuan në Bob, e ke idenë për çfarë
7 përdorej kjo ndërtesa që shohim në fotografi, në kohën që ishe
8 arrestuar?

9 PË. Po aty rrijshin ushtarët e UÇK-së, flejshin.

10 PY. Dhe një pyetje tjetër për këtë. Gjatë kohës që ke qenë i
11 arrestuar në Bob, në 1999, ndërtesa, ky objekti, ishte siç
12 duket tani në fotografi, apo ishte ndryshe atëherë?

13 PË. Është kanë e vjetër kjo, shtëpi e vjetër. Qe tani po e
14 lyp qiriç pak.

15 PY. A ishte siç është tani, siç e shohim në fotografi apo
16 kishte ndonjë gjë ndryshe?

17 PË. Veç qysh me ju thanë, është kanë shtëpi e vjetër kjo. E
18 vjetër është, [E pakuptueshme] kohësh që është mbarue. Qysh në
19 klasën e parë kur jam kanë, e mbaj mend.

20 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkojmë
21 pranimin e fotografisë sikurse e shpjeguam në email edhe
22 diskutimin *inter partes* përpara se të fillonim dëshminë,
23 ndonëse ne në fakt nuk e kishim në listën e provave materiale,
24 kjo është një kopje e fotografive edhe qëllimi është që në
25 mënyrë që ne t'i tregojmë dëshmitarit komentet që ka

1 fotografia, dhe të shpjegonim vetëm çfarë dokumenti është. Pra
2 teknikisht është në listën e provave materiale. Megjithatë
3 kërkojmë që sërish të pranohet.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
5 kundërshtim?

6 Asnjëri s'ka kundërshtim?

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Merr numrin e provës
8 materiale P374.

9 Z. PACE: [Përkthim]

10 PY. Dëshmitar, dhe pak pyetje kam. Gjatë kohës së arrestimit
11 në mars 1999, pate ndonjë avokat, të dhanë ndonjë avokat?

12 PË. Jo, s'ka pasë avokatë aty.

13 PY. Gjatë arrestimit në mars 1999, ndonjë pjesëtar i UÇK-së
14 të nxori para ndonjë gjykate apo ndonjë gjykatësi?

15 PË. Jo, jo. Më kujtohet Jonuz Shurdhani na marrke në pyetje
16 krejtve. Unë i mbrami kam mbetë. I kam thanë "Edhe mu pse s'po
17 më merr". Ai tha, "Jo s'guxoj prej Enverit. Edhe prej Fadil
18 Çakës, prej Rustem Demës". Edhe s'më ka marrë në pyetje se
19 tha, "Me të marrë unë në pyetje, a duhet me të lëshu me shku
20 në shtëpi, se ta kanë gjetë veç një [E pakuptueshme] në
21 korridor te shtëpia". Tjetër send s'kanë gjetë. Edhe një palë
22 pantoll të ushtrisë të Gjermanisë që i ka pru vëllai jem, i ka
23 marrë Rustem Dema, qe kaq. Ai është kanë tu më lëshu, por
24 Enver Axhami s'më ka lëshu me Rustem Demën, me Fadil Çakën. Me
25 këtë jam kanë në bela.

1 PY. A mund t'u tregosh Gjykatësve si e ka emrin ky Shordani
2 që sapo përmende?

3 PË. Jonuz Shurdhani, ai ka punu përpara në milici, në
4 mbrojtje në Jugosllavi. Ai ka shkollë, kurse Enver Axhami, më
5 falni shprehja, ai është një rrugaç. Edhe Rusta q'ashtu,
6 Rustem Dema, edhe ai Fadil Çaka ka qenë ashtu. Këta të tre.
7 Jonuz Shurdhani është me shkollë. Ai ka lëshu, i ka marrë në
8 pyetje 15 vetë i ka marrë në pyetje. Pesë na kanë lëshu këto,
9 tre ushtarë. Enveri edhe Fadil Çaka, dhe Rustem Dema.

10 PY. Dëshmitar, e kuptojmë që kanë kaluar 25 vjet që kur kanë
11 ndodhur këto ngjarje, por ke më pasoja fizike për shkak të
12 asaj që të ndodhi në mars 1999? A vuan nga ndonjë gjë për
13 shkak të asaj që të ndodhi?

14 PË. Unë i kam pasojat që mendja s'jua merr. Më kanë lanë me
15 fjetë ku ma keq. Më kanë maltrajtu, më kanë rrehë në [E
16 pakuptueshme] ma keq ndonjë. Edhe krejt trupin e kam keq.

17 PY. Faleminderit, dëshmitar.

18 Z. PACE: [Përkthim] Nuk kam më pyetje.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

20 Z. LAWS: [Përkthim] Nuk kam pyetje, sepse pyetjet tona u
21 ezauruan nga Prokuroria, nuk do të shtoj asgjë.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]
23 [Përkthim] Mbrojtja e Thaçit.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Besoj që të është dërguar një
25 email ku kemi thënë që do të fillonte Mbrojtja e Selimit. Ka

1 dërguar një mesazh elektronik Mbrojtja e Selimit dhe do të
2 fillojnë ata të parët.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
4 le të fillojë Mbrojtja e selimit.

5 Z. YOUNG: [Përkthim] Faleminderit. Faleminderit dhe
6 kolegët që më lejuan mua të filloja i pari.

7 Pyetje të palës tjetër nga z. Young:

8 Z. YOUNG: [Përkthim]

9 PY. Mirëmëngjes, dëshmitar.

10 PË. Mirëmëngjes.

11 PY. Z. Dëshmitar, gjatë këtyre viteve sigurisht që shumë
12 avokatë ju kanë bërë shumë pyetje. Kështu që përpiqu që sa më
13 shkurt të na japësh përgjigjet.

14 Është e vështirë që të kujtohen gjërat që kanë ndodhur
15 para 20 vitesh. Kështu që unë do të përpiqem të ndihmoj aty ku
16 mundem. Edhe Gjykatësit, do të fokusohem më shumë tek arsyet
17 që ke dhënë për gjërat që të kanë ndodhur. Pra, do fokusohemi
18 te konteksti. Ajo që ka ndodhur. Nuk do të pyes për vendet ku
19 të kanë çuar pra, e kupton këtë? Apo për sulmin që të kanë
20 bërë.

21 PË. Po.

22 PY. Faleminderit. Unë do të them si fillim, që dua të pyes
23 për tre fusha të ndryshme, apo për tre tema. E para njëherë
24 dua të na tregosh këtë mosmarrëveshjen për tokën, që ke pasur
25 me Axhamin. Pastaj, do të pyes çfarë ndikimi pati ky konflikt

1 për tokën tek ty dhe pastaj tek të tjerët. Dhe do të pyes dhe
2 për deklaratat që ke thënë se "UÇK-ja nuk e dinte se çfarë
3 synimesh kishte Enver Axhami për mua", ose "me mua". I kupton
4 këto? Këto janë tre fushat që do të diskutojmë. I kuptoni
5 këto?

6 PË. Urdhno, urdhno, fol.

7 PY. Gjithashtu, do kem një pikë të fundit dhe të tretë, duke
8 pasur parasysh se e shpjeguat tani për Gjykatësit diçka. Të
9 bëmë një pyetje pse të arrestuan, nuk ishte çështje UÇK-je, a
10 çështje politike, a çështje alltish, kështu? Nuk të arrestuan
11 për këto arsye, as për UÇK, as për allti, as për politikë,
12 kështu?

13 PË. Mu më kanë arrestu tu bo shpifje që si nëpërmas Habib
14 Kokës. Kanë arritë te Enver Axhami, familja Axhami, që ka
15 punue në policinë serbe, Habib Koka, edhe këto nëpërmas atij i
16 kanë bo këto gjana. Unë sot jam qetu dhe jam i shkatërru,
17 krejt trupin ma kanë prishë tu më rrehë. Ai ka shti emrin tem
18 aty në listë. Habib Koka dhe Enver Axhami.

19 PY. Mirë, faleminderit. Por ka qenë një problem që e ke pasur
20 me Enver Axhamin, dhe që -- mund të thoni kur ju thoni që ai
21 ishte armiku im, e ke fjalën -- çfarë ishte ky që kishe bela
22 me Enver Axhamin?

23 PË. Ky është më i madhi armik i jemi në krejt Kosovën se ka
24 shku ka thanë te UÇK-ja, ky është Habib Koka e ka pështu këtë
25 familjen Axhami, ky ishte një Arkan përmendet shumë atje te

1 kjo tokë. Thotë kanë pasë me ardhë shtatë kerre me na lidhë me
2 konop mbas kerrit, me na ngre zharrë prej Llanishtes deri në
3 Kaçanik, familjen Axhami, e i ka shpëtu ky Habib Koka. Këto
4 janë gënjeshtër. Kaçaniku e din që s'ka pasë Arkan kurrë në
5 Kaçanik.

6 PY. Pra, ai po përhapte gënjeshtër dhe gjëra që s'ishin të
7 vërteta për ty, kështu?

8 PË. Po, krejt Kaçaniku e din, unë s'kam nevojë këtu me
9 rrejtë. Se aty janë tu na përcjellë sot krejt. Edhe ju kam
10 kallëzu edhe herët aty në Kaçanik. Tash, du me e kallëzu
11 kështu haptaz, me e marrë krejt vesh populli.

12 PY. Faleminderit --

13 PË. Faleminderit edhe prej juve, se kjo pyetje shumë e qartë
14 është.

15 PY. Z. Dëshmitar, ju na e keni shpjeguar që ka qenë çështje
16 personale, e keni thënë këtë. Edhe hetuesve edhe policisë
17 gjatë këtyre viteve. Dhe keni dhënë edhe dëshmi për këtë që
18 kjo ka qenë mosmarrëveshje personale mes teje dhe atij. Keni
19 dëshmuar për këtë gjë, kështu?

20 PË. Po, po. Më lejoni veç pak ta foli një fjalë.

21 PY. Do më lejosh që të bëj një pyetje --

22 PË. Po, po, urdhno.

23 PY. -- pastaj Gjykatësi do të të japi mundësinë të thuash
24 diçka.

25 PË. [Folës që flasin njëkohësisht]

1 PY. Arsyëja që thua ti pse të arrestuan -- ose më saktë, kur
2 të pyeti Prokurori ty a të tha ndonjëherë se të kidnapuan, a
3 është e vërtetë që ti ke thënë që: Një familje më kidnapoi dhe
4 një familje dha urdhrin që të më kidnaponin? Dhe ke thënë
5 pastaj që kjo ishte familja e Enver Axhamit, kështu?

6 PË. Po, këta janë kanë policë ushtarakë që më ka marrë
7 familja e Enver Axhamit, e Sami Axhamit.

8 PY. Tani, sigurisht e dimë që ka kaluar kohë dhe s'të
9 kujtohen gjërat, kështu që herë pas here do të kërkoj që të
10 shohim ca dokumente në ekran siç e bëri edhe kolegu, që të
11 ndihmojë me kujtesën.

12 Z. YOUNG: [Përkthim] Edhe tani, për shembull do të
13 nxjerrim një dokument. Do i lutesha Sekretares që të nxirrte
14 në ekran tani provën materiale P342, dhe në shqip dhe në
15 anglisht -- pra prova materiale 342-AT.1 dhe 342 [sipas
16 përkthimit], ju lutem ta vendosim në ekran. Mund t'i jap
17 Sekretares edhe numrin përkatës që është SPOE00089723 deri në
18 00089766. Dhe faqja që na duhet në anglisht është
19 SPOE00089728, ndërsa shqipja është faqja 6, me numër
20 SPOE00089771.

21 PY. Dëshmitar, t'i shohim bashkë, mbase e ke më kollaj që ta
22 lexosh shqipen, e ke në ekran e sheh?

23 PË. Po.

24 PY. Do ju lutesha Gjykatësve të shohin pjesën nga fundi i
25 faqes -- fillon -- shiko shqipen:

1 "Më rrahu dhe më pyeti se nuk kishte asnjë vend për të më
2 liruar e deshën të më likuidonin. Unë kisha probleme për një
3 copë tokë. Kushëriri im i shiti atij tokën. Edhe kur ia shiti,
4 i transferoi dokumentet komshiut."

5 Pra:

6 "Ai më rrahu dhe më pyeti kështu që nuk kishte kompetencë
7 të më lironte dhe donin të më vrisnin Unë kisha problem me të
8 për shkak të një punë toke."

9 E shihni këtë që po lexoj unë? Është në fund të faqes:

10 "Kushëriri im i ka shitur tokë atij. Dhe kur ia shiti, i
11 transferoi dokumente."

12 A është e saktë kështu? A është përkthyer saktë?

13 PË. Jo, më lejoni të përgjigjem. Tokën e ka ble Bajram Bruti.
14 Janë -- tri vjet është kanë toka në pazar me u shitë. S'mund e
15 ka ble kurrkush, e ka ble Bajram Bruti, ia ka dhanë paret. E
16 ka marrë prenos [fonetkisht]. Kur janë ba dy javë, këto kanë
17 shku i kanë marrë paret te Samir Oneva. Ai i ka miq këta Enver
18 Axhamin. Vllai i Enver Axhamit e ka çikën të martume te Samir
19 Oneva. Ai ka thanë, "Merrni paret shkoni [E pakuptueshme]
20 mbrena shtëpisë edhe mos i merrni". Kështu është kanë.

21 PY. Ju lutem mund t'ju kërkoj që të ndaloni për momentin. Do
22 ju kërkoj për pak që të shpjegoni se çfarë mosmarrëveshje keni
23 pasur në mënyrë që ta kenë më të qartë anëtarët e Trupit
24 Gjykses. Pyetja që kam tani është kjo: A ju është përkthyer
25 saktë që Enver Xhani [sipas përkthimit] ju ka rrahur. A është

1 e saktë kjo?

2 PË. Po, po.

3 PY. Në versionin në shqip, a thuhet që ai më rrahu dhe më
4 pyeti, donte të më vriste" dhe pastaj ju thoni që:

5 "Kisha një problem me të për shkak të një pune toke.
6 Kushëriri im i ka shitur tokë edhe kur e shiti ia transferoi
7 dokumentin fqinjit."

8 A është kështu në shqip? Kështu ka ndodhë apo ke për të
9 bërë ndonjë sqarim?

10 PË. Tokën e ka ble Bajram Bruti, me qejf e ka ble. Kurse ky e
11 din Kaçaniku krejt, i ka hy natën me gjashtë vetë të familjes
12 së vet, ia ka flugë paret në shtëpi edhe ka ikë. Si i ka marrë
13 paret e di vetë ky. Kanë ardhë shqiptarë shumë me na pajtu,
14 por s'kanë mujtë.

15 PY. Që ta sqarojmë. Për sa i takon mosmarrëveshjes, do t'ju
16 bëj pyetje pak më pas. Por, tani, për momentin, nuk e di e ke
17 përpara, e lexon këtë deklaratën që ke dhënë më herët që ty të
18 rrahën për shkak të një cope toke. A ke thënë këtë?

19 PË. Po.

20 PY. Nëse më lejoni, tani nuk do t'ju pyes lidhur me atë çfarë
21 ju ka ngjarë ju sepse nuk dua që ta përjetoni dhe një herë
22 këtë përvojën e hidhur që keni jetuar atëherë. Por dua t'ju
23 bëj një pyetje lidhur me atë natën kur ju kanë arrestuar në
24 mars 1999.

25 A është e drejtë, a është e vërtetë që stafit të

1 personelit ju i keni shpjeguar në 2001 se çfarë ju ka ngjarë,
2 çfarë ju ka ndodhur në mars 1999? A është e saktë kjo?

3 PË. Te shtëpia, po.

4 PY. Faleminderit. Ju u morët nga shtëpia dhe shkove, i
5 shpjegove UNMIK-ut çfarë të kishte ndodhur, kështu?

6 PË. Po.

7 PY. Ju i thatë UNMIK-ut që u dërguat në një shtëpi në Bob, në
8 rajonin ose zonën e Kaçanikut, e ke thënë këtë gjë?

9 PË. Po.

10 PY. A është e vërtetë që ju shtuat po ashtu se ti u çudite
11 ose u habite që aty patë edhe armikun tuaj, fqinjin tuaj,
12 Enver Axhamin, që ishte në këmbë edhe ju përshëndeti. E ke
13 thënë këtë gjë?

14 PË. Po.

15 PY. A është e vërtetë që i keni thënë gjithashtu personelit
16 të UNMIK-ut më datë 1 shtator 2001 --

17 Z. YOUNG: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në qoftë se
18 është e nevojshme, do ju jap numrin e referencës --

19 PY. -- që: Enveri filloi që të bënte pyetje lidhur me atë
20 copën e tokës që mendohej që do t'i shitej vëllait të vet, por
21 në fakt iu shit dikujt tjetër, jo vëllait të tij. A është e
22 vërtetë që ia keni thënë këtë UNMIK-ut?

23 PË. Atë tokën e ka ble Bajram Bruti, me qejf. Krejt e di
24 Kaçaniku.

25 PY. Po. A i ke thënë ti UNMIK-ut që Enver Axhami, pyetja e

1 parë që të bëri Enver Axhami ishte pyetja që kishte të bënte
2 me këtë copën e tokës. Kjo ishte gjëja e parë që ju tha ai,
3 domethënë pasi ju përshëndeti mbasi ju ishit kidnapuar? Ai ju
4 pyeti për copën e tokës, kështu ka qenë?

5 PË. Po.

6 PY. Faleminderit. Ai, Enver Axhami, a e përmendi emrin e
7 personit që sipas tij duhet ta kishte blerë tokën në vend të
8 Bajram Prufit [sipas përkthimit], këtij personit që e bleu? A
9 ta tha ty ai se kush duhet ta kishte blerë tokën? Jo Bajrami
10 Brutti, por dikush tjetër, ta tha emrin e personit që ai
11 mendonte se duhet ta kishte blerë tokën?

12 PË. Po, këto i kena lutë se s'kanë pas pare me ble tokë,
13 familja Axhami. Masanej kanë marrë, thashë, te Samir Oneva
14 paret, e kanë mekë, ai i ka mësu. Shkoni flugni paret dhe ikni
15 mos i merrni, [E pakuptueshme] çfarë është kjo? Shumë keq. Me
16 t'i gjujtë paret e me ikë. Këta në atë kohë e kanë pasë [E
17 pakuptueshme] krajl e kanë pasë në Kaçanik. [E pakuptueshme] e
18 ka shti në punë Sami Axhami te kafja e pensionerëve, Enverit i
19 ka mbaru butik, ka shitë tesha. Dyqan ka pasë, Enver Axhami.

20 PY. Faleminderit.

21 PË. Faleminderit edhe juve.

22 PY. Enver Axhami, a të shpjegoi ty z. Dëshmitar se kush ishte
23 personi që sipas mendimit të tij duhet ta kishte marrë, ta
24 kishte blerë tokën. E përmendi emrin e këtij personi për
25 shembull, a tha ai që pronari i asaj tokës duhet të ishte

1 vëllai i tij? Duhet ta kishte blerë vëllai i tij, ta tha këtë
2 gjë?

3 PË. Jo, këta janë gënjeshtër. Bajram Bruti ka ble. Tri vjet
4 toka është kanë në pazar. S'mund e ka ble kurrkush s'kanë pasë
5 pare në atë kohë, ky BAJRAM BRUTI e ka ble. Ia ka dhanë paret,
6 e ka bo përnes [fonetikusht] tokën. Kurse ky Enveri i ka hy me
7 gjashtë vetë mbrenda, që e kam të shkruar me një vend s'e di
8 qysh me jua pru këtu me e pa. Lexon kjartë, e di thotë që ia
9 kanë lanë paret mbrenda dhe kanë ikë. Kështu është kjo. këtë
10 s'e ka ba askurrifar kombi çka e ka ba --

11 PY. Në rregull.

12 PË. -- Enver Axhami.

13 PY. Çfarë bëri ai, a mund të na e thoni? Domethënë, çfarë
14 bëri ai lidhur me këtë mosmarrëveshjen për tokën?

15 PË. Unë jam tu të kallëzu që paret e dinë edhe në Kaçanik, që
16 janë tu na ngu krejt. Samir Oneva, i Kaçanikut ka hotel, te
17 benzinës ka naltë në Kaçanik atje naltë. Edhe para lufte edhe
18 mbas lufte ka. Ia ka dhanë paret, i ka thanë shkoni flugni
19 brenda në shtëpisë dhe jepni mos i merrni. Këto q'ashtu kanë
20 hy ia kanë flugë dhe kanë ikë. Këta janë dëshmitarë njerëzit
21 të mëdhenj shqiptarë. Që kanë ardhë me na pajtu, Enveri ka
22 shajtë i ka përzënë si ka marrë paret. Unë s'e qes këtë prej
23 veti.

24 PY. Me sa kuptoj unë, ju po thoni që Enver Axhami vetë nuk i
25 kishte paratë, ose familja e vet nuk i kishte paret që të

1 blinte këtë copën e tokës, është e saktë kjo?

2 PË. Jo, s'kanë pasë pare këta, se me kanë e kishin ble me
3 vakt, s'e kishte ble ma vonë Bajram Bruti. Na i dijna këto
4 punë.

5 PY. Bajram Bruti me sa di ti, Bajram Bruti u bë pronari i
6 ligjshëm i tokës, ai e bleu tokën, kështu?

7 PË. Po, ai e ka ble, po.

8 PY. Dhe me çfarë çmimi e bleu? E bleu për 24.000 marka
9 gjermane?

10 PË. Po, 24.000 marka gjermane ia ka dhanë paret në dorë, edhe
11 e kanë shku kontratë.

12 PY. Faleminderit. A mund ta ndihmoni Trupin Gjykues duke i
13 shpjeguar se kur e bleu Bajram Bruti këtë copën e tokës për
14 24.000 marka gjermane?

15 PË. Kjo i ka -- gati 30 vjet qeshtu mos gabofsha. Kjo është
16 motit.

17 PY. Na e shpjeguat problemin me tokën, ose mosmarrëveshjen
18 për tokën. Dhe njëherë thatë që ju ka shkaktuar probleme kjo
19 për dy vite, një herë the për 11 vite. A mund të pajtohemi
20 bashkë që kjo çështja e tokës ju ka shkaktu goxha shqetësime
21 për shumë kohë?

22 PË. Po. Ky Enver Axhami dy vjet e ka punu tokën me dhunë,
23 s'kanë guxu familja Bruti me dalë te toka.

24 PY. Të përqendrohemi tani te mosmarrëveshja e tokës. Pra do
25 të flasim tani për temën numër 1. Ku gjendej, ku ndodhej kjo

1 copa e tokës, nëse mund të na e shpjegosh?

2 PË. Kjo është -- në krye të katundit në Llanishtë, katundi
3 tem.

4 PY. Mbase e kam komplet gabim, por a nuk ka dy Llanishta? Apo
5 ka vetëm një Llanishtë, është një Llanishtë në Kaçanik dhe një
6 tjetër Llanishtë, kështu është?

7 PË. Jo. Një Llanishtë e kam ndi këtej nga Shtimja, s'di apo
8 nga Prizreni. Po ne s'kena lidhje me atë Llanishtë. Ne jena
9 lart Kaçanikut.

10 PY. Në rregull. Pra, kjo copa e tokës për të cilën po flasim
11 ishte në Llanishtë në Kaçanik, kështu?

12 PË. Po.

13 PY. Dhe bëhej fjalë për 7 ari tokë, kështu? Hektarë tokë?

14 PË. Nuk e di sa janë, a 17 a 7, nuk e di sa janë. Se ai e ka
15 punu krejt. Atë duhet me vetë, ai ka çka me u kallëzu, Abaz
16 Bruti.

17 PY. A e di ti se për çfarë përdorej ajo toka, përdorej për
18 bujqësi, përdorej për banesë, për çfarë? Për ndërtim, për
19 çfarë? Ishte tokë bujqësore, çfarë ishte?

20 PË. Ajo tokë është kanë krejt shkretë, gurë, ferra, trapa, pa
21 punu kurrë. Po ka pasë livadh, ma shumë ka pasë gurë e ferra,
22 trapa, lisa, kurse ky e ka punu mbas dy vjetëve e ka punu
23 Abazi. Djali i Bajram Brutit. Se kena hy edhe me Lidhjen
24 Demokratike në këtë temë për bisedime, për me ia kthy paret
25 Enver Axhamit, por -- s'ka ecë puna me Lidhjen Demokratike. I

1 ka sha, ma shkurt. S'ka dashtë me ndi për këtë punë hiç. Edhe
2 kanë ndejtë në livadh dy vjet, e ka kullotë tokën --
3 PY. A ndaloni këtu ju lutem?
4 PË. Po.
5 PY. Pra, këto paratë, 24.000 markat gjermane, të kujt ishin
6 këto paret? Nga vinin këto paret, të kujt ishin këto paret?
7 PË. Po qetash Bajram Bruti e ka ble me qejf, ia ka shitë
8 tokën Qazim Idrizi Bajram Brutit e ka ba kontratën me leje të
9 [E pakuptueshme]. Edhe e ka marrë ai tokën Bajram Bruti, kurse
10 ky i ka marrë paret te Samir Oneva e kanë shku ia kanë flugë
11 natën në shtëpi dhe kanë ikë. Kështu është kjo. Dhe më s'ia ka
12 çu paret Qazim Idrizi Enver Axhamit. Ne kena ikë me Lidhjen
13 Demokratike, kena mbajtë mbledhje te kafja e pensionerëve.
14 Edhe atje janë kanë tu u rrehë, janë dy të Kaçanikut janë djem
15 të politikës me ne që janë këto ditë. Se ka muhabet edhe me
16 atë.
17 PY. Pra, tokën, pronar i tokës fillimisht ishte Qazim Idrizi,
18 kështu e kishte emrin personi që ishte shitësi?
19 PË. Po, ky është shitësi i tokës, po. Shitësi -- q'ashtu.
20 PY. Qazim Idrizi, çfarë marrëdhënie ka me ty? E ke kushëri, e
21 ke farefis, çfarë e ke?
22 PË. Qazim Idrizin unë e kam të parin kushëri, e kam para
23 shtëpisë aty. Ai jeton edhe në Prishtinë, por verës e ke aty
24 në katund. E ka mbaru një shtëpi e ka mbaru edhe daja i vet e
25 ka një shtëpi, por Enveri tash ia ka marrë mbas luftës. Të dy

- 1 shtëpitë. Me dhunë ia ka marrë. Se ka qitë në gjyq Bajram
2 Bruti, edhe mu me marrë tokën nëse është ai blerësi i tokës.
3 Ai çka ka ba? I ka thanë "I kam zanë numrin e Arkanit Agimit",
4 m'i keni majtë paret dy vjet, ke ba biznes me paret e mija,
5 unë atë tokë e kam marrë krejt, për gjynaf [fonetikiisht].
6 PY. Faleminderit. Pra, kishte mosmarrëveshje ose kishte një
7 lloj reagimi të tillë sepse nuk ishte pronari i ligjshëm i
8 tokës?
9 PË. Urdhno edhe një herë?
10 PY. E kam unë fajin. Të kërkoj ndjesë për këtë. Na thatë që
11 Bajram Bruti e bleu tokën dhe u bë pronar i tokës, kështu?
12 PË. Po, kështu është kanë.
13 PY. Si ndodhi kjo? Kjo ka ndodhur në zonën tuaj domethënë kjo
14 pjesa e letrave për pronësinë e tokës ka ndodhur tek zona
15 juaj, apo ka ndodhur në Beograd, apo nuk e dini fare se ku
16 janë bërë letrat për tokën.
17 PË. Në komunë i kanë ndreqë letrat në atë kohë. Në komunën
18 Kaçanik. Edhe kam ndi se s'e di, ka çu Bajram Bruti në Beograd
19 dokumentat. Në riva [fonetikiisht], me i bo atje. Ku e di unë,
20 atë vete.
21 PY. Në rregull. Pra, toka është regjistruar mbi Bajram Brutin
22 aty në komunën e Kaçanikut, kështu?
23 PË. Po.
24 PY. Në nivel vendor, kështu?
25 PË. Kështu është, po.

- 1 PY. Po Enver Axhami si reagoi ndaj faktit që në fakt Bajram
2 Bruti e bleu tokën?
- 3 PË. Tash të kallëzoj. Kena majtë mbledhje me Fadil Bajnicën,
4 Ramiz Shehin në Kaçanik, atje janë të Lidhjes Demokratike.
5 Edhe i kena mbajtë mbledhjet te kafja e pensionerëve në
6 Kaçanik, është e kafeqarit aty. Edhe Enveri, Zymri Axhami edhe
7 Enver Axhami kanë mbajtë mbledhje me Fadil Bajnicën e Ramiz
8 Shehin e me neve. Këto kurrqysh nuk kanë ra në pëlqim për këtë
9 tokën, agresivë janë ba, me u rrehë atë ditë, shqiptarët çka
10 janë. Fadil Bajnica, Ramiz Shehi, edhe ato me ato kërcënime
11 kanë dalë aty dhe na kanë thanë. "Sot për sot i kena qeto
12 policë. Shkoni lajmëroni te policia serbe se po t'ju folë
13 serbisht ai i merr paret Enver Axhamit". Jena kanë tu u vra.
14 Edhe ky ka marrë paret, Enver Axhami. Masanej ka marrë paret,
15 mbasi u kanë folë që thotë ai Fadil Bajnica, Ramiz Shehi,
16 folin serbisht. Kaq di për këtë.
- 17 PY. Thoni që Enver Axhami i mori paret. Për cilat pare mori,
18 për kë pare e keni fjalën?
- 19 PË. Paret që ia ka flugë natën Qazim Idrizit me gjashtë
20 kushërinjtë e vet. I ka hy në shtëpi mbrenda.
- 21 PY. A po thoni që në fakt, Enver Axhami u mundua që të
22 ndryshonte rrjedhën e shitjes së tokës? Dhe pasi ishte shitë
23 toka ai u përpoq që ta blinte për veten e vet, këtë po thoni?
- 24 PË. Po, se Abaz Bruti, djali i Bajram Brutit, edhe Qazim
25 Idrizi kanë shku në Prishtinë te një gjykatës. E kanë --

1 bisedu këtë punë të tokës edhe ai e ka pasë një telefon strues
2 [fonetikiisht] Abaz Bruti në Kaçanik e ka ble një shpi. Kanë
3 marrë vesh me atë gjykatësin qysh ka ndodhë këto probleme,
4 edhe ai ua ka kry punën. Edhe u ndal belaja. Kush e ka ble
5 tokën, që ai ia paftë hajrin.

6 PY. A kishte shumë vlerë kjo toka për persona në zonë, për
7 njerëzit e mëhallës e të zonës, ishte me shumë vlerë ajo tokë?
8 PË. Ajo tokë unë thashë është kanë e shkretë, si e ka punu --
9 kushedi sa vjet s'e ka punu kurrkush, veç e kanë marrë do bar
10 aty edhe e hante [E pakuptueshme] q'ashtu. Ky e ka punu krejt,
11 e ka ba livadh Bajram Bruti.

12 PY. Faleminderit. Dëshmitar, ju e kuptoni shumë mirë
13 rëndësinë e tokës për njerëzit, se je vetë njeri i tokës, ke
14 punuar me tokën --

15 PË. Po.

16 PY. Ke furnizuar me dru pylli edhe njerëz të tjerë kështu që
17 rëndësia e tokës është goxha e madhe dhe njihet mirë nga
18 personat që jetojnë në atë rajon, apo jo?

19 PË. Po.

20 PY. Për të folur për disa nga personat që po diskutojmë këtu.
21 Na thatë që Qazim Idrizi ishte komshiu juaj --

22 PË. Po, kështu është.

23 PY. -- ai është komshiu juaj në Llanishtë?

24 PË. Po, po.

25 PY. Për sa kohë e ke njoftë ti Qazim Idrizin?

1 PË. Qazim Idrizin si i vogël ne qaty, e kena të parin komshi,
2 përpara dere e kam shtëpinë e atij. Shumë afër e kam.

3 PY. Kështu që keni dhe të njëjtin mbiemër, a jeni të lidhur,
4 keni lidhje gjaku apo jo?

5 PË. Po, po. Njëjtin mbiemër dhe jemi të një gjakut. Ai i ka
6 mbetë veç një vëlla, një djalë i ka, e tri çika. Ka mbetë i
7 vetëm. Këto i kanë ba presion familja Axhami kësaj familje,
8 dhe vëllaznitë i kanë djegë motit. S'ka, edhe dy motra i ka,
9 s'ka tjetërkund. Qazim Idrizi.

10 PY. Dëshmitar, sa i takon Enver Axhamit, sa kohë ke ti që e
11 njeh Enver Axhamin në fshatin tënd? Enver Axhami dhe familjen
12 e tij, afërsisht për sa kohë, sa kohë ke që e njeh?

13 PË. Enver Axhami e kam kojshi, e jam rritë me të si fëmijë,
14 nxënës i shkollës, e kena shku në shkollë bashkë. Është kanë
15 gjithmonë problematik ky.

16 PY. A është e drejtë të them -- dhe në qoftë se e kam gabim
17 të lutem më korrigjo. Ju na shpjeguat se si Enver Axhami
18 organizoi kidnapimin, sulmimin dhe arrestimin tuaj. A është e
19 saktë kjo?

20 PË. Po.

21 PY. A është e drejtë të thuhet se keni pasur edhe telashe të
22 tjera, jo vetëm këtë problemin që lidhet me tokën, a është e
23 drejtë të thuhet që keni pasë probleme të tjera të shumta me
24 familjen Axhami?

25 PË. Po, shumë mirë e ke bo qetë pyetjen se duhet me i ditë

1 atje Kaçaniku. Enver Axhami thotë se unë jam spiun i Sali
2 Brutit. Unë me Sali Brutin kurrë s'kam folë. Ai në atë kohë
3 motit është kanë komander në Kaçanik. Unë jam kanë në mal, m'u
4 këput nji sharrë e dorës ma zuni lisi, e ishin kanë do dru
5 q'aty pa çekiç [fonetikisht], unë kam mendu që janë të shtetit
6 edhe i kam ngarku. Ai të nesërit ka ardhë te shtëpia, ka thanë
7 "Pse m'i ke vjedhë drutë?" Thashë, "Po s'e kam ditë që janë të
8 tujat se s'kishin shtambel [fonetikisht], çekiç
9 [fonetikisht]". Edhe thashë po t'i paguj. Edhe e lamë q'ashtu,
10 shkojmë.

11 Kam shku me mbjellë nji arë [E pakuptueshme] me nji vlla,
12 me të hy me kallamboq e groshë --
13 PY. Ju lutem ndaloni. Thjesht për çështje të transkriptit, të
14 shënimeve që mbajnë në gjykatë, do t'ju kërkoja që të flisnit
15 më ngadalë.

16 Ju lutem, na shpjegoni ose na bëni një përmbledhje të
17 problemit që keni pasë me familjen Axhami. Pra së pari, ju ka
18 akuzuar se i keni vjedhë drutë atij, e saktë është kjo?

19 PË. Po, po.

20 PY. A është e saktë se ju e keni akuzuar atë që ai ju ka
21 vjedhë lopën?

22 PË. Po. Lopën edhe mëzatin edhe kjo është krejt Kaçaniku e
23 di. Sulë Axhami me Hysen Axhamin, ai është -- një është polic
24 atje ma i vogli. Vëllavi i Sulës, në Prishtinë ish-polic. Një
25 haspi. Këta i kanë vjedhë të dy në komunë të Kaçanikut,

1 hupshin lopë, pa shenjë. Edhe mu ma kanë vjedhë mëzatin, një
2 lopë, kurrë në milici s'e kam [E pakuptueshme]. Se ato s'i
3 kanë [E pakuptueshme].

4 PY. Më vjen keq që e dëgjoj këtë zotëri. Por a është e drejtë
5 të thuhet -- se kushërinjtë e Enver Axhamit e kanë sulmuar
6 vëllain tuaj për një periudhë të gjatë kohe. A është e drejtë
7 kjo? A e kanë ndjekë atë, për shumë kohë vëllain tënd?

8 PË. Po, po. Po.

9 PY. A është e drejtë të thuhet se edhe përpara se sa të
10 fillonte lufta, familja Axhami donte të të kidnaponte, të të
11 rrëmbente ty, dhe këtë ia keni thënë vetë ju hetuesve, a është
12 e saktë?

13 PË. Kështu, kështu është kanë. Edhe -- më kanë rrehë
14 vëllavin, e kanë marrë në mbramje Enver Koka i kanë çu djemtë
15 në Maqedoni i kanë strehu. S'i kanë mshelë në burg. Kështu
16 është kanë.

17 PY. Kjo ka qenë për të shmangur arrestimin nga policia? Për
18 këtë gjë është bërë?

19 PË. Po, kur ma kanë rrehë vllain, tinëza ma kanë rrehë,
20 shpejt në Kaçanik edhe i ka marrë në mbramje edhe Enver Koka
21 edhe i ka çu pa pasosha në Maqedoni, i kanë strehu.

22 PY. A mund t'ju pyes se si e ka emrin vëllai jot? Si quhet ky
23 vëllai që e kanë rrahë këta të familjes Axhami? Adil, ë?

24 PË. Adil.

25 PY. Është më i vjetër se ti, apo më i ri se ti?

1 PË. Ma i vogli.

2 PY. Faleminderit. Enver Axhami, a është përpjekë edhe që ta
3 kidnapojë vëllain tënd më të ri, Adilin? A është e saktë kjo?

4 PË. Po, atë natë me pas kanë me shtëpi, ka pasë deshtë me e
5 marrë edhe atë.

6 PY. Faleminderit.

7 Z. YOUNG: [Përkthim] A mund t'i kërkoj Sekretares që të
8 paraqesë në ekran një tjetër dokument që mbase mund t'ju
9 ndihmojë, dëshmitar. Ju lutem, paraqisni në ekran dokumentin
10 P346 që është prova materiale 346. Dhe referenca në anglishte
11 e këtij dokument është SPOE00091113 deri në 00091130. Faqja
12 SPOE00091124 e transkriptit. Pra është transkripti i datës 2
13 nëntor 2004.

14 PY. A ju kujtohet që keni dhënë dëshmi në nëntor të 2004,
15 dëshmitar? Ju kujtohet që keni dhënë dëshmi si dëshmitar?

16 PË. Po, po.

17 PY. Faleminderit.

18 Z. YOUNG: [Përkthim] Do kërkoja që ky dokument të
19 paraqitet në ekran. Referenca për dokumentin në shqip është
20 SPOE00091131 deri në 00091148, në faqen SPOE00091142.

21 PY. A i keni përpara në ekran këto dokumente? Do kërkoja që
22 dokumentet në shqip dhe në anglisht të paraqiten përkrah njëri
23 tjetrit. Do të përpiqem që të lexoj. Unë do të lexoj në
24 anglisht, por do ju kërkoja që të shikonit në ekran dëshmitar.
25 Dhe shiko në qoftë se është shkruar si më poshtë.

1 A keni thënë që:

2 "Kadri [sipas përkthimit] Idrizi i ka mbajtur paratë" --

3 Z. YOUNG: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë. Mendoj që është
4 gjashtë rreshta nga fillimi.

5 PY. A ke thënë që:

6 "Qazim Idrizi i ka mbajtur paratë në xhepin e vet për dy
7 vjet. Paratë kanë qenë të Enver Axhamit dhe të Bajram Pruthit.
8 Nuk e di arsyen pse i ka mbajtur ai këto pare."

9 A ke thënë këtë gjë në dëshminë e nëntorit?

10 PË. Çka e përmendi diçka Kadri Idrizin? Shkrujте fjala Kadri
11 Idrizi, diçka.

12 PY. Në rregull, do jua lexoj dhe një herë dëshmitar. A ke
13 dhënë dëshmi duke thënë se:

14 "Qazim Idrizi i ka mbajtur paratë në xhep për dy vjet.
15 Paratë kanë qenë të Enver Axhamit dhe të Bajram Pruthit. Nuk e
16 di arsyen pse i ka mbajtur ai paratë."

17 A e ke thënë ti këtë gjë?

18 PË. Paratë kam kallëzuar e ju kallëzoj e të gjithëve kam me ju
19 kallëzuar, paratë me dhunë ia ka çu, me kërcënim ia ka çu në
20 shtëpi, ia ka gjujtë mbrenda në odë të shtëpisë Qazim Idrizit
21 Enver Axhami me gjashtë vetë. Kushërinjtë e vet. Edhe kanë
22 ikë. Kanë ardhë prej Prishtinës tre shqiptarë, i kanë pajtu
23 gjaket, krejt. Kur kanë shku në Kërçovë më Maqedoni, tha një
24 djale, i kishte pasë tri vjet një fëmijë, e kishin lidhë me
25 benzinë e kishin kallë. Qe atë bela ishin kanë ata shqiptarët.

1 Them e kam fal gjakun, tha ju duhej me u pajtu se ka me u ba
2 luftë, s'ban me u vra ndërmjet veti. Enver Axhami e ka sha
3 q'ate doktor Muhamet Pirakën. Me dy shqiptarë, por atyne s'ia
4 di emrin. Ai na ka premtu që kur të fitojë Kosova, ka me më
5 njoftë kush jam doktor Muhamet Piraka, fjala ishte për Enver
6 Axhamin. Kështu është kanë.

7 E kjo është kanë veç një vëlla, Qazim Idrizi, atëherë
8 gjashtë vëllazëni nga pesë-gjashtë gjind i kanë. Janë familje
9 e madhe, ky s'ka mujtë me ba gja Qazim Idrizi. Për atë i kanë
10 mbetë paret në xhep.

11 PY. E kuptova. Sipas teje, mos ishte ndonjë përpjekje kjo e
12 Enver Axhamit që t'i shisnit prapë tokën atij dhe vëllait të
13 tij? Mendon se mund të ishte kjo një tentativë e tij?

14 PË. Jo, toka po të shitet edhe kerri edhe shtëpia e çka do që
15 është krejt e dijnë qeto e kudo që janë, kur ta bajsh
16 kontratën edhe e jep paret, më merr fund ajo punë. Ajo është e
17 jotja.

18 PY. Po. Po, po. Shumica e njerëzve e dinë këtë, por Enver
19 Axhami e pranoi që kishte ndodhur kjo shitja?

20 PË. Jo, Enver Axhami u bo në UÇK, u bo i madh atje edhe thotë
21 çka të them unë. Edhe na ka bo qeta. Në emër të UÇK-së. Pse
22 UÇK-ja s'e dënon këtë?

23 PY. Domethënë, ti po thua që ai do ta merrte atë tokë me çdo
24 kusht në të ardhmen, kështu?

25 PË. Po, po tash e ka marrë. Tash e ka marrë tu na i rrehë

1 djemtë, na e ka rrehë djalin e mixhës. Ia ka thy krahin. E ka
2 rrehë djalin e vëllavit tim me gjashtë vetë, me e pa krejt
3 gjak është kanë. E ka fshehë policia e Kaçanikut dokumentin.
4 Por atë djalin e mixhës, e ka mbajtur burg një vit. A do me i
5 pa fotografitë?

6 PY. Faleminderit. Jo, nuk është nevoja. Në qoftë se është
7 nevoja, i kërkojnë Gjykatësit --

8 PË. Që don me e qit fotografinë, që çka i kanë ba djalit të
9 ri? E kanë prishë tu e rrehë, e milicia s'kanë marrë masa hiç.
10 Veç kanë keshë.

11 PY. Sa shumë e rrahën? E dëmtuan shumë?

12 PË. Mbas lufte e kanë rrehë me drunë gjashtë vetë, e kanë
13 dalë e kanë bo llom. Tjetër më trimi ka dal shpejt aty i ka
14 pështu. [E pakuptueshme] krejt gjak e kanë ba. Ia kanë thy
15 kryet, ku di çka ka të thyme.

16 PY. Mirë. Faleminderit që na e thatë këtë gjë. Tani do kaloj
17 tek tema dy se temën tre e mbuluar në fakt. Tani të flasim se
18 çfarë ndikimi pati ky problem -- kjo belaja e tokës tek ju.

19 A mund të themi që gjatë gjyqit të 2003 dhe 2004, i ke
20 thënë gjykatës së qarkut në Prishtinë se ishe në bela për
21 shkak të tokës, a i ke thënë këtë gjykatës së Prishtinës?

22 PË. Po, po. Kështu është.

23 Z. YOUNG: [Përkthim] Mirë, mund ta shohim në ekran. Se të
24 ndihmon edhe ty edhe Gjykatësit. Atëherë, shohim provën
25 materiale 342. Pra, është prova materiale 342. Referenca në

1 anglisht është SPOE000897232 -- pra deri në 00089766, dhe
2 faqja që duhet është 00089757, anglishtja. Ndërsa shqipja
3 SPOE00089767 deri në 00089814, faqja 38, në shqip 00089804. Ja
4 do presim që të shfaqet në ekran.

5 PY. E sheh që e ke shqipen majtas? Majtas, ke shqipen. Dhe
6 djathtas është anglishtja.

7 Lexoni anglisht, dini anglisht?

8 PË. Jo, s'di.

9 PY. As unë s'lexoj shqip, kështu jemi barabartë. Shohim
10 ekranin më mirë. E sheh aty që është në paragraf, duhet të
11 jetë diku paragrafi i katërt. A i keni thënë kështu gjykatës -
12 - më falni do ta filloj një më lart. Në mes të faqes, tek mesi
13 i faqes:

14 "Ne patëm probleme për dy vjet për shkak të kësaj toke.
15 Unë po e tregoj tamam ashtu siç ndodhi dhe kishim probleme për
16 dy vjet."

17 Kështu.

18 PË. Po, po. E qartë është, e qartë.

19 PY. Çfarë ke dashë të thuash kur ke thënë ne patëm probleme?
20 Çfarë ke dashur të thuash me këtë ne patëm probleme?

21 PË. Na patëm probleme të thashë se kjo është familje e madhe
22 kurse kjo e Qazim Idrizi e ka veç një djalë e tri çika. S'ka
23 mujtë më me ia çu paret Enverit. Enverit ia ka çu, por Enveri
24 ia ka çu apert në shtëpi. S'i ka marrë paret.

25 PY. Kuptova. E morëm që keni pasur probleme me Qazim Idrizin,

1 me komshiun dhe kushëririn mbase. Po tek ti personalisht,
2 çfarë pasojash pati kjo gjë?
3 PË. Te unë mu më ngarkon me Arkanin, kinse unë i kam çu
4 paret, kishte Arkani ka thanë me shtatë kerre kena me ardhë me
5 ju lidhë, krejt familjen Axhami. Kemi me ju ngre zharrë
6 teposhtë deri në Kaçanik. Kena me ju burgosë, kena me jua
7 marrë paret. Ka rrejtë Habib Koka këtë e ka mbaru këtë, qysh i
8 thojnë, Habib Koka na i ka ba krejt këto sherre. E atij i kanë
9 lindë këto gjana. Se këto s'kanë mujtë me ba qeshtu. Ai ka
10 punu me policinë serbe, edhe ma ka shti emrin aty. Tash s'e
11 hek dreqi. Krejt shahen, jo krejt nuk shahen. Gjindja s'është
12 shajtë.

13 PY. Zotëri. E kuptova. A mund të themi që problemi që ke
14 pasur me Enver Axhami konkretisht ishte për shkak të
15 gënjeshtreve që ai ka përhapte për ty, pra për këtë ke pasë
16 probleme me Enver Axhami, për gënjeshttrat që ai përhapte,
17 kështu?

18 PË. Po ti po e sheh. Për tokë më akuzon mue, e Arkani mos e
19 hekte prej goje hiç. Unë kam qenë [E pakuptueshme] që Arkan
20 s'ka pasë kurrë. Edhe Sami Axhamit që ia ka thanë qete "Agimi
21 më ka rrehë me policët", kjo është gënjeshtër se s'është e
22 vërtetë. Edhe që ka dhanë policë, ka punu Agimi edhe thotë
23 roje pylli. Këto s'janë kurrkund të shkrueme me emër aty. Ky e
24 ka qitë prej vetit, veç me më hupë. Atë e dinë krejt Kaçaniku
25 qe tash. S'është tu i folë kurrkush atij më. Le të më

1 kallëzojnë shokët. Se iu ka ba dam edhe ai te pa, u ka qitë
2 punë edhe UÇK-së. Njeri i keq.

3 Këtë punë u kanë deshtë këta me dalë me më vra mu para
4 luftës -- jo me ushtri e me kësi me marrë hak.

5 PY. Më fal, do të ndaloja shkurtimisht që ta kuptojmë. Është
6 e drejtë të themi për UÇK-në që ju pas luftës keni thënë që
7 UÇK-ja -- si institucion e shkarkoi Enver Axhamin. E largoi
8 Enver Axhamin, kështu?

9 PË. Po, po. Prej shokëve kam ndi, s'është tu i folë kurrkush.
10 Ka ba dam të madh ai te UÇK-ja, e ka pa çfarë dami ka ba?

11 PY. Shohim një paragraf tjetër, por tek e njëjta faqe. Do ju
12 lutesha gjykatësve diku katër-pesë paragrafë poshtë. Në
13 anglisht thuhet:

14 "Unë s'kisha gjë kundër UÇK-së. Apo shqiptarëve të tjerë.
15 Unë kisha probleme vetëm me këta persona, dhe kjo ishte një
16 çështje private jo çështje shtetërore." --

17 PË. E saktë, q'ashtu është.

18 PY. -- e ke thënë kështu?

19 PË. Po, saktë është.

20 PY. Vërtet është?

21 PË. Vërtetë është.

22 PY. Çfarë ke dashë të thuash ti kur thua kjo ishte çështje
23 private jo çështje shtetërore? Çfarë ke dashe të thuash me --
24 se mbase duket pak pyetje kështu, por duhet ta dimë.

25 PË. Unë ta bëj të kjartë. Ky ka deshtë me dalë më vra -- jo

1 në emër të UÇK-së po fol ai, se ai kur më arrestoi mue, një e
2 dy ja bajke, "UÇK? Ke punë me UÇK-në." Unë s'po e marr vesh
3 këtë kështu.

4 PY. Tani kam dhe temën e tretë. Pra ti e ke bërë të qartë dhe
5 ia ke thënë Prokurorisë nuk është çështje UÇK-je kjo, nuk ka
6 lidhje kjo me UÇK-në, kështu?

7 PË. Jo, nuk ka, nuk ka.

8 PY. Faleminderit. Pajtohemi pra bashkë që s'ishte çështje
9 UÇK-je.

10 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtoj, sepse kjo pyetje është
11 bërë disa herë.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdojmë tek
13 pyetja tjetër.

14 DËSHMITARI: Faleminderit. E ke bo pyetjen me vend.

15 Z. PACE: [Përkthim] Je shumë i sjellshëm.

16 PY. Edhe në 2020, kur të ka bërë pyetje Prokurori, a të kam
17 pyetur për të njëjtat çështje dhe të njëjtat i ke thënë
18 Prokurorisë që ka qenë probleme toke. Edhe sot këtë the, ka
19 qenë problem toke --

20 PË. Kjo është. Për qetë kam ardhë unë.

21 PY. -- kur erdhe në Hagë pra.

22 PË. Po, për qetë kam ardhë këtu.

23 PY. Dua të të kujtoj çfarë ke thënë në një dëshmi edhe do
24 shohim një intervistë që i dhënë Prokurorisë.

25 Z. YOUNG: [Përkthim] Që në anglisht është prova materiale

1 P370.2 -- ndërsa në shqip është 370, po. Referenca në anglisht
2 është 071922-TR-ET Pjesa 2. Ndërsa shqipja është faqja 10, që
3 ka numrin 071922-TR-AT Pjesa 2 e Rishikuar.

4 PY. Shohim dokumentin që do dalë përpara në ekran. Ju
5 faleminderit Sekretares. E sheh shqipen majtas?

6 PË. Po, po.

7 PY. Djathtas është anglishtja.

8 Z. YOUNG: [Përkthim] Duhet të shkojmë pak më poshtë tek
9 anglishtja.

10 PY. Unë po shoh anglishten. I keni thënë Prokurorisë:

11 "... e kanë marrë vesh krejt që krejt shkak i tokës u bo
12 qe ky problem tek unë."

13 E keni thënë kështu në shqip?

14 PË. Po, kështu është. Krejt shkaktare është qe kjo tokë.

15 PY. Dhe ndonëse duket -- është e kuptueshme, ndonëse kjo
16 është e kuptueshme, kur thua ti e kanë marrë vesh krejt që
17 krejt shkak i tokës u bë që ky problem tek unë dhe asgjë
18 tjetër", ke thënë, "dhe asgjë tjetër".

19 PË. Po.

20 PY. Çfarë ke dashë të thuash "dhe asgjë tjetër"?

21 PË. Po, unë jam kanë në Kaçanik mbas luftës. S'po më kujtohen
22 datat, por këto datat i harroj, mbasi kam ndejtë tri vjet
23 mshelë në shtëpi, atë s'e ka ditë kurrkush që jam, veç e ka
24 ditë babëgjyshi jem edhe një motër e grusë time, edhe motra
25 ime, vëllavi jem edhe kurrkush tjetër. Kam ndejtë në izolim,

1 prej këtij kam ndejtë. Se ky të më shkrun gazetë "e kërkon
2 UÇK-ja Agim Idrizin". Po çfarë arsye më kërkon, për tokë? Ky
3 më ka ba dam të madh. Ky ma ka shkatërru jetën e krejt
4 familjen. Shumë keq.

5 PY. Problemet që bëri kjo toka, na the që jeni përpjekur edhe
6 t'i zgjidhni probleme, kështu?

7 PË. Po, ju thashë kanë ardhë dy shqiptarë, janë të Kaçanikut,
8 kemi majtë mbledhje, s'mund t'ia kthy paret Enver Axhamit.

9 Edhe të Prishtinës janë ata kanë thanë s'ban me u vra na ndër
10 veti se kena me bo luftë. Çka po don ti me të kallëzu ma tej?
11 E kishin djegë një fëmijë tri vjet e kishin lidhë për një
12 dardhe me benzinë tha e kishin kallë. Qe atë gjak ishin çu ajo
13 familja ia kishin falë. E ky tha i ka hy, Qazim Idrizit ia ka
14 flugë paret mbrena në shtëpi dhe ka ikë. S'është kjo punë.
15 Këto janë gjana të tmerrshme.

16 PY. Më duket se the që ka qenë një person që është përpjekur
17 t'i zgjidhte problemet më duket sikur the që u përpoq një
18 njeri i nderuar me emrin Muhamet, ishte doktor më duket me
19 emrin Muhamet që u përpoq t'ju ndihmonte por s'ia doli dot
20 mbanë, kështu?

21 PË. Po, ai ka ardhë me dy shqiptarë, atyne s'ia di emrin ata.
22 Ata janë dikund në pozita me siguri, punojnë diku nalt. Si një
23 akt ky e ka prezantu emrin e vet, ka thanë "Unë jam doktor
24 Muhamet Piraki, mundeshi me pritë sa të fitojë Kosova, ka
25 thanë ka me më njoftë Enver Axhami kush jam, doktor Muhamet

1 Piraki". Po këtu ishin kanë në 1999 një parti. S'kam mujtë me
2 u marr vesh me kurrkënd. Ku shkoj unë në Kaçanik policia me u
3 lajmëru te shqiptarët? Kurrrgja tha s'mujna me ju ba. Çka me ba
4 me ta unë?

5 PY. Ke përmendur dhe një person me emrin Habib Koka. Po Habib
6 Koka mos u përpoq që të ishte si tip koristi apo ndërmjetësi
7 mes këtyre palëve të ndryshme? Si e kuptove ti, ky Habib Koka
8 mos po përpiqej që të ndërmjetësonte mes palëve?

9 PË. Jo, ky ka hangër një duboki me mish, i kam zanë në
10 shtëpi. 5000 ia kanë ble Niva-n e kuqe dhe kanë ba muhabet
11 gjithë natën me familjen Axhami dhe [E pakuptueshme]. Deri ora
12 katër, unë i kam zbulu, sot jam qetu. Se i kam zbulu. Kanë
13 deshtë me na ba keq këta me ushtrinë serbe a me policinë. E
14 kanë lajmëru Bajram Brutin, e kanë lajmëru. E di çka janë kanë
15 tu i ba Bajram Brutit? Habib Koka. Unë i di tjetër gjana. Për
16 qete kam ardhë këtu.

17 Bajram Bruti i ka lajmëru që mbajnë armë, me një vlla.
18 Tani ka thanë, jo një i Kobliqit ka thanë. Jo i Kobliqit nuk
19 është ai, ky është vetë. Habib Koka.

20 PY. Ishte kjo akuzë e rreme sipas teje?

21 PË. Po, akuzë e rreme është kanë kjo, se Bajram Bruti është
22 një njeri, një familje që e njohin krejt Kaçaniku, që s'i ka
23 ba keq kurrë kurrkujna. Janë punëtorë.

24 PY. Por të fokusohem tek ti si person, po ti vetë, a u
25 përpoqe t'i zgjidhje problemet duke folur me një gjyqtar për

1 këtë problemin me tokën? Ti vetë a shkove te ndonjë gjyqtar
2 për të folur për këtë çështjen e tokës?
3 PË. Jam kanë në Ferizaj rastësisht, kam shku me një shqiptar,
4 ai ka vdekë. Tash s'është gjallë. Edhe veç i kam kallëzu që
5 kena ra në bela, kështu, kështu, kështu. Qysh është kanë puna,
6 s'kam rrejtë kurrgjë. Ai ka thanë le të vijë Abaz Bruti qe ai
7 që e ka ble tokën, edhe ai shitësi i tokës, Qazim Idrizi. Le
8 të vijnë tek unë në Prishtinë, edhe unë i kam kallëzu. Kanë
9 shku në Prishtinë, kanë kry punë, kanë ardhë në shtëpi, kanë
10 dalë e kanë punu tokën. Qe atëherë u punu toka. Edhe u tërhjek
11 Enver Axhami prej tokës. Por më ka shti në ligë të keqe, më ka
12 shti mu. Më ka shti tek Arkani. Arkani s'i jepet hiç. Unë nëse
13 pa me ndejtë me Arkanin, të delë të kallëzojë dikush ku më ka
14 pa.
15 PY. Fokusohemi te ky gjyqtari. Ky personi, të dha ndonjë
16 këshillë, mos tha t'ia ktheje paratë e shitjes Axhamit, të tha
17 ndonjë gjë të tillë?
18 PË. Jo, veç ka thënë të vjen Qazim Idrizi, Abaz Bruti në
19 Prishtinë edhe du me bisedu me ta qysh është shitë toka, që
20 kush e ka ble. Edhe ata i kanë kallëzu rastin vetë, unë s'jam
21 kanë aty. Edhe, i ka ba telefon Habib Kokës, Habib Koka sikur
22 sonte ka ndejtë me Axhamët mbas darke deri ora 4 në sabah. Të
23 nesërit i ka ardhë lajmi me çu paret te Enveri. Edhe Enveri u
24 çmend kur i ka pa paret te shtëpia. S'ka deshtë me i marrë.
25 Habibi i ka thanë Arkani, qeshtu është kjo.

1 Thashë Habibin duhet me e kapë, me e mshelë në burg të
2 përjetshëm, me gjithë Enverin. Se këta të dy i kanë ba këto
3 gjana. Edhe sot të vijë këtu, merrni përgjigje -- pa shitë
4 kurrgjë.

5 PY. A mund të themi se ia ke shpjeguar çështjen gjyqtarit, a
6 i the ti gjyqtarit që mund të bëhet, mund të shkojë edhe në
7 polici, kjo puna e tokës? A ia the ti gjyqtarit, apo ta tha
8 gjyqtari ty që: shiko se kjo puna do shkojë deri në polici.

9 PË. Jo, ne s'i kena çu në polici, se ne e kana ditë që i
10 rrehin, i burgosin, e send u bajnë keq. Prandaj i kena çu te
11 Habib Koka, ky ishte Habib Koka ma mirë, ky s'e zgjidhi
12 problemin. Edhe tash u desht me shku në gjykatë, Abaz Bruti,
13 Qazim Idrizi e kanë zgjidhë këtë problem. Dhe unë. Po mu më
14 kanë shti në listë me më hupë, se mu s'më kanë dashtë edhe
15 kështu.

16 PY. Nuk ka rëndësi cilat kanë qenë mendimet e komandantit
17 polic, po ti vetë si mendoje, a mund të shkonin në burg këta
18 Axhamët për shkak të kësaj, për shkak teje, për shkak të këtij
19 problemi?

20 PË. Kushdo që është këtu, kushdo që është në gjyq, gjyqtar, a
21 polic, kur ta ndijë, ka me thanë që duhet kjo punë në gjyq me
22 dalë. Edhe në gjyq nuk i kanë arrestu këto, se i ka marrë
23 paret. A mos me i marrë paret, atëherë ka shku në gjyq, e
24 kishte mbajtë burgun, ma keq. Po ai u tërhjekë [E
25 pakuptueshme]. E ka pritë vaktin e luftës.

1 PY. Sa para mori dhe për kë e ke fjalën tani?

2 PË. 24.000 marka e ka shitë Qazim Idrizi Bajram Brutit. Kurse
3 Enveri është ai i cili e kërcënon non stop Qazim Idrizin edhe
4 ia ka gjujtë paret në shtëpi natën, dhe ka ikë. E din Kaçaniku
5 krejt, unë s'kam ça me rrejtë këtu. Për atë e kam lypë me dalë
6 në publik, du me e kallëzu krejt këtë histori.

7 PY. Nëse do përfshihej policia në këto punë, do kalonte në
8 tjetër nivel kjo punë, apo jo?

9 PË. Po, ne kena pasë një polici që për kësi gjana, i kishin
10 rrehë, pse i ki hy mbrenda, pse ke ngushtu njeri mbrenda, ke
11 hy mbrenda, ke flugë paret edhe ke ikë? Normal që të rrehin,
12 kushdo që është në polici të rreh. Te ne, se këtu në Evropë
13 s'e di. Toka blihet me qejf, jo me gjetë një njeri me e gjetë
14 pa krahë. Veç një vëlla, një djalë, tri çika. Edhe tash mbas
15 lufte tash ia ka marrë shtëpijat, çfarë shtëpie, 400.000 euro
16 i ban shtëpia. Ia kanë marrë, ia kanë prishë kulmin, ia kanë
17 ndreqë vetë. Mos me ditë shtëpitë -- qe ajo shtëpi. Pse s'e
18 qiti në gjyq Bajram Brutin dhe Agim Idrizin? Edhe me gjyq të
19 Kosovës tash i kishim fillu këto punë, por s'ka guxu me shku
20 në gjyq. Se e di që e mshelin në burg. Edhe prandaj unë kam
21 ardhë këtu. E kam pritë që më ka qitë në gjyq, s'është tu më
22 qit në gjyq.

23 PY. Nëse më lejoni, pothuajse mbarova, nuk kam dhe shumë.

24 Besoj për --

25 PË. Urdhno, veç fol, qe pyetjet të mira m'i ke dhënë.

1 PY. Faleminderit. Do mbarojmë shumë shpejt. A mund të themi
2 që marrëdhënia mes familjes tënde dhe familjes së Enver
3 Axhamit u përkeqësua kryesisht për punën e tokës, pra kjo
4 është? U prish marrëdhënia për shkak të tokës, kështu?

5 PË. Po, janë prishë marrëdhëniet edhe këto veç keq më kanë
6 ba. Unë tash i kam katër izveshtoja [fonetakisht] te policia
7 serbe për pushkatim. Një e kam që më kanë qitë në varje në
8 Sihalicë. Është njëri gjallë ka ardhë më ka nxjerrë. Shqiptar.
9 S'e kam pa që kanë ardhë kush me më pështu, por veç kur e ka
10 çelë derën e kam pa më ka zgjidhë. Kështu është kanë.

11 PY. A mund të themi që kjo ngjarje nuk të preku vetëm ty, por
12 i gjithë fshati u zemërua? Pati një zemërim në gjithë fshatin
13 për shkak të këtij problemit të tokës, me njëri-tjetrin.
14 Krijoi një farë brengosjeje kjo në fshat, mund të themi
15 kështu?

16 PË. Po, [E pakuptueshme] që tash pas lufte ma ka ndjekë
17 djalin e mixhës, ia ka thy krahun djalin, i ka mbajtur një vjet
18 burg. E ka përzënë prej shtëpie [E pakuptueshme] të kërcënu.
19 Ia ka marrë dy shtëpi, tokën, krejt ma të mirën tokë. E ka
20 ndjekë prej katundit. I ka thanë policisë në Kaçanik nëpërmes
21 telefonit, mos hajde me marrë se unë e kam liru stacionin e
22 policisë, se këtu ka pasë serbë. E në pas mbetë ai me liru,
23 mos [E pakuptueshme] na kish gjetë neve. Edhe policia është
24 kanë keq, s'kanë shku me marrë hiç. Ai e ka lanë shtëpitë,
25 tokë, krejt, ka shku në Ferizaj. Me ardhë me i ba këto gjana,

1 duhet me dalë policia e Kosovës zot. Ai ka kanë në UÇK, le të
2 [E pakuptueshme] UÇK-ja. Jo me marrë toka të huaja me zor.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

4 Z. Young, i kemi diskutuar tre-katër herë të paktën këto
5 gjëra.

6 Z. YOUNG: [Përkthim] Unë pothuajse mbarova. Shpresoj
7 brenda kohës që ka mbetur. Se po e shoh orën.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, në qoftë
9 se do nxjerrë informacion, të paktën nxirr informacion të ri,
10 sepse po përsërit të njëjtat gjëra.

11 Z. YOUNG: [Përkthim] Faleminderit.

12 PY. Dëshmitar, të thashë që kam dhe diçka për të trajtuar,
13 besoj se e mbylla dhe me temën e tretë në fakt. Më falni një
14 çast.

15 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

16 Z. YOUNG: [Përkthim] Që të bëjmë diçka të qartë -- do të
17 doja që të shfaqej në ekran -- më falni. në fakt s'e kemi
18 numrin e provës materiale për materialin që dua të shohim në
19 ekran, por do të jap numrin ERN.

20 Pra, ju i keni thënë Prokurorisë që UÇK-ja nuk ka pasur
21 gisht. Dhe do shohim materialin SITF00429466. Shqipja është
22 SITF00429464, vazhdon pastaj SITF00429493 me faqen
23 SITF00424616 [sipas përkthimit] ose ndryshe faqja 3. Kam edhe
24 ERN-në për anglishten, s'e kisha të plotë pak më herët,
25 SITF00429430 deri në faqen 00429493 dhe faqja jonë konkrete

1 është SITF00429430, dhe është në disa gjuhë. Faleminderit.

2 Shohim në ekran.

3 PY. Janë disa deklarata që e ke dhënë për UNMIK-UNMIK këto --

4 PË. Po.

5 PY. -- kjo është ballina, por po të hyjmë brenda në dokument

6 do shohim fjalën që dua të diskutojmë, mbaron me 466

7 anglishtja -- ndërsa shqipja më duket mbaron me 616.

8 Djathtas kemi anglishten. Shkojmë pak më poshtë. E sheh

9 që ke përmendur gjashtë -- më falni, dhe një herë është e

10 njëjta referencë në shqip.

11 E shihni tek shqipja, që ke përmendur se ka pasur 16

12 probleme a 16 çështje? Dhe pas kësaj, e ke bërë të qartë dhe

13 ke thënë, i ke thënë UNMIK-ut pra,

14 "UÇK-ja nuk kishte dijeni se Enveri më arrestoi në mes të

15 natës për të më marrë në pyetje."

16 Ia ke thënë këtë UNMIK-ut?

17 PË. Po.

18 PY. Është e vërtetë apo jo? UÇK-ja nuk e dinte.

19 PË. Është e vërtetë se ky kish ikë prej UÇK-së, kish ra

20 poshtë, ata s'e kanë pa çka është tu më bo. Edhe ky më ka

21 mbajtur në vëzhgim veç. Pa prezencën e UÇK-së. Ka deshtë me

22 likuidu, mos me ditë kurrkush ku jam unë, ato send.

23 PY. Faleminderit. Na ndihmove shumë. Unë nuk kam më pyetje.

24 PË. Faleminderit edhe prej juve.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë. Do

1 bëjmë pushimin e paradites. Do kthehemi në orën 11.30.

2 Dëshmitar, do bëjmë gjysmë ore pushim tani, dhe pastaj do
3 kthehesh në sallën e gjyqit për të vazhduar me dëshminë.

4 DËSHMITARI: S'ka problem. Kur të doni, veç thirrni. Unë
5 jam i gatshëm me ardhë.

6 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Takohemi në
8 orën 11.30.

9 --- Pauza fillon në orën 11.01

10 --- Seanca rifillon në orën 11.30

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Palëve do ju
12 kërkoja që jepni parashtrimet e tyre sa i takon videolidhjes.

13 Z. KEHOE: [Përkthim] Z. Misetiç ka trajtuar dhe ka lexuar
14 parashtrimin, kështu që doja që t'i jepja fjalën atij.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, kundërshtojmë.
16 Dëshirojmë që të dëgjojmë se cilat janë arsyet për sa i takon
17 parashtrimeve.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë në
19 qoftë se doni që të bëni parashtrime me shkrim, i takon që
20 duhet të përcaktojmë edhe një afat për dorëzimin e
21 parashtrimeve deri të enjten.

22 A ka ndonjë kundërshtim lidhur me këtë?

23 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ne nuk kemi parashtrime për të
24 bërë sa i takon kësaj pike.

25 Z. TULLY: [Përkthim] Ne nuk kemi kundërshtim sa i takon

1 parashtrimit me shkrim të një parashtrimi. Kështu që jemi në
2 rregull me këtë.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë do të
4 vendosim për të enjten që të gjitha palët në qoftë se keni
5 mund t'i dorëzoni parashtrimet tuaj ame shkrim deri të enjten
6 dhe pastaj deri të hënën do të marrim një vendim Trupi Gjykses
7 sa i takon kësaj kërkesë të Prokurorisë.

8 Znj. Sekretare, ju lutem silleni dëshmitarin në sallë.

9 Më kujtuan kolegët që të enjten kemi vetëm dy seanca.
10 Kemi dy seancat e para. Do punojmë deri në drekë.

11 [Dëshmitari vijon dëshminë]

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
13 uleni, Dëshmitar.

14 DËSHMITARI: Faleminderit.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jemi gati që
16 vazhdojmë më tej.

17 Z. Misetiç, nga Mbrojtja e z. Thaçi do ju bëjë pyetje.

18 DËSHMITARI: Urdhnoni.

19 Pyetje të palës tjetër nga Z. Misetic:

20 Z. MISETIC: [Përkthim]

21 PY. Mirëdita, Dëshmitar.

22 PË. Mirëdita.

23 PY. Siç e tha Gjykatësi Smith, unë jam z. Misetic, jam
24 Mbrojtja e z. Thaçi dhe kam disa pyetje për ju sot paradite.

25 PË. Faleminderit.

1 PY. Përpara sesa të futemi në thelbin e dëshmisë suaj,
2 dëshiroj që të sqaroj diçka që ka të bëjë me historikun tuaj.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Kërkoj që të paraqitet në ekran
4 prova materiale P368 në faqen SPOE00091734. Dokumenti në
5 gjuhën shqipe ka numrin e provës materiale 368-AT dhe
6 SPOE00091761 deri në 62.

7 PY. Dëshmitar, ky është raporti i një dëshmie që keni dhënë
8 juve para gjykatës në vitin 2004. Dëshiroj që të sqaroj diçka
9 lidhur me këtë dëshmi.

10 PË. Urdhno.

11 PY. Shpresoj që të jetë në ekran edhe në shqipe. Besoj që
12 është diku nga fundi.

13 Ju bëhen disa pyetje nga gjykatësit, do t'i lexoj këto
14 pyetjet dhe do t'ju pyes pastaj në qoftë se ky informacion
15 është ende i saktë. Gjykatësi ju thotë:

16 "Kur keni studiuar në shkollë, kur keni shkuar në
17 shkollë, a keni mësuar serbisht?"

18 Përgjigja juaj është:

19 "Po".

20 Gjykatësi ju pyet që:

21 "A e lexoni dhe a e kuptoni serbishten?"

22 Përgjigja:

23 "Po".

24 Pastaj ju bëhet pyetja tjetër:

25 "Në qoftë se mund të lexoni dhe të shkruani në shqip?"

1 Përgjigja është:

2 "Po".

3 Gjykatësi pastaj ju pyet:

4 "Pra, ju mund të lexoni dhe mund të shkruani edhe në
5 serbisht edhe në shqip?"

6 Ju thoni që:

7 "Po, unë i njoh dhe i lexoj, i njoh shkronjat, por e kam
8 të vështirë të shkruaj".

9 "Mund të flasësh dhe mund të lexosh në të dyja gjuhët"
10 pyet gjykatësi.

11 Dhe pastaj ti thua "Po".

12 A është ky informacion i saktë apo jo?

13 PË. Që ne kur kena mësu serbisht, më kujtohet një mësues ka
14 pasë ardhë, ka nejt pak, se u prish situata në luftë a s'më
15 kujtohet. Dhe më s'kena mësu. Kena mësu anglisht dhe anglisht
16 as mësuesi s'më kujtohet.

17 PY. Po ju pyes që a janë këto përgjigjet që i keni dhënë
18 pyetjeve të kryegjykatësit në çështjen e 2004?

19 PË. Po, po. Po s'kena mësu serbisht.

20 PY. Prokurori sot paradite ju pyeti në qoftë se lexoni
21 serbishten. Dhe përgjigja ishte jo.

22 PË. Jo, nuk i di mirë germat.

23 PY. Më lejoni që të përfundoj pyetjen njëherë pastaj
24 përgjigjuni ju lutem.

25 Pra, thjesht dua që të më thoni në qoftë se përgjigja që

1 keni dhënë përpara Gjykatës Themelore janë të vërteta që mund
2 të lexosh edhe mund të shkruash serbisht. Ndërkohë që sot
3 paradite pyetjes së Prokurorit thatë që nuk kuptonit serbisht.

4 PË. Jo, jo, s'di mirë serbisht edhe nuk di me shkru mirë. Se
5 s'mund të kuptoj krej mbiemrat.

6 PY. Dëshmia juaj është që pasi u liruat ke qëndruar për ca
7 kohë në shtëpinë e Boban Krasniqit, kështu?

8 PË. Po.

9 PY. Çfarë gjuhe fliste ky Boban Krasniqi?

10 PË. Shqip fol mirë ky, në gjuhën shqipe.

11 PY. Po serbisht a flet?

12 PË. Jo, veç shqip fol.

13 PY. Pra, Boban Krasniqi çfarë kombësie ka?

14 PË. Është serb po ka ndejt me shqiptarët shumë. Përpara kanë
15 punu me policë shqiptarë bashkë e ka mësuar gjuhën mirë. Janë
16 kanë me një kohë moti.

17 PY. Po ti the që ai flet vetëm shqip?

18 PË. Po.

19 PY. Ky është serb që nuk flet serbisht, kështu i takon?

20 PË. Ka fol shqip, fol ma shumë me shqiptarë. Me serbët ai
21 s'fol shqip.

22 PY. Në rregull. Do t'ju tregoj një dokument që ia treguan
23 kolegët e Prokurorisë edhe më herët sot paradite.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] E kam fjalën konkretisht për
25 provën materiale SPOE00093211 deri në 00093212.

1 PY. Ju i tha Prokurorit që këtë dokument e keni parë për herë
2 të parë para një jave kur u takuat me Prokurorin, kështu?

3 PË. Po.

4 PY. Është e drejtë të thuhet se askush nuk jua ka përmendur
5 këtë listë kur ke qenë i arrestuar në Bob dhe në ato fshatrat
6 e tjerë, nuk jua ka përmendur njëri këtë listën atëherë,
7 kështu?

8 PË. Listën e këtyne të burgosurve apo?

9 PY. Listën që ke përpara në ekran. Askush nuk ta ka përmend
10 atëherë këtë listën, kështu?

11 PË. Këtë listë e ka lexu Enver Axhami. I ka lexu do shqiptarë
12 ça i kishte në listë. Qaty i kam ni. Tjetërkund s'i kam ni
13 këto lista. Ai i lexojke.

14 PY. Do i diskutojmë edhe emrat dhe në qoftë se emrat që ju i
15 keni përmendur janë të njëjta si emrat që janë këtu në listë?
16 T'jua bëj ndryshe pyetjen. Në atë kohë askush nuk të ka
17 akuzuar ty se punoje për sigurinë vendore, kështu?

18 PË. Jo. Emri im s'u përmend.

19 PY. Në rregull. Do t'ju tregoj një tjetër dokument që jua
20 tregojë edhe kolegu i Prokurorisë.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Është dokumenti IT-05-87. Dëshiroj
22 që të paraqiten të dy dokumentet, domethënë, dokumenti në
23 serbisht dhe dokument në shqip. 6D484-E është dokumenti
24 tjetër. Dokumenti në serbisht nuk ka E. Kalojmë tek faqja
25 tjetër me germa latine.

1 PY. Dëshmitar, kolegu i Prokurorisë ju bëri disa pyetje më
2 herët. Edhe për këtë dokument ju thatë që e keni parë për herë
3 të parë javën që shkoi, një javë më përpara kur ju u takuat me
4 Prokurorinë për t'u bërë gati për këtë proces, kështu?

5 PË. Po, po.

6 PY. Askush nuk e ka përmendur një dokument të tillë, nuk jua
7 ka përmendur që ekzistonte ky dokument kur ju kanë arrestuar
8 në vitin 1999, kështu?

9 PË. Po.

10 PY. A e njihni Jenuz Shurdhani se ju e keni përmend disa herë
11 edhe gjatë dëshmisë tuaj?

12 PË. Jenuz Shurdhanin e njoh shumë mirë, sikur e njoh veten,
13 se qatje jam rrit. Edhe ai ka qenë një djalë i vogël. Na
14 njihnin numereti [fonetikiçht] krejt.

15 PY. A e dini ju se Jenuz Shurdhani ka thënë se këto lista nuk
16 janë zbuluar nga UÇK-ja, nuk kanë qenë në dijeni të UÇK-së
17 derisa është futur UNMIK-u në Kosovë?

18 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ndoshta do ishte
19 mirë që kolegu të përmendte informacionin pa e thënë se kush e
20 ka thënë këtë informacion.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, patjetër. Mund ta vendos edhe
22 përpara në ekran, në seancë private në qoftë se është e
23 nevojshme. Dokumenti është 074301-TR-ET Pjesa 10, e redaktuar,
24 faqja 11, rreshtat 21 deri në faqen 12, rreshti 5.

25 "PË. Pas luftës, unë e gjeta këtë listë në arkivin e

1 rajonit të policisë në Kaçanik.

2 "PY. A ju kujtohet në qoftë se dokumente ose
3 informacione të tillë lidhur me shqiptarët që kanë punuar me
4 serbët janë zbuluar gjatë luftës apo pas luftës?"

5 "PË. Jo".

6 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, sa për të qenë
7 të saktë, ky nuk është një informacion që është dhënë nga
8 Jenuz Shurdhani. Por është dhënë nga dikush tjetër. Ndoshta do
9 ishte mirë që të sqarohet kjo.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Më lejoni një çast, ju lutem.

11 PY. Ndërkohë që shohim këtë për ta sqaruar, dëshiroj që t'ju
12 lexoj përfundimet e Gjykatës Themelore lidhur me këto lista.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Për Sekretaren është dokumenti
14 03228 deri në 03226 në faqen 032278.

15 PY. A e keni lexuar aktgjykimin e gjykatës në çështjen për të
16 cilën keni dhënë dëshmi në vitin 2004?

17 PË. E kam lexu.

18 PY. E keni lexu, kështu? Do të lexojmë pjesën përkatëse që
19 është drejt fundit të faqes ku thotë që:

20 "Mbrojtja ka dorëzuar dy lista. Një është një listë
21 pagese dhe një listë tjetër pretendohet që të jetë një listë e
22 policëve që kanë punuar me serbët".

23 Z. PACE: [Përkthim] E kuptoj që Avokati është në mes të
24 bërjes së një pyetjeje për dëshmitarin, megjithatë ne
25 kundërshtojmë që ky informacion t'i bëhet me dije dëshmitarit.

1 Ne nuk shohim ndonjë vlerë apo relevancë që përfundimet e një
2 gjykate t'i vihen në dispozicion dëshmitarit. Ndërkohë që kjo
3 gjykatë, ky Trupi Gjykses duhet të arrijë në përfundimet e
4 veta.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni, z.
6 Misetiç.

7 Z. MISETIC: [Përkthim]

8 PY. Mirë atëherë vazhdojmë dhe njëherë. Siç pretendohet nga
9 Prokuroria, në qoftë se UÇK-ja do të kishte informacioni ose
10 në qoftë se do të kishte në zotërim listën në atë kohë dhe do
11 t'i përdorte atë si bazë për ndalimin e personave, ata pa
12 diskutim që do ja kishin thënë këto pretendime të ndaluarve.

13 Sikurse u tha nga Prokurori, Jenuz Shurdhani ka dëshmuar
14 që nuk ka absolutisht asnjë lloj informacioni se pse janë
15 mbajtur të burgosurit atje. Në çdo rast nuk është bërë asnjë
16 pretendim që këto lista janë përdorur nga UÇK-ja si bazë ose
17 shkak për arrestimin e personave".

18 Gjykata përfundon duke thënë që:

19 "Edhe në qoftë se këto lista janë të saktë dhe të
20 besueshme, ato nuk është provuar që kanë shërbyer si bazë për
21 ndalimin apo kidnapimin e personave".

22 Ju thatë që e keni lexuar aktgjykimin e gjykatës. Po këtë
23 pjesën që sapo lexova unë e keni lexuar, Dëshmitar?

24 PË. Po, e kam lexu, po për qët Jenuz Shurdhanin që bëhet
25 fjalë, ki i ka marrë në pyetje atëna burgun që kam qenë unë.

1 Edhe i ka lëshu do. Dhjetë i ka lëshu. E nuk e di ku i ka çu
2 ato. S'e di. Pi pesë janë nda me mu.

3 PY. Në rregull. A ka ndonjë gjë me të cilën nuk pajtohesh sa
4 i takon përfundimeve që sapo lexova, që janë përfundime të
5 gjykatës?

6 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtoj. Kundërshtoj në qoftë se
7 dëshmitari pajtohet ose jo me atë çfarë ka vendosur gjykata
8 është çështje tjetër.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk është bërë ndonjë pretendim që
11 UÇK-ja ka përdorur listat për të arsyetuar ose si arsye për të
12 ndaluar personat. Pra, këto dy lista që ua tregoj Prokuroria
13 ti ke arsye për të besuar që këto lista janë përdorë nga UÇK-
14 ja për të ndaluar ty, kështu?

15 PË. Unë me këto s'kam mbledhje, nuk e di kush janë. Sa a
16 lista, shka janë ba, si i kanë bë UÇK-ja, kush i ka bë.
17 Kryesore unë për veten teme veç muj me fol, që s'jam kanë në
18 ato lista.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Gjykatës, nuk mendoj që kjo
20 pjesa e aktgjykimit të Gjykatës së Kosovës është pranuar si
21 provë materiale, kështu që do kërkoja që të pranohet si provë
22 materiale.

23 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtojmë. Sa i takon relevancës,
24 të nderuar Gjykatës. Në qoftë se Avokati i Mbrojtjes kërkon që
25 të pranohen në prova materiale faktet të gjykuara ose gjë e

1 gjykuar, kjo është e qartë, besoj, për të gjithë, kështu që
2 kjo është arsyeja që pse ne nuk pajtohemi në pranimin në
3 provën materiale të këtij dokumenti.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Caktojeni për
5 identifikim dhe vendimi lidhur me këtë material do të merret
6 më vonë.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] E kemi caktuar numrin
8 1D46.

9 Z. MISETIC: [Përkthim]
10 PY. Ju u përgjigjët në fakt pyetjes time, në qoftë se
11 personat që u ndaluan, që ju arrestuan, ju akuzuan se keni
12 punuar për sigurinë vendore. Askush nuk të ka akuzuar ty
13 asnjëherë se ke qenë shok me forcat e sigurisë serbe, kështu?
14 PË. Unë thashë më kanë akuzu që jam kanë polic edhe që jam
15 kanë rojtar i pyllit. Këto janë gënjeshtër. Krejt Kaçaniki e
16 di që unë s'jam kanë as polic, as i pyllit, qysh pretendojnë
17 këta. As vënë në pyetje bile. S'të marr kurrëgjegj me fol. Ai
18 duhet me pasë argumente.

19 PY. Askush nuk të akuzuar se ke qenë shok me ushtrinë serbe,
20 kështu?

21 PË. Jo, jo.

22 PY. Dhe askush nuk të ka akuzuar se ke qenë kolaboracionist
23 ose tradhtar, kështu?

24 PË. Po unë për qetë kam ardhë këtu që këto kolaboracionistat,
25 çdo sene ti bë, për qetë kam ardhë këtu. Se s'mund t'i duroj.

1 Kush ka informata le të mi qesi. Ku kam marrë rrogë? Ku jam
2 kanë polic? Kën e kam mshel në burg? Mos të bëjnë këto gjënat
3 çka s'duhet me i bë. Unë i kam ni këto gjëna për qetë kam
4 ardhë këtu. [Folës që flasim njëkohësisht].

5 PY. Unë në fakt e kam fjalën për kohën kur të kanë arrestu,
6 kur të kanë ndalu.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Dua që të shikojmë provën
8 materiale P370 në versionin në shqip dhe në anglisht. Në faqen
9 6, rreshtat 8 deri në 13 në anglisht dhe faqja -- ju kërkoj
10 ndjesë, Pjesa 4, faqja 6, rreshtat 8 deri në 13 në anglishte
11 dhe Pjesa 4, faqja 7, rreshtat 24 deri në faqen 8, rreshti 12
12 në shqip.

13 PY. Prokuroria ju bën këtë pyetje:

14 "Mesa dini ju, ndokush ju ka akuzu se keni qenë
15 kolaboracionist ose tradhtar duke përdorur këto fjalë ose
16 fjalë të ngjashme?".

17 Përgjigja juaj është:

18 "Jo. Jo, por veç që kjo familja Axhami lidhet me Hebib
19 Kokën, këto janë. Këto njerëzit që kanë shty dhe të rrejshme
20 kanë qenë se nuk kanë ndodhë gjëra të tilla".

21 A të kujtohet t'ia kesh thënë këtë Prokurorisë?

22 PË. Këto janë të sigurta. Edhe janë qështu qysh jam tuj
23 thënë unë. Këto informata kanë dalë pi Hebib Kokës, pi
24 familjes Axhami, Enver Axhamit. Unë i di mirë këto gjëna qysh
25 ka ardhë te unë, emni im këto qysh ka hi në të zezë.

1 PY. E kuptoj. A ju kujtohet t'i keni thënë Prokurorit që

2 Jenuz Shurdhani nuk ka përmend asnjëherë asnjë listë?

3 PË. Jo, se edhe unë i thashë i ka marrë në pyetje njerëzit të
4 burgostë në katundin Ivajë. Ai di shumë mirë kush janë kanë
5 dhe kush ja ka çu listën.

6 PY. Do ju tregoj çfarë keni thënë në provën material P370.3,
7 është Pjesa 3, faqja 7, rreshtat 15 deri në 21 në anglisht dhe
8 Pjesa 3, faqja 8, rreshtat 4 deri në 16 në gjuhën shqipe. Këtu
9 pyetja është kjo:

10 "Dua t'i kthehem dhe njëherë listave. Listën e pe vetëm
11 që e ka pasë në dorë Enveri apo e ka pasë edhe Jenuzi?"

12 "Jo, Enveri. Jenuzi s'më ka marrë në pyetje. Nuk ia kam
13 parë që Jenuzi ta ketë pasur listën".

14 "Po Jenuzi ndonjëherë e ka përmend ekzistencën e listën
15 në njëfarë mënyre?"

16 Përgjigja është.

17 "Jo, jo. Jenuzit i kam thënë për Bashkim Lokin me e lëshu
18 se ka punu te unë e ka dhënë eurot".

19 PË. Po, unë i kam lëshu.

20 PY. E kujton që e ke thënë këtë gjë për Prokurorinë?

21 PË. Edhe unë i kam lëshu. Edhe me u ngjallë sot.

22 PY. Të diskutojmë pak më tepër për listën. Na the që Enver
23 Axhami ka lexuar një listë me emra ndërkohë që ju ka marrë në
24 pyetje, a është e saktë kjo?

25 PË. E saktë është.

- 1 PY. A e ke idenë ti se nga e kishte marrë këtë listën ai?
- 2 PË. Prej Hebib Kokës.
- 3 PY. Habib Koka?
- 4 PË. Habib Koka.
- 5 PY. A të kujtohet në qoftë se Enver Axhami e ka lexu edhe
- 6 emrin tënd nga ajo lista? E ke pasë emrin ti aty në listë që e
- 7 ka lexuar Enver Axhami?
- 8 PË. Po, po. Kish shti dhe emnin tem.
- 9 PY. Ku kujtohen emra të tjerë nga ajo listë, kështu, ju
- 10 kujtohen?
- 11 PË. Qëtash ke janë kanë në burg të parët. Ata tjerët. Më
- 12 kujtohen nja dy a tre më duket. Në s'gabofsha shka janë kanë
- 13 burg në Ivajë.
- 14 PY. A mund të na i thoni këto emra tani?
- 15 PË. A kanë një Rexh, Rexh e thirrnin, mbiemrin s'ia di. Një
- 16 Sefë, Sefë plak. Edhe një tjetër e kam harru vallaj emrin. A
- 17 këta tjerë që jam kanë në burg me to, këto i di, se me këto
- 18 kam nejt shumë.
- 19 PY. Do t'ju tregoj se çfarë keni thënë, domethënë, emrat që i
- 20 keni dhënë gjykatës themelore.
- 21 Z. MISETIC: [Përkthim] Jepet në provën materiale P367 në
- 22 faqen SPOE00091676 në versionin në anglisht dhe SPOE00091699
- 23 në versionin në shqip.
- 24 PY. Nëse do shikoni versionin në shqip nga mes i faqes ku
- 25 thuhet:

1 "Agim Idrizi: Kur Enver Axhami më ka marrë në pyetje ..."

2 A e shikon atë pjesën?

3 PË. Po, është saktë që Enver Axhami më ka marrë në pyetje.

4 PY. Nëse vazhdohet më tej me leximin e paragrafit përmenden

5 disa emra që ti i ke thënë gjykatësit që kanë qenë pjesë e

6 listës. Do t'jua lexoj unë.

7 "Kur Enver Axhami më ka marrë në pyetje, ata më kanë

8 lexuar me zë një listë që përmendte emrat e atyre shqiptarëve

9 që ata kanë pasur qëllim t'i kidnapojnë dhe unë do t'ia jap

10 këto emra gjykatës. Islam Dranogllava, Ismail Lela" --

11 PË. Po.

12 PY. -- "për të kanë thënë se 'ai u shoqëronte me Arkanin më

13 mirë ta kidnapojmë atë'".

14 PË. Po. Po e saktë a. Qështu ka thënë Enver Axhami.

15 PY. "Përpos kësaj ata kanë thënë për të se para 20 vjetëve u

16 ka shoqëru me Arkanin ndërsa ka qenë në Belgjikë" --

17 PË. Po, po.

18 PY. -- "Halit Loki, Ismet Stagova, një këpucar nga Stagova me

19 emër Heset, Safet Rexhallari" --

20 PË. Afet. Afet.

21 PY. -- Afet. Në rregull.

22 PË. Po.

23 PY. -- "Mahmut Darishti, Qamil Dardhishta, Osman Kuka" --

24 PË. Po, po.

25 PY. -- "Hazir Jaha, djali i të ndjerit Iliaz Jaha. Myrteza

1 Tusha. Ata njerëz që na kanë kidnapuar kanë gjuajtur në kerr
2 tek Kulla e Keshmes, por ai ka arritur të largohet. Personi
3 tani është gjallë”.

4 PË. Po.

5 PY. “Jeton Qorri, Bashkim Qallaki. Lal Qallaki, vëllai i
6 Bashkim Qallakit. Qamushi ka qenë roje pyjeve nga Elizhani.
7 Aty ka qenë dhe në person tjetër veteriner i lopëve, emri i
8 tij ishte Hisen”.

9 PË. Qamush Shumari. Po, po.

10 PY. “Aty ishin katër persona të tjerë në Llanishte”

11 Okei.

12 “Ata e kanë vendos edhe Emin Axhamin në listë sepse ata
13 kanë dashtë që ta kidnaponin dhe atë. Ai ka qenë postieri i
14 shkollës”.

15 PË. Emin Axhami ka punu në gjimnaz. Ka punu në gjimnaz.

16 PY. “Ata kanë vendosur edhe Bekim Matlumën në listë. Bekir
17 Shurdhanin. Lidhur me këta persona ata kanë thënë se ai ka
18 sjellë me ushtarët serbë dru me kamionë”.

19 PË. Po dhe këto thojke Enver Axhami.

20 PY. “Ata kanë përmend dhe emrin e Hisenit”.

21 PË. Po, kështu thojke Enver Axhami.

22 PY. “Sa i përket Bobit, Fehme Zenelit, këta janë ata që më
23 kujtohen. Sa për të tjerët nuk e di”.

24 A t’u kujtuan tani emrat?

25 PË. Po, po. Këto i ka shti në listë. Ku e di unë për çka i ka

1 shti në lista ai. Ai le të kallëzon qetash. Unë s'i kam shti
2 në listë. Edhe s'kam kontakte me to. Kështu që jam i lirë me
3 to. E ai nëse di çka kanë punue, kush ka punu, le të vjen e të
4 kallëzon si unë qështu. Enver Axhami. Le ti banë publik.
5 PY. Në rregull. I mbajtet mend përmendësh këto emra, ndërkohë
6 që ato lexoheshin se ishte i takon një listë e gjatë me emra
7 dhe ti i ke kujtuar goxha mirë?
8 PË. Po e ti më lër ta bëj një pyetje edhe unë juve. Ai e ka
9 shti edhe vëllavin tem në listë Kadri Idrizin. Ai 40 vjet s'ka
10 ardhë në Kosovë, mbas 40 vjetëve ia ka dhënë paret një
11 shqiptari të Kaçanikit Bajram Vula -- Bajram Tusha e kish pasë
12 shok klase në fillore në Kaçanik, e njofti menjëherë në
13 Maqedoni. Ai ka ardhë pa pasosh, i Belgjikës dhe i ka hi këtu
14 nëpër mal te maqedont edhe serbët, Enver Axhami thotë kanë
15 flejtë Agim Idrizi dhe Kadri Idrizi me Arkanin në Hotel Grand
16 në Prishtinë shtatë ditë. Ky tu na e mbajt krejt evidencën
17 neve. A bën me shku në aty në hotel me këqyri në kena flejtë.
18 A shkrun emri jonë aty?
19 PY. Dëshmitar, unë po të pyes: Si ka mundësi që i mban mend
20 emrat? U përpoqe t'i fiksoje në kujtesë kur t'i lexonin?
21 PË. Unë nuk ka nevojë me i përmend emrat se s'pi ujë te unë
22 këto. Veç i kam pa që i ka lexu ai. Në libër i ka pasë. Edhe
23 emnin tem e kish shti aty. Tash le të japë përgjigje ai. Ka
24 ardhë koha me kallëzu kush a kanë, çka a kanë. S'ka mësheft
25 më. Vëllavi jem s'a kanë 40 vjet që ikën gjithë bishta. Ai

1 s'ka bërë kurrëgjë në Kosovë. Ka ardhë me pa nënën e vetë.

2 PY. Dëshmitar, do bëj një pyetje tjetër. Emrat që të janë

3 kujtuar për gjykatën nuk janë të njëjtat emra që ishin tek

4 lista e sigurisë që të tregoi dhe Prokurori dhe unë, pra, nuk

5 janë të njëjtat emra?

6 PË. Jo, nuk janë.

7 PY. Shohim listën.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Vendosim në ekran materialin me

9 numër SPOE0093211.

10 PY. Cilat emra janë njësoj këtu? Cilat emra janë njësoj me

11 emrat që i ke thënë gjykatës?

12 PË. Emrat janë qetu shka jam kanë i burgosë. Qeto muj me t'i

13 kallëzu. Tjerat nuk më interesojnë mu se s'pi unë te unë ato.

14 Ata ai ne t'i kallëzon e le të hin në bela jo unë. Se ai i ka

15 lexu. Ai mund ka bier sot atë librën e ta kallëzoje këtu.

16 PY. Dëshmitar, krahasojmë emrat më vonë. Po do flas për diçka

17 tjetër tani. Ke dhënë dëshmi për një artikull në gazetë që

18 është botuar pasi të kanë liruar. Të kujtohet që ke të ketë

19 pasur një artikull në gazetë ku thuhej që UÇK-ja po të

20 kërkonte?

21 PË. E ka shkru Enver Axhami nëpërmes djalit të Esat Rakës, le

22 ta dijë ai atje në Kaçanik se ata na përcjellin. Atë e ka shok

23 të ngushtë. E ka shkru emnin tem që me shpërnda që kush të më

24 shohi me më vra. Ma ka rrit atë tensionin edhe ma shumë me

25 këtë gazetë. Edhe ma ka shkru gruan që a çika e Arkanit, Agimi

1 a mik i Arkanit. Çka s'ka shkru ku ke unë. S'e di që jam tuj
2 nejt gjallë. Na duhet vetë me e dënu atë. Nuk e di qysh e kanë
3 leju kështu me bë? Çfarë ushtari është ai ashtu? Unë gruan e
4 kam shqiptare.

5 PY. Më duket se po flasim për të njëjtin artikull në fakt.

6 Mban mend kur u publikua ky artikulli në gazetë, të kujtohet?

7 PË. Po isha atëherë në Kosovë kur i kam lexue. I kanë marrë
8 policia ato gazeta, s'mi kanë la. Mu s'më erdh mirë, as
9 familjes teme. Duhet me shkru saktë, jo me shkru ti pa u sha.
10 Hajd t'ia futim dhe ta vrasim Agimin Idrizin. Ma ka shkru
11 gruan që a çika e Arkanit. S'ka ma gazetë ma keq ma.

12 PY. Dëshmitar, unë thjesht po të pyes data, viti ose muaji,
13 kur u botua ky artikulli në gazetë të kujtohet?

14 PË. Ky u botue, unë jam kanë në Kosovë atëherë atje në
15 program për mediat. S'muj me ditë që e ka marrë policia
16 gazetën. Unë s'jam tuj rrejt. Që kjo gazetë ma ka stresu krejt
17 familjen. Tuj mendu njerëzit pale kush e di çka kam bë. Merre
18 me mend që ma ka shkru gruan që është çika e Arkanit, gruaja e
19 Agimit. Qysh a kjo kështu? Këto s'i ka bë as turk, as një komb
20 në botë qeto gjana.

21 PY. Dëshmitar, do të pyes edhe njëherë ose do ta bëj mbase
22 ndryshe. Ky artikulli në gazetë është botuar pasi je larguar
23 nga Kosova, kështu, pasi kishe ikur ti nga Kosova, kështu?

24 PË. Jo, në Kosovë jam kanë atëherë. Nuk jam kanë përjashta.
25 Jam kanë në Reç e dinë këta.

1 PY. Do të tregoj atëherë provën materiale P367 me faqen
2 0091682, shqipja SPOE0001679 -- më falni. Dhe njëherë
3 SPOE0019705. Kjo është e sakta.
4 PË. A bën se mu tek që tash kur e ka shkru këtë gazetë? A bën
5 me kallëzu?

6 PË. Patjetër.

7 PË. Këtë gazetë e ka shkru kur ju kam ik, kur ju kam ik
8 këtyne ushtarëve, ky e ka shpërndarë këtë gazetë në Maqedoni e
9 kanë lexu do të familjes time dhe më kanë kallëzu. Kur u ndal
10 lufta kam shku në Maqedoni dhe më kanë kallëzu. Kjo është e
11 saktë. Edhe një tjetër e kanë shkru, po atë jam kanë atëherë
12 në Prishtinë, që demek unë e kam gruan çikën e Arkanit, Agimi
13 a miki i Arkanit. Që më ka shti me një pus të fellë, po ju
14 s'jeni tuj e ditë.

15 PY. Po shohim dëshminë që i ke dhënë gjykatës themelore dhe
16 ke thënë:

17 "Kur shkova takova për ta parë familjen time, kur kam
18 lëshuar Kosovën, kur lufta përfundoi, ata më thanë se në
19 gazeta ka qenë e shpallur se UÇK-ja ishte duke më kërkuar dhe
20 kur unë shkova për të kërkuar një strehim askush nuk ka dashur
21 të më strehojë. Kur ka qenë e vërtetë. Ka qenë e shpallur në
22 media se cilido ushtar i UÇK-së ka qenë duke më kërkuar".

23 A të kujtohet ta kesh thënë këtë?

24 PË. Po, saktë a kanë qështu.

25 PY. Pra, gazeta, artikulli në gazetë është publikuar pasi

1 ishe larguar nga Kosova dhe kishte mbaruar lufta, kështu?

2 PË. Po. E besoni që në Maqedoni në burg ku jam kanë një muaj
3 për pasosh fals, një polic shqiptar atje i kish çu thënë, qysh
4 i thojnë, në Kosovë, ju ka çu mesazh ose fjalë ne na thojnë,
5 Agim Idrizin nëse doni me e arrestu nesër ka me u lëshu pi
6 burgit, ora që kaq, që kaq. Edhe ata s'kanë ardhë në Maqedoni
7 me më arrestu. A e dini ju këtë?

8 PY. Dëshmitar, ne thjesht po përpiqemi të marrim disa fakte
9 për këtë artikullin. Vetëm kaq. Po të shohim transkriptin në
10 ekran, bën një pyetje Prokurori:

11 "Ju jeni përmendur në gazeta. Në atë kohë ju a e keni
12 parë vetë gazetën?"

13 Ti i je përgjigjur:

14 "Një kushërini im i afërt nga familja ime e ka prerë dhe
15 më ka thënë. Mua nuk më ka interesuar nga cila gazetë ka marrë
16 emrin tim. Po do ta gjejmë nëse kjo duhet?"

17 Të kujtohet ta kesh thënë këtë?

18 PË. Nuk ma ka dhënë ai. Po u tutke se ku me dit. S'ma dha se
19 bash kam pasë qejf me e marrë me e ruajt. Dhe kjo nuk a e mirë
20 që e kanë shkru. Se a po e sheh qysh janë bo gjithë këto
21 përçamje?

22 PY. Të kuptojmë në qoftë se po flasim për të njëjtin
23 artikull.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Prandaj vendosim në ekran
25 materialin me numër SPOE00093174 deri në 00093175.

- 1 PY. A bëhet fjalë për këtë artikull, për këtë po flet?
- 2 PË. Po atyne nuk i erdh mirë. Nuk i erdh mirë as familjes
3 time kur e pa atë.
- 4 PY. Mirë. Po për këtë artikull e ke fjalën? Këtë artikull pa
5 familja që të tregoi ty më pas, për këtë këtu?
- 6 PË. Po. Këtë këtu më kallzutën që e ka shkru një gazetë të
7 kërkon UÇK-ja. Unë nuk e di për çfarë qëllimi më kërkon UÇK-
8 ja. Duhet me kallëzu. Po që tash duhet me u dënu Enver Axhami,
9 krejt ai i ka bë këto gjena që sjellë gjithë këto telashe
10 këtu.
- 11 PY. Artikulli e përmend UÇK-në, a përmendet UÇK-ja në
12 artikull?
- 13 PË. Qysh ka më ka thanë ai. S'ma ka dhënë me lexu. Me pasë
14 dhënë dhe unë e kisha në xhep sot këtu.
- 15 PY. Artikulli këtu nuk e përmend as gruan dhe as Arkanin?
- 16 PË. Jo, ajo tjetra është. Atë e kanë policia në Prishtinë.
17 Ajo me karta të qelqit po e dënon. Ma ka shkru. Ma ka shkru
18 gruan dhe që e kam çikën e Arkanit grue.
- 19 PY. Mirë do ndërroj pak temë. Ti nuk e ke ditur se çfarë roli
20 kishte kushëriri yt në LDK? Hysen Idrizi. Ti nuk e dije çfarë
21 roli mbante ai në LDK?
- 22 PË. Unë e kam ditë, se ai më ka thënë që na jena tuj këqyrë
23 këto gjena mirë edhe nuk bën në punë të keqe, se kur të vjen
24 koha janë njerëzit të caktum.
- 25 PY. Më keqkuptove më duket. Do të bëj ca pyetje për LDK-në

- 1 tani.
- 2 PË. Bani.
- 3 PY. Jo për atë që të ndodhi.
- 4 PË. Bani, bani.
- 5 PY. Ke pasur një kushëri me emrin Hysen Idrizi, i cili ishte
- 6 në LDK, kështu?
- 7 PË. Po.
- 8 PY. Ti nuk e di çfarë pozite kishte kushëriri në LDK, kështu?
- 9 PË. Ai ka mbajt mbledhje qatëhere ato si LDK-ja mo.
- 10 PY. Po ti nuk e dije çfarë detyrash kryente ai në LDK, --
- 11 PË. Unë nuk --
- 12 PY. -- çfarë funksioni kishte?
- 13 PË. -- s'jam interesu se unë më ka interesu veç parja e mali.
- 14 Unë s'jam interesu për asnjë punë, ndaç me ditë. S'kam dashtë
- 15 me u përzi në kun një fare pune hiç. Me u kanë rehat po qe se
- 16 më lënë rehat.
- 17 PY. Ti vetë nuk kishe asnjëherë i interesuar në politikë,
- 18 kështu, s'të ka interesu ndonjëherë politika.
- 19 PË. Jo, jo. Kurrë hiç. As në Jugosllavi, as qetash. Unë jam
- 20 kanë ai që kam ik edhe pi ushtries jugosllave. Tre muaj kam
- 21 nejt. Kam bë probleme të mëdhaja e kam ardhë në shtëpi se
- 22 s'kam dashtë me nejt. Jena kanë 30 vetë të Kaçanikit, ata kanë
- 23 nejt e kanë kri ushtrien, unë jo.
- 24 PY. Gjatë kohës që ke qenë i burgosur askush nuk të ka
- 25 akuzuar ndonjëherë se ishe anëtar i LDK-së, kështu?

1 PË. Jo, jo. Aty veç u përmend Arkani, toka, Sami Axhami, u
2 rreh për armë, Agimi e ka rrahë një milic, polic. Qësi. Qësi
3 budallake janë këto. Tash ai e ka bërë, e bëhet me shnet, le të
4 mirret kushdoj me ta.

5 PY. Ti nuk e di në qoftë se ka pasur ndonjëherë probleme
6 kushëri yt Hisen Idrizi me UÇK-në në 1998 ose 1999, kështu,
7 nuk ke dijeni për diçka të tillë?

8 PË. Jo, jo. Na kena dalë keni ruajt natën. Më kujtohet kena
9 ruajt natën në kohën e luftës. Po armë s'na dhatën edhe e
10 lashë, ma krejt ja shtritim me shku në Shkup. U përgatita më.
11 Enver Axhami erdh natën, i ka çu ato ushtarët e vetë më ka
12 marrë.

13 PY. Më duket se nuk më kuptove. Unë po të pyes tjetër gjë. Ti
14 vetë dije gjë kushëriri yt Hisen Idrizi, a ka pasë ndonjëherë
15 ndonjë problem me UÇK-në, dije gjë ti për këtë?

16 PË. Jo, jo, nuk di kurr gjë.

17 PY. Faleminderit, Dëshmitar.

18 PË. Faleminderit edhe prej juve.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Kryegjykatës, unë nuk
20 kam më pyetje.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
22 z. Misetic.

23 Mbrojtja e Veselit?

24 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Nuk kemi pyetje.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis, keni

1 pyetje?

2 Z. ELLIS: [Përkthim] Jo, nuk kemi pyetje.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka pyetje
4 shtesë nga Prokurori?

5 Z. PACE: [Përkthim] Po. përreth pesë minutash shpresoj.

6 Pyetje vijuese nga z. Pace:

7 Z. PACE: [Përkthim]

8 PY. Dëshmitar, sot paradite, në faqen 35 të transkriptit,
9 është reflektuar kjo, ju thatë:

10 "Enver Axhami tha që unë isha spiun për Sali Brutin. Unë
11 asnjëherë s'kam folur me Sali Brutin. Ai ishte komandant në
12 Kaçanik".

13 Dhe unë tani kam një pyetje: Enver Axhami, kur ka thënë
14 që ke qenë ti spiun i Sali Brutit përpara arrestimit në mars
15 të 1999 apo pas arrestimit, kur e ka thënë ai këtë?

16 PË. Shumë faleminderis këtë pyetje ma ke bë me vend edhe tash
17 e ngojnë atje në Kaçanik edhe unë du me e fol. Më lejoni të
18 foli. Kjo punë a kanë kur më kanë arrestu ato ushtarët e
19 Enverit, shokët e tina më kanë çu në Ivajë, në burg, Enver
20 Axhami te shtëpiat e Bobve aty, qajo shtëpi vjetër që shihet.
21 Që atje Enver Axhami më ka marrë në pyetje edhe ka thënë që
22 Agim Idrizi u kanë spiun i Sali Brutit.

23 Unë nuk jam kanë spiun i Sali Brutit, po u kanë
24 puna për dy kuaj dru. I kam vjedhë në mal. Mu këput sharra, të
25 kam kallëzu njëherë edhe i kam ngarku ato drutë ishin kanë pa

1 çekiç. Unë e kam ditë që janë të shtetit ato dru se i ka pre
2 shteti, turra i thojshin ata metri. Edhe ka ardhë te shpia më
3 ka thënë "Agim mi kishe vjedhë dy kuaj dru?" Thashë "Po ti
4 paguaj ose po ti bi". E prita me të mirë. Ai tha: "Ani". Dhe
5 kam shku me liru një arë me [e pakuptueshme] me nënën time me
6 një vëlla i saj. Ka ardhë te ara më ka rrehë me një dru. Edhe
7 ia kam marrë drunin, jam kanë më i fortë, e kam rrehë. Tre muj
8 ka nejt ratë, s'ka shku në punë.

9 Kjo është e sakta. E Sali Bruti atje është, ndoshta na
10 ndëgjon, nëse jam kanë spiun Sali Bruti le të lajmërohet. E le
11 të lajmëroet në Kaçanik atje. Tjerat këto janë gënjeshtër. Ka
12 thënë u kanë tu na mçel në burg Agimi me vëllavin e vetë
13 Rrahimin. S'është kjo. A Zylfi Axhamin. Janë rrenat e atij të
14 Enver Axhamit se Sali Bruti a gjallë. Nëse thotë ai që jam
15 kanë spiun, le të del e të kallëzon. Që më ka shti me një
16 bonor të thellë mos me dalë kurrë.

17 PY. Në rregull. E dhatë përgjigjen. Po ashtu sot paradite -
18 dhe kjo është në faqen 24 të transkriptit - të bëri një pyetje
19 Avokati i Mbrojtës për Enver Axhamin dhe familjen. Pyetja
20 ishte kështu:

21 "Sipas teje ai po shpërndante shumë gënjeshtër dhe gjëra
22 që s'ishin të vërteta për ty?"

23 Ti u përgjigje:

24 "Po, të gjithë në Kaçanik e dinë këtë".

25 Tani unë kam pyetje kështu: Gjatë kohës që ke qenë i

1 burgosur në mars të 1999, ndonjë pjesëtar i UÇK-së i përfshirë
2 në arrestimin tuaj a u përpoq të verifikonte ato që thoshte
3 Axhami a ishin të vërteta apo jo?

4 PË. Edhe njëherë bëma qët pyetjen?

5 PY. Patjetër. Sot the se Enver Axhami përhapte gënjeshtër për
6 ty. Gjatë kohës që ke qenë në burgun e UÇK-së, në mars të
7 1999, ndonjë nga pjesëtarët që ishin aty a u përpoq t'i
8 verifikonte në qoftë se ishin të vërteta ato që thoshte
9 Axhami, pra, të verifikonte a ishin të vërteta apo ishin
10 gënjeshtër ato që po përhapte Axhami, u përpoqe njeri ta bënte
11 këtë gjë?

12 PË. Po Enver Axhami i ka lexu listat. Dhe listën te emnin
13 tem. Edhe Enver Axhami a kanë kryesori që s'më ka lëshu e s'më
14 ka marrë në pyetje Jenuz Shurdhani. Se Jenuz Shurdhani me më
15 marrë në pyetje unë isha në pyetje unë isha në shtëpi sot. Ky
16 është shkaktari i krejt këtyre tollovinave sot unë jam qetu.
17 Enver Axhami dhe Hebib Koka. Ky i ka çu listën, ky mi ka shti
18 këto emna polici, rojtar i malit, Arkanin, tokën, krejt qeto i
19 ka përzi këtu. Tashtine të marri masa dikush në të.

20 PY. Dëshmitar, më dëgjon dhe njëherë me kujdes. Do të bëj një
21 pyetje tani bazuar në atë që thatë. The që po thoshin që të
22 kishin ngritur akuza për ty se ishe polic, ishe shumar. Tani
23 gjatë kohës që ishe në atë vendin që të kishin ndaluar ty në
24 Bob, ndonjë nga anëtarët apo pjesëtarët e UÇK-së që ishte aty,
25 a të tregoi ty ndonjë provë që këto ishin të vërteta dhe a të

1 pyeti ndonjëri prej atyre personave atje janë këto të vërteta
2 apo nuk janë të vërteta, pra, të pyeti njeri gjatë kohës atje?

3 PË. Këto ja kallëzoj qartë që dhe duhet me ditë krejt
4 opinionin edhe ju krejt këtu, unë më kujtohet se shtëpia më
5 kanë ardhë mbas luftës do karabinier dhe një përkthyes ma ka
6 prur një libër edhe aty ishin --

7 PY. Dëshmitar, jo, jo, jo. E kemi fjalën tek vendi ku --
8 përgjigju pyetjes. Dhe njëherë, gjatë kohës që ke qenë në
9 objektin e ndalimit të UÇK-së, ndonjë nga ata të UÇK-së që
10 ishin atje a të tregojë ty ndonjë copë letër, ndonjë dokument
11 ku të vërtetoheshin këto akuzat që thoshte ky Enver Axhami për
12 ty, të tregojë ty ndonjë provë të thoshte që këto janë ose nuk
13 janë të vërteta këto që thotë Enver Axhami, ta tregoj njeri
14 gjatë kohës që ishe tek objekti i ndalimit?

15 PË. Jenuz Shurdhani ka deshe me më marrë në pyetje po s'ka
16 guximi për Enver Axhamin. Kjo është e qartë. Jenuz Shurdhani më
17 ka thënë "Agim duhet me të lshu, si të marrë në pyetje ata
18 duhet me të lshu. Ta kanë gjetë një tefork të hekërt". Ai
19 teforki i ka katër grepa, sha ai pleh ke lopët, e kam lënë
20 mbas dera qatje. Tha "Duhet me të lëshu Agim se s'të kanë
21 gjetë kurrëgjë në shtëpi". Kjo është e kuartë.

22 PY. Faleminderit.

23 Z. PACE: [Përkthim] Nuk kam më pyetje.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,

25 z. Pace.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi Smith.

2 Pyetje nga Trupi Gjykses:

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Mirëdita, Dëshmitar.

4 PË. Mirëdita.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Unë kam pak pyetje.

6 PË. Urdhoni.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pyetja e parë është kështu.

8 Pasi dëgjuam dëshminë tuaj sot paradite, a e kam kuptuar unë
9 siç duhet që arsyeja kryesore, në mos arsyeja e vetme, për
10 keqtrajtimi dhe arrestimin tuaj ka qenë problemi që keni pasur
11 për tokën me Enver Axhamin dhe familjen e tij, kështu?

12 PË. Po, e saktë a. Krejt Kaçaniki e din. Unë s'kam ça me
13 gënjy këtu. Pyeta e di krejt. Edhe fëmijët e vocël e dinë.
14 Teje për bela të madhe kena pasë.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. E kuptova.
16 Enver Axhami a ka qenë anëtar i UÇK-së në mars të 1999, ka
17 qenë pjesëtar i UÇK-së në mars të 1999?

18 PË. Po, qysh s'a kanë ai pjesëtar i UÇK-së. Po.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A ishte i veshur me uniformë
20 kur të keqtrajtojë?

21 PË. Po. Ai mbasandaj e ka vesh uniformën. Këto ushtarët
22 i ka çu civil më kanë marrë te shtëpia. Ai ka nejt, s'ka guxu
23 me ardhë pi familjes time me më marrë se e njohin, që i ka
24 ndejt në Bob te një kolibe veç vetë. Edhe te ushtarët s'ka
25 nejt [e pakuptueshme] mos me pa ushtarëtçka janë tuj bë. Veç

1 këto grupi i familjes së vetë janë kanë polic dhe s'kanë mujt
2 me nda informata pi këtyne. Po unë e pava që jam gjallë tash e
3 kallëzoj se s'ka pasë me dit kërrkush që Enver Axhami ma ka bë
4 qetë. Kështu është kjo.

5 Janë familje këta janë bë policë ushtarakë bashkë një
6 familje janë komplet edhe janë kanë keq. Një Rustem Demën për
7 një çik të mixhës së vetë në shkollë ajo. Unë isha i ri në atë
8 kohë. Ajo a kanë gocë [e pakuptueshëm] pushim. Unë i thosha
9 "largohu". Ajo hiç. Ai ka ardhë më ka mshu boks. Unë e kap e
10 kam rrehë, ia kam thy të gjitha e kam përgjak krejt. Qështu a
11 kanë. 20 vjet s'kena fol. Mbas 20 vjetëve kish ardhë për mi
12 thy xhamat, tu më lidh e tu më rrehë. Thojke "S'kena fol 20
13 vjet". Po atyne s'ka ça i fol 20 tash puna ime. Ke ardhë ti me
14 marrë hakmarrjen mu në emën të UÇK-së apo? Kështu a kjo. Se
15 s'ka dalë para lufte me më rrehë? 20 vjet i ka ajo punë. E
16 shini, pra, gjena kanë bë të tmerrshme.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Besoj se e
18 kuptova. Pra, ju thoni që Enver Axhami ishte anëtar i policisë
19 ushtarake --

20 PË. Po.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] -- këtë po thoni?

22 PË. Po bashkë u kanë me këta.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe axha i tij ishte po
24 ashtu anëtar pjesëtar i UÇK-së në mars të 1999 me sa dini ju?

25 PË. Axha i tij ka punu me shkije.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Sami Axhami.

2 PË. Krejt e dinë te [e pakuptueshme] gjithçka pompa ka punu
3 edhe në kohën e Titos, në kohën e Milloshit, në kohën e UÇK-
4 së. Edhe e kanë qitë dy herë pi pune, dy herë e kanë shti
5 shkijet në punë qët Sami Axhamin. Mixhë e ka Enveri. Edhe
6 armët i ka të shkive sot në shtëpi. A na kurrë armë s'kena
7 pasë familja Idrizi. Krejt e dinë Kaçaniki. Ka u bënë këta
8 kështu kaq proletera, kaq të mençëm?

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, me fjalë të tjera, Sami
10 axhami nuk ka qenë me UÇK-në, kështu?

11 PË. Sami Axhami kam ni napërmes njerëzve në kohë të luftës ka
12 lëvru me traktor. E ka mbjell tokën me kallaq. Edhe e kam ni
13 që një djalë, edhe një djalë të motrës ia kanë vra shkijet.
14 Shkijet ia kanë vra se ka bë be. Ka rrehë Agim Idrizin, ka lyp
15 automat. Kur i kanë lyp automat? Krejt Kaçaniki e din që kurrë
16 milicia s'e kanë rrehë Sami Axhamin. Këto janë gënjeshtër veç
17 me mu. S'më kanë dashtë mu si Agim.

18 Ka më ka pa të vesh ata kanë ku. Se unë jam kanë i
19 veshtë. S'jam kanë çka do njeri. Edhe ajo është një farë, s'po
20 di qysh me ta përshkru. Me pa në teshat sikur ndonjë çoban që
21 ruan lopët Enver Axhamin. Një katunar i thjeshtë a kanë. Ka
22 racizëm shumë në zemër. S'i do kërrkënd ai. Ai ju ka thënë
23 edhe në telefon policies së Kosovë Kaçanik kam [e
24 pakuptueshme] e ke këta servilët familjen Idrizi. Po çfarë
25 rastësie ti më njeh krejt. Je tuj pasë argument. A e dini ju

1 këtë që na e ka bënë edhe qetë. Që ku e kam fotografi unë këtu
2 në daci me pa. Shikoni çka i ka bënë djalin të vllavit, djalin të
3 mixhës edhe mue. A bënë t'jua kallëzoj?

4 Qysh i ka leju shteti me i bënë këto gjena? U ka desh
5 komandanti me na bënë si me si me na marrë në pyetje.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dëshmitar, më lejoni të
7 vazhdoj me pyetjen.

8 PË. Po, urdhno.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ma dëgjo pyetjen, të lutem.
10 Në fakt e dhe përgjigjen.

11 Pyetja e radhës ka të bëjë me shënimin përgatitor me
12 Prokurorinë numri 2, është paragrafi 18. Më dëgjo me vëmendje
13 këtë që do të lexoj. Këtu ke thënë:

14 "Dëshmitar 0481, konfirmon deklaratën e mëparshme se para
15 se të ndalohej 04018, xhaxhai i Enver Axhamit, Sami Axhami më
16 tha dhe më pranoi mua", pra, ty "si dëshmitar për 04018 se ai
17 e dinte që s'ishte e vërtetë".

18 Unë, pra, dua të pyes këtë, kur e pranoi Sami Axhami që akuzat
19 për ty nuk ishin të vërteta, e pranoi gjatë luftës apo e
20 pranoi pas luftës që akuzat që kishin thënë për ty s'ishin të
21 vërteta?

22 PË. Unë kur jam kanë në shtëpi tash dy verë e një dimër mbas
23 luftës kam dalë mbasandaj, mbas tri vjetëve, se tri vetë kam
24 nejt në izolim në shtëpi. S'e ka ditë kurrkush që jam aty,
25 mbasandej kam dalë. E kam zënë te para shtëpies tek bëhet

1 nisani. Shkon e kish pasë gruen dhe nja 30 gjemë i kish marrë
2 me rieti. Ajo është një trasa me traktor. I thashë "A po vjen
3 te unë a të vij te ti?" "Jo, jo" tha "lal" se lal na thonë
4 "lal ne jena kanë kojshi. Na s'keni pasë kurrkurr gjë. Na jena
5 kanë kështu. Na kështu". Thashë "Qysh na kështu e na kështu"
6 thashë "po ti kishe bë ne shtab te UÇK-ja kishe thënë Agim
7 Idrizi më ka lyp automat. Ka ardhë ai me polic. Rrehë Agimi
8 rrehë policët. Cili polic të ka rrehë?" Ajo gruaja vetë qa
9 tutje, veç e këqyri shtrembët i tha "Marre duhet me ta shka ke
10 bë".

11 Dhe q'ashtu është. Shkoni i vetni sot nëse thotë më ka
12 rrehë Agimi, unë e marrë edhe çoj cili milic të ka rrehë? Mo
13 miqsi miqsi. Nuk a veç qitja mbas shpine një guri Agimit edhe
14 hajd. Këtu duhet me kallëzu drejtësien për qëta kam qetu, se
15 atje janë tu na përcjellë. Ai s'më ka me pasë fytyrë me dalë
16 mu në qarshi se kanë me e pështi shqiptarët se s'a kanë rrehë
17 policia. Kjo a e vërtetë.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Faleminderit,
19 Dëshmitar. Pyetja tjetër është kjo. A e dini se kur ka ndodhur
20 rrahjet në rajonin e policisë serbe sipas Sami Axhamit? Sami
21 Axhami çfarë pretendonte që kishte ndodhur në këto rrahje, kur
22 kanë ndodhur sipas atij këto rrahje?

23 PË. Atë e ka bë në kohë lufte. Pak pa marrë mue. Edhe
24 ushtarët njëri më kallëzue, atje është në Kaçanik. Tha "Agim a
25 e vërtetë qe kjo" tha "mirë e ke bë që ke ardhë në Kaçanik". I

1 thashë "Po, po mirë ia ka bë, po do gjëjna s'un jam tuj duru".
2 Edhe ai më kallëzojë. Tha "e vërtetë që e ke rrehë Sami
3 Axhamin i ke lyp automat me milic?" Thashë unë "Pi teje po e
4 nij sot". Edhe pi atij e pi njerëzve tjerë që e kam ni.

5 S'bën kështu me bë. Duhet njërit në sy me i thënë. Pa të
6 rreh as milic as kërrkush ti tu më thënë Agimi po ia lyp
7 automat se dhe ai ku ka me shkue. Ai nesër do ta gjykoj dikush
8 atje në Kaçanik. S'a veç me fol hajd se luftë e s'mirret vesh.
9 Ata e kanë ditë që kanë me u pushkatu menjëherë. Bile e kanë
10 ditë edhe që më kanë marrë në luftë. Kena tu të marrë me
11 luftu. Se ai sen nuk më kish lidhë kurrë. Kurrë s'un më kish
12 lidhë. Ma bën më mashtrutën, më lidhën, mbasi lidhën mbasandaj
13 e pash shka janë tu më bë. Po apet ju ika. Qe sot ku jam. Dhe
14 ju kam shku në Kaçanik.

15 Na ka ndalë një ushtar shok i Enver Axhamit, një Ismet
16 Kuka, ma kanë ndalë kombin e bardhë para stacionit të
17 policies, kisha po tutna unë pi palezje po hipi në kombi me më
18 çu me më ekzekutu. Po s'ka guxu me ik. I thashë "Nëse do me
19 nejt gjallë hec, mos do me mbyt vetin hip në kerr". Dhe ka ik.
20 Po merr ti mua apet kish kujtu që po më merr me më çu ka dojë
21 ai me më shëtiti napër mal.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, Dëshmitar. Në
23 fund fare më lejoni t'ju pyes a jeni në dijeni që ndonjë
24 hetimi ose procesi gjyqësor të kryer nga UÇK-ja kundër Enver
25 Axhamit apo persona të tjerë të përfshirë në arrestimin,

1 ndalimin dhe keqtrajtimin tuaj vetëm për arsye personale
2 private? A dini ju që të ketë nisë ndonjëherë ndonjë proces
3 ndonjë hetim UÇK-ja për këtë gjë?
4 PË. Po. Për atë gjykim nuk di asgjë unë. Asi se jne nuk i di,
5 veç e di që, se unë rregullisht foli me shokë dhe ju kallëzoj
6 qesi gjena edhe ata i kanë shpërnda këto fjalë krejt edhe a
7 mbush krejt populli aty që i dinë ngjarjet teme e të Enver
8 Axhanit, tashti kam ni që kanë bisedu me një njerëz, s'jam tuj
9 ia përmend emnin se s'ban, le ti rregullon ai qetash punët me
10 ta. E kanë kap prej hunde që thojnë me një fjalë. E kanë kap
11 për rastin tem. Për shka ti na rrejte Agimi a polic edhe
12 shumar i malit. Si e rrejte Sami Axhamin që e kanë rrehë
13 policia, kur s'e kanë rrehë. Ti e hupi njërin pa bë kurr gjë.
14 Ja more tokat te shtëpia i përzunë. Tash ai u bë me vra veten,
15 ama unë s'ia fal. Qështu është historia e tina.

16 Unë kam me e ndjek deri ku ka gjyq polici e çka ka. Deri
17 kur ta burgosi ta mshelin në burg të përjetshëm. T'ia goditi
18 jetën keq ma. Më ka shkatërru familjen ma ka shkatërru.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dëshmitar, besoj që thatë më
20 herët sot paradite, gjatë marrjes në pyetje nga ekipi i
21 Mbrojtjes së z. Selimi, që Enver Axhami është shkarkuar nga
22 UÇK-ja e përzunë nga UÇK-ja. A dini diçka më tepër lidhur me
23 këtë?

24 PË. E ka pasë marrë edhe një banesë të serbëve aty në
25 Kaçanik. Ia kanë qit teshat pi ballkonit poshtë janë kanë plug

1 shqiptarët vetë. E kanë përzënë e kanë çu në katund. Atje në
2 katund qetash është tu bë zullum. Jo qetaj, mbas lufte. Nuk më
3 kujtohet në cillin vit.

4 Na ka rrehë djalin e vëllavit s'ki qysh me këqyrë. E ka
5 përgjakë e ka bë për kërrkund e ka bë. Edhe policia me hi e
6 kanë mshel në Kaçanik ato shiringat i kanë mshel. Pse se
7 arrestuan atë? Duhet me u qit në gjyq policia. Trishtim më
8 vjen me pa fotografinë. Tu ndjek me dhunë. Tu ndjek me dhunë
9 "Hajde hipni për në Serbi". Për çfarë arsye ti më ndjek me
10 dhunë? Kush je ti? Kush i ka dhënë shtet atij me bë kështu?

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Mbase duhet që të jem më i
12 saktë. Pyetja që të bëra është kjo: Enver Axhamin a e kanë
13 përzënë nga UÇK-ja, me sa di ti, sepse ju ka ndaluar dhe ju ka
14 maltratuuar ju apo e kanë përzënë për arsye të tjera?

15 PË. Po e kanë përzënë edhe përditë ka fjalë me ta. Njerëzit e
16 marrin në pyetje. S'ka qysh me i dhënë përgjigje se ka bë krim
17 të rand ai. Ata nuk e kanë ditë që ka bërë qështu. Tash po ju
18 kallëzoj unë dhe kështu u bë publik. Tash e kanë marrë vesh
19 krejt. Ai tash s'ka vend kërrkund ai më.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A keni ndonjë informacion se
21 pse e kanë përzënë nga UÇK-ja, pse e kanë --

22 PË. Po e kanë përzënë se e ka përdorë UÇK-ja këqyre ça ka bë
23 ai. Te po e sheh ça ka bë. Na ka marrë tokat, jo Arkani, jo
24 polic, jo e rujt malin shumars. Fare s'vlen në pyetje kjo
25 kurrkund s'janë shënimet e mia këto. Këto janë pa u sha s'e

1 kam dëgju këtë letër gja gjë. Duhet me pasë argument. Qe ku ke
2 marrë rrogë. Ku ke punu, ça ke punu, a e ke mshel një shqiptar
3 në burg? Kallëzojna emrin more, mos e mbani msheft? Unë për ça
4 kam ardhë këtu. Duhet me kallëzu. Nëse e kam mshel Enver
5 Axhamin në burg le të kallëzojnë more. Sigurisht me shku me
6 fol atje. Ai ka bë një krim mjaft me një familje të vete.
7 Policë ushtarakë i ka pasë. Edhe ka garantu te UÇK-ja që unë i
8 marrë shënimet të sakta. Kush është ai? E ai Hebib Koka. Ah po
9 e di bi vallaj ia vë. Edhe e ka shkru gazetën, u gazeta, Agim
10 Idrizi do më vra ka ardhun policia serbe tu bë luftë me UÇK-
11 në. Thotë e ka pasë 600 euro rrogën u kanë polic. Mos i mbroj
12 ato ushtarët. Ka thënë e kena morë nëpërmes inteligjencës një
13 kopje. Kush a ajo inteligjencë? Hebib Koka e Enver Axhami.
14 Tani ta dijë gjithë populli që janë të këqinj. Po më kallëzon
15 ti mu inteligjencën. Ia ka ni zënin inteligjencës.
16 Inteligjenca Hebib Koka e Enver Axhami i kanë dhënë shënimet e
17 mia. Edhe unë sot qysh jam tuj hek ka mos, tuj ik ka mos. Ne
18 duhet me i ndërpre këto gjana. Duhet me e marrë Enver Axhamin,
19 Nehbi Kokën, Qemal Draganin, Zeni Axhamin, Zekir Axhami. Zekir
20 Axhami a e dini ju shka ka thënë? Le ta dinë këta këtu shka
21 janë. Kjo dhe më e keqja. A më lejoni ta bëj qët pyetje? Se
22 është shumë e trishtueshme.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, jo
24 e keni tejkalluar pyetjen që ju bë nga Gjykatësi.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kam një pyetje të fundit për

1 ju, Dëshmitar, a ke ndonjë informacion se kur z. Enver Axhami
2 është përzënë nga UÇK-ja? Kur ka ndodhë kjo gjatë luftës apo
3 pas luftës?

4 PË. Mbase kam dalë jashtë. Nuk më kujtohet. Veç kam ni pi
5 njerëzve, pi shokëve, se s'folin shumë, që tash kërkush s'a tu
6 fol ka mbete vetë. Nuk i fol kërkush edhe e kanë përzënë. Nuk
7 a si përpara qysh e kanë mendu që është ushtar i mirë, ushtar
8 i ndershëm, domethënë, nuk e kanë ditë ç'a farë krimi ka bë
9 edhe për çka më ka marrë mu. Nuk e kanë ditë ata. Unë për atë
10 kam dalë këtu në publik me ju kallëzu. Nesër mos ma bën me
11 gisht dikush me më thënë se e kishin shkru menjëherë dje ato
12 ky a tradhtar i kombit. Çfarë do të thotë tradhtar i kombit
13 jam bre? Pse ta ka mshel UÇK-ja në burg a? Amerika, Amerikë e
14 mshel ushtarin 20 vjet burg. Këtu e heq. Këtu veç msheja mos
15 fol për UÇK-në keq. Unë s'jam tu akuzu UÇK-në. Unë jam tu
16 thënë një grup, një familje. Që kjo është.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dëshmitar. Dëshmitar, ju
18 lutem më dëgjoni. Faleminderit shumë. I keni dhënë përgjigje
19 të gjitha pyetjeve që kisha për ju. Ju falënderoj pa masë.
20 Faleminderit.

21 PË. S'më latë qëtë me kallëzu për Zekir Axhamin. Është shumë
22 interesant. Le ta dijë populli atje.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
24 këtu jeni për t'ju përgjigjur pyetjeve. Kështu që ju lutem
25 dëgjoni pyetjet që ju bëhen dhe përgjigjuni pyetjeve.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi
2 Smith.

3 Mirëdita, Dëshmitar.

4 PË. Mirëdita.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kam dy fusha të vogla të
6 dëshmisë tuaj pretë cilën dua t'ju pyes. Do ju kërkoja ju
7 lutem që të më jepni përgjigje të shkurtra. E kuptoni?

8 PË. Po, po.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në qoftë se mundeni
10 përgjigjuni me "po" ose "jo", këtë do preferoja.

11 PË. Urdhnoni. Urdhnoni.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe në qoftë se kam ndonjë
13 pyetje tjetër për t'u sqaruar do ju bëj pyetjen plotësuese.
14 Faleminderit.

15 PË. Po, urdhnoni.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Fusha e parë
17 për të cilën dua t'ju pyes është e lidhur me pyetjet që ju
18 bëri z. Misetic, pra, kanë të bëjnë me një listë që të ka
19 treguar Enver Axhami pas arrestimit nga UÇK-ja. E kuptove?
20 Domethënë, dua të të pyes lidhur me këtë listën, për këtë e
21 kam pyetjen.

22 PË. Po.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e kuptoj drejtë, se me
24 sa e keni kuptuar ju, kjo listë përmbante emra të njerëzve që
25 UÇK-ja dëshironte t'i arrestonte apo t'i kidnaponte, se këtë

1 fjalë ke përdorur në një prej deklaratave tuaj --

2 PË. Po, po.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] -- domethënë, kjo lista

4 përmbante emrat e njerëzve që UÇK-ja donte të arrestonte?

5 PË. Po.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nëse e kuptoj dëshminë

7 tuaj, kjo listë i është dhënë z. Axhami nga Hebib Koka, këtë

8 ke thënë?

9 PË. Po, kështu është. E saktë.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po Hebib Koka kush ishte

11 në atë kohë?

12 PË. Hebib Koka --

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ishte anëtar i UÇK-së,

14 çfarë ishte, kush ishte?

15 PË. Habin Koka ka punu në policien serbe që në kohën e Titos,

16 më kujtohet. Moti punon ai milic. Dhe ka nejt apet në kohën e

17 Millosheviçit, deri qatë ditë që jam kidnapu unë Hebib Koka në

18 polici ka punu. Dhe ke ka pasë autoritet të madh që i ka marrë

19 demok shënimet edhe ia ka dhënë Enverit. Enveri i ka çu te

20 shtabi. Tashti le të marri vesh me Enver Axhamin Hebib Koka.

21 Ai i kallëzon kush janë këta. Edha ata po i njofshin mirë.

22 Tash ta dhana përgjigjen.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

24 PË. Faleminderit shumë për këtë pyetje.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po përpigem të kuptoj dhe

1 me sa kuptu ju në qoftë se nuk e dini, thoni që nuk e di, por
2 mesa keni kuptuar ju, në kohën kur jeni marrë në pyetje dhe
3 kur jeni burgosë, jeni arrestu, ju a e dini në qoftë se Hebib
4 Koka ka qenë anëtar i UÇK-së --

5 PË. Hebib Koka kam ni pi njerëzve se --

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] -- apo ishte akoma zyrtar
7 i policisë serbe?

8 PË. Jo, jo. Kam ni q'atë ditë që u përgatita me ik ka deshe
9 me na i bë një dëm të madh neve dhe familjes Bruti. Tash ai
10 janë tu na përcjellë atje, duhet me i kallëzu këta se shka
11 janë tu na bë këto as Millosheviçi s'e ka bë këtë. Kanë desh
12 me na bë në luftë keq.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë
14 Dëshmitar, pyetjen e kam të thjeshtë. Z. Koka a ishte ushtar i
15 UÇK-së në atë kohë, apo jo? Po, jo apo nuk e dini?

16 PË. Z. Koka e ka marrë telefonin e policies serbe dhe ka shku
17 tek -- iu ka bashkangjitur UÇK-së.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dokumenti që ju thatë që
19 keni parë që kishte ato emrat, a patë ndonjë nënshkrim ndonjë
20 vulë apo ndonjë tjetër stemë ndonjë tjetër dalluese në ato
21 dokument, apo thjesht vetëm emrat ishit s'kishte asgjë tjetër.

22 PË. Një fletore e kish pasë, qatë fletore e lexojke ai. U
23 trimnojke ai ke e lexojke. E di sa i madh është bë aty te UÇK-
24 ja? Ish bërë shumë njeri i madh. Demek i ka murr
25 informacionet. Ky është tuj i dhënë të sakta. Tashti ta këqyri

1 çfarë informacioni ka ai, le të shkon e t'ia vqet tash kanë me
2 morë atje në Kaçanik ata. Menoj që kanë me e marrë. Kush t'i
3 ka dhënë këto informacione Hebib Koka. Ti me Hebib Kokën krejt
4 ato gjena i keni sjellë e sot telashe njerëzit kanë. Duhet me
5 pasë argument të mirë e të saktë. Ai që ka punu polic, Hebib
6 Koka ai duhet --

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në rregull. Do kalojmë
8 edhe aty, po duroni një sekondë. Do t'i marrim gradualisht hap
9 pas hapi, nëse më lejoni.

10 Kur e pe këtë fletoren me emrat apo këtë dokumentin që po
11 përdorte ai, a patë ndonjë vulë në të? A patë, për shembull,
12 ndonjë emblemë, ndonjë stemë, ndonjë vulë?

13 PË. Jo, jo, s'kam pa kurrëgjë veç fletore që a dhe emna kish
14 shkru shumë atje. Na i lexoj që me ditë demek që unë jam tuj i
15 mbledhë këto spiunat. Me pa unë si person. Qaq i ish rritë
16 mendja.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Na tregove se sipas këtij
18 individi emri juaj ishte pjesë e asaj liste, kështu?

19 PË. Po, po emnin tem e kish shti aty.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po Shaban Idrizi a ishte
21 në atë listë?

22 PË. Shaban Idrizi?

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shabi Idrizi.

24 PË. A Shabi. Po edhe ai ish kanë në listë.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Me sa dini ju Shabi Idrizi

1 a ka pasë ndonjë kontakt me institucionet serbe? E kam fjalën
2 ose gjatë luftës ose dhe përpara luftës, ka pasë ndonjë
3 kontakt ai me institucionet serbe?

4 PË. Vallaj me të kallëzu të drejtën, vëllain e vetë e kanë
5 rrehë njëherë policia serbe. Më kujtohet një Shaban, më i
6 madhi është. E kishin pas rrehë. Shkaki i gruas qëtij Shabies,
7 diçka probleme kishin pasë. Dhe qaq di ë shumë s'di për të.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do ju tregoj shkurtimisht
9 një dokument që ua tregoj edhe Prokurori dhe ekipet e
10 Mbrojtjes. Për Sekretaren është dokument IT-05-876D00484.

11 Këtë listë e keni parë dhe më herët, Dëshmitar.

12 Do i kërkoja Sekretares të kalojmë në fund të faqes.

13 Dhe sikurse e thashë, këtë listë e keni parë dhe më
14 herët. Do t'ju pyes për emrin 28. Është Shabi Miljaim Idrizi.
15 A bëhet fjalë për këtë person? Për këtë person e keni përmend
16 juve, me sa dini ju?

17 PË. Po, po.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] I njëjti person është ky?

19 PË. Po, i njëjti.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e dini ju që ai besohet
21 që ka nënshkruar me institucionet serbe me sigurinë vendore të
22 Serbisë? A e dini këtë gjë? Ose të paktën kështu pretendohet?

23 PË. Jo, jo. Nuk di kështu gjena. Veç jam tu të kallëzu qëna
24 me këtë familje fort s'kena hi, s'kena dalë, se jena kanë si
25 shumë larg keq. S'kena pasë fort marrëdhënie të mira.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, nga përgjigja që
2 thoni me ç'kuptoju nuk e dini që Shabi ka pasë lidhje me
3 institucionet e sigurisë serbe?
4 PË. Këto muni me pyet për këto gjena muni me i pyet ato
5 njerëzit që kanë mbajtur mbledhje që janë kanë me këta bashkë,
6 që kanë bashkëpunu, për shembull, muni me i gjetë ato në listë
7 edhe i merrni në pyetje ata kallzojnë për njani-tjetrin. Unë
8 kurrë s'kam marrë pjesë në kësi gjena. As nuk i njoh. S'e di
9 sha kanë bë.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do ta përsëris edhe
11 njëherë pyetjen, ju lutem më thoni nëse e dini ose nuk e dini.
12 A e dini në qoftë se ai ka pasë ndonjë lidhje me sigurimin
13 serb ky personi domethënë, Shabi Idrizi a ka pasë a nuk ka
14 pasë, po apo jo? Po s'e dite nuk e di.

15 PË. Nuk e di se s'e kam as vëlla as - jena të largët shumë
16 jena gjak.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ju kujtohet në qoftë se
18 emri i Halit Lokit ka qenë një emër që ishte pjesë e asaj
19 listës që keni pa? A e mbani mend që z. Misetić ju tregoi një
20 listë dhe njëri prej emrave ishte i Halit Lokit? Të kujtohet
21 kjo?

22 PË. Po Halit Lokin e kam njoftë. Kështu e njoh që ka punu për
23 shembull, në sigurim. Tani ka dalë në pension edhe më s'di gjë
24 për të.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e dini në qoftë se ai ka

1 qenë i arrestuar e kanë pasë arrestu gjatë konfliktit?

2 PË. Po, po. Qëtash mu mu tek, ka ardhë një plak te unë me më
3 pa dhe më ka kallëzu që e kanë marrë në Maqedoni e kanë pru
4 gjoja me një vend ka Kaçaniki, po një shqiptar atje ish kanë e
5 kish njoftë dhe e kish lshu. Ka qenë gjallë ai. Ka dek më
6 duket ai pi vetit. Nuk ka pasoja.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po Bashkim Lokin?

8 PË. Bashkim Loki.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ky Bashkim Loki ka qenë
10 pjesë e asaj liste?

11 PË. Bashkim Loki a kanë një fukara. Ja kanë lip një allti,
12 një manxerkë. Ka punu te unë ka 10 euro ia ka çu kamionin e
13 mikit të vetë me dru i ka bajtë te unë. Jam kam dhënë turrën
14 ka dhjetë euro në ditë. Edhe për një mazer me një allti ka
15 pasë problem ai. Q'atje e di. Edhe unë shkaktari jam ai që
16 tash gjallë. Unë ia kam lëshu pi Jenuz Shurdhanit. Kam fol
17 mirë për atë edhe q'ashtu është. S'ka bë gja djali. Dhe sot
18 është tu punu me te fëmijët e mi, te shtëpia vetë.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pyetja që ju bëra është që
20 në qoftë se të kujtohet nëse e ke parë te lista emrin e
21 Bashkim Lokit? A e kishte emrin Bashkim Loki te lista që po
22 përdorte Enver Axhami?

23 PË. Po listën e kam pa të shkruame ama për me e lëshu pi
24 burgit unë e kam lëshu. Ai e di. Bile unë u gëzova që e lshoi
25 Jenuz Shurdhani se deshta me çu me i numër do pare i kam pasë

1 37.000 marka dhe ato pare thashë mu knejna dojnë me pushkatu,
2 kënej e kemi ne, më shkojke mendja ka mos edhe s'un i thashë
3 "Shko Bashkim merri paret i kam lënë në filan vend" bile
4 kështu e lëshova. Edhe paret mi ka marrë ky. Kam punu 40 vjet
5 pa nal hiç.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mund ta shohësh dokumentin
7 që keni përpara në ekran ju lutem tek numri 25. A bëhet fjalë
8 për të njëjtin person Bashkim Sulejman Loki, për këtë po
9 flasim ne?

10 PË. A Sulejmani e ka mbiemrin? Apo Baba Sulejmani? Qëta s'po
11 e kuptoj.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Këtu shkruhet Bashkim
13 Sulejman Loki.

14 PË. Po, Bashkim Loki. Po Sulejman a është baba? Se babën s'ia
15 di emnin.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] As unë nuk ia di,
17 Dëshmitar.

18 PË. Nejse, po këna me siguri hajd fol. Bashkim Loki. Ky
19 është.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Duke menduar që është i
21 njëjti person, a di ti në qoftë se ka pasë ndonjë lidhje z.
22 bashkim Loki me aparatën e sigurimit të shtetit të Serbisë, a
23 di ti që ka pasë ndonjë lidhje ky me këtë aparat?

24 PË. Jo, jo. Unë për qetë duart në zjarr me i shti pse i ka bë
25 keq kujna. Ai me kanë s'ish në Kosovë. Po ai është Kosovë. Si

1 e kanë lëshu atë ditë, gjenia se rroni atë njeri më kurrë s'e
2 ka vetë: Ku je kanë? Ose ke nje a ka po dal? Po është i lirë.
3 Ai e di faleminderit që e kanë lëshu se njërin pa faj s'bën
4 mik.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk po të pyes në qoftë se
6 ai ka bë dëm ndokujt apo jo. Po ju pyes dhe ju lutem më thoni
7 në qoftë se e dini apo jo, po apo jo, po ju pyes në qoftë se
8 ke dëgju ndonjëherë apo e di që Bashkim Loki ka pasë lidhje me
9 sigurimin serb, po apo jo?

10 PË. Jo, jo. Jo, jo nuk kam ni. Veç e di që mamzerkë edhe një
11 allti ia kanë lyp policia serbe. Qëta e di. Edhe e dinë ata
12 kush i ka thërret kush janë ata. Ky s'ka pasë me i dorëzu.
13 Këtë e di që s'ka pasë me i dorëzu as allti, as atë.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dua t'ju pyes për diçka
15 tjetër. Do vazhdoja që t'ju kërkoja që të përgjigjeshit shumë
16 shkurt nëse mundeni, siç jeni përgjigj deri tani. Dua t'jua
17 t'ju pyes me një fushë tjetër të dëshmisë që ke dhënë për
18 autoritet e tjera të ndryshme.

19 Pra, pyetja ka të bëjë me lëvizjet tuaja ndërkohë që
20 ishit nën ruajtjen dhe nënkontrollin e UÇK-së. Së pari do të
21 jap një përmbledhje dhe më dëgjoni në qoftë se i kam kuptuar
22 siç duhet këtë lëvizjet tuaja dhe pastaj do ju bëj disa
23 pyetje.

24 Me siç e kam kuptuar unë ju jeni dërguar në gjashtë vende
25 të ndryshme gjatë kohës kur ke qenë i arrestuar. Nga shtëpia

1 në Llanishte në fillim të marsit. Nga Llanishti në Bob. Nga

2 Bobi në Kukaj.

3 PË. Po.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nga Kukaj në Çiçevaç --

5 PË. Po. Në Ivajë. Kjo a Ivajë.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Edhe në Ivajë. Pastaj nga

7 Ivaja në Çiçevaç dhe Kaçanik.

8 PË. Në Ivajë. Tani pi Ivajës, Kukaj, Biçeç, Varosh.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Prej aty në Varosh dhe
10 prej Varoshit te ai vendi ku më pas u largove ti se doli

11 makina nga rruga, kështu?

12 PË. Po, po.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Këto lëvizje, në qoftë se
14 e kuptoj siç duhet dëshminë që keni dhënë, kanë zgjatur rreth
15 një javë. Domethënë, gjithë ky rrugëtim, në qoftë se mund ta
16 quaja kështu domethënë, ka zgjatur pak a shumë një javë. A
17 është e saktë kjo?

18 PË. Këto burgosje sha kena heq krejt, këto lodhje, rrehje
19 bam, qësi sene dhjetë ditë e dhjetë net shkrujnë atje. Ka tri
20 netë na kanë mbajt secilin në burg e në bunkerë. Te Kukajt pak
21 na ka mbajt na kanë hjek.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Gjëja e parë për të cilën
23 dua t'ju pyes këtu është kjo. Mesa ju kujtohet ju, afërsisht
24 sa ushtarë të UÇK-së erdhën në shtëpinë tuaj atë ditë për t'ju
25 marrë nga shtëpia? Ju kujtohet sa veta ishin që erdhën për

1 t'ju marrë nga shtëpia?

2 PË. Po, mor qysh jo. Tetë ushtarë kanë hi në shtëpi. Dy i
3 kanë ruajte dy vëllaznit dhe një Kapitan e thirrën një plak. I
4 kanë ruajte përjashta dere atje. E këta tetë vetë kanë hi
5 mbrena mi kanë thi xhamat, derën, ma kanë kontrollu shtëpien.
6 S'kanë gjetë kurrgjë. Një ta fërterkën e kanë gjetë. Thanë
7 "Pse e ke shti këtë furkën brena?" "Këtë furkën me e shti
8 mbrena pse? Armë s'kam. Dhe s'kanë gjetë. [Folës që flasin
9 njëkohësisht].

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, tetë veta ishin në
11 këtë rast.

12 PË. Po.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po në raste të tjera, pra,
14 kur të kanë shoqëruar në vende të ndryshme që i përmendëm pak
15 më herët, zakonisht sa veta ishin nga UÇK-ja, sa anëtarë të
16 UÇK-së ishin që ju shoqëronin ju? Një? Dy? Tre? Sa?

17 PË. Po pi Ibajës na kanë shoqëru tre. Njënin e njoh e mirë. E
18 kam pasë shok shumë të mirë e kam pasë, po më tradhtojë. Në
19 luftë më ka tradhtu. Ka bë roje me dy shokët e vetë. Gjithë
20 kësaj periudhe deri në Varosh. Ene aty në Biqec na ka ruajt
21 Xhabir Elezi. Këto kanë shku janë përgatit, vendin e kanë
22 përgatit, kerret. Kanë ardhë na kanë marrë na kanë çu Varosh.
23 Kur kanë ardhë në Varosh, atje na kanë rrehë na kanë bë për
24 kërrkund. Masakër na kanë bë. Krejt buzët mi ka ça komandant
25 Era. Unë kurrë emnin s'ia kam kallëzu këtij, se tjetër kush e

1 ka qit në emën e mbiemën. Ai le ta bajë këtë përgjegjësi. E
2 unë e kam njoftë që është i Kaçanikit i Runevës. Shumë mirë e
3 kam njoftë. Veç e thirrshin Era, Era, Era. Thotë tre [e
4 pakuptueshme].

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju lutem përqendrohuni tek
6 pyetja që u bëra. Këta ushtarët e UÇK-së që ju shoqëruan,
7 gjatë gjithë kohës që ju kanë shoqëruar kanë qenë të armatosur
8 apo jo?

9 PË. Po të armatosun kanë qenë.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Me sa mund të shihnit ju a
11 kishin ndonjë mjet komunikimi a kishin radio marrëse-dhënëse,
12 telefon ndonjë mjet tjetër komunikimi, ke parë gjë?

13 PË. Kanë pasë telefon. Kanë pasë alltia, bome. Kanë pasë
14 automatik. Te shtëpia më kanë hi me maska.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po kështu ndonjë radion
16 marrëse-dhënëse, ndonjë telefon, ndonjë gjë për të komunikuar
17 a ju patë gjatë kohës që ju shoqëronin këta burrat?

18 PË. Jo, ata na kanë mshel në Biqec atje. Na ka ruajt qeky
19 Xhabiri. Këtë e kam pasë shoq edhe a kanë polic mbrojtje ai në
20 Kaçanik moti në kohë është ajo. Mandaj e lanë punën në atë
21 kohë policia dhe ki e ka pasë lanë. Tash aty ku e di a kanë
22 polic a s'a kanë nuk e di, na ka ruajte te dera. Tri ditë e
23 tri net, as bukë, as ujë as kurrëgjë s'na kanë dhanë. Na ka një
24 gru ish kanë aty tuj rujt lopët, ia lypa do të ambël se jena
25 tuj dekë pi stofit. Na e dh dhe do bukë nxetë. Qata e di.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do ta përsëris edhe një
2 herë për të fundit herë pyetjen. A ke parë ndonjë mjet
3 komunikimi e kam fjalën konkretisht për telefon ose për radio
4 marrëse-dhënëse? Ke pa mjete komunikimi?

5 PË. Jo, atje na s'kanë fol atje te na me telefona.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pyetja ime e fundit është
7 kjo, me aq sa dini ju a e di ti se kush e mori vendimin për
8 t'ju çuar ju nga një vend te tjetri? E di se kush ka vendosur
9 që ti të çoheshe nga një vend te tjetri gjatë asaj periudhe?

10 PË. Këtë pyetje shumë qartë ma ke dhënë edhe unë du me kthy
11 tash. Këtë ekzekutim timin, qysh me thanë, e ka bë Enver
12 Axhami, Rustem Dielma [fonetikisht] dhe Fadil Qoka edhe
13 komandant Era. [E pakuptueshme] edhe ky Bujar Tafili. Këta
14 janë shkaktarë që unë jam sot qetu. Kanë desh me më çu me më
15 ekzekutu.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Për të qenë të qartë, ti
17 kupton dhe e kupton, domethënë, mënyra si e kupton ti është që
18 këta janë personat që kanë dhënë urdhër që ty të lëvizin nga
19 një vend tek tjetri, kështu?

20 PË. Po, po. Këto janë.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shumë faleminderit,
22 Dëshmitar.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë pyetje
24 plotësuese nga Prokuroria?

25 Z. Laws?

1 Ekipet e Mbrojtjes?

2 Mbrojtja e Thaçit e para?

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Kam vetëm një pyetje të shkurtër.

4 Pyetje vijuese të palës tjetër nga Z. Misetiç:

5 Z. MISETIC: [Përkthim]

6 PY. Dua të sqaroj diçka, Bashkim Loki dhe Halit Loki janë dy
7 persona të ndryshëm?

8 PË. Po këta janë të njëjtit katund ma merr mendja. Po ky
9 Haliti moti a kanë në Kaçanik. Unë jam kanë i ri atëherë kur
10 ka ra Haliti në Kaçanik se ai punon mbrojtje a në sigurim a ku
11 e di ku ka -- në polici ka punu Ferizaj në atë kohë. Unë jam
12 kanë i ri e nuk e di a u rrit në Kotlinë në atë katundin a u
13 rri në Kaçanik s'e di. Edha janë njofun me Bashkim Lokin.
14 S'muj me ditë. Se s'më ka interesu, s'kam pasë punë kurrë me
15 ta. E Bashkim Loki ka jetu ka jetu në katund atje në Kotlinë.
16 Tash nuk jeton atje.

17 PY. Faleminderit, Dëshmitar.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kam pyetje tjera.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

20 Mbrojtja e z. Veseli, jo.

21 Mbrojtja e Selimit, jo.

22 Mbrojtja e Krasniqit, jo, gjithashtu.

23 [Mikrofoni çaktivizuar].

24 Dëshmitar, më dëgjon, e keni përfunduar dëshminë para

25 Trupi Gjykses sot. Do t'ju shoqërojë Sekretarja, do t'ju

1 nxjerrë nga salla e gjyqit. Ju falënderojmë për informacionin
2 që na dhatë sot dhe për dëshminë përpara Trupit Gjykues. Ju
3 urojmë gjithë të mirat.

4 DËSHMITARI: Faleminderit edhe pi juve. Edhe ju kisha bë
5 thirrje, tash do me ju a bëni thirrje atje në Kaçanik që nëse
6 ka dikush që ka informacione për Agim Idrizin që kam mshel
7 shqiptarë në burg le t'i shkrujnë në internet a diku, le të mi
8 çojnë shënimet s'uni shqiptari e kam çu në burg edhe kujna i
9 kam lajmëru armën. Qëto du i di të kjarta. Edhe a jam kanë
10 polic edhe jam kanë rojtar i malit. Këtë duhet me e bë publik
11 ata në Kaçanik. Nëse jam kanë le të kallëzojnë.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
13 Dëshmitar.

14 DËSHMITARI: Faleminderit dhe pi juve. Se dje menjëherë ma
15 kishin shkru tradhtar i kombit. Marre duhet me i ardhë.
16 Tradhtar i kombit a di kuj na i thojnë? Më kanë ba rezil më
17 kanë ba. Po ma kanë bë punën ndahet qetu. E dikush duhet me
18 pagu për jetën time ma kanë shkatërru.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, të
20 lutem.

21 DËSHMITARI: Mi kanë marrë krejt paret ça kanë punu 40
22 vjet. Dhe ala thojnë mos fol, mos fol.

23 Ditënë e mirë e bëfshit faleminderit shumë. Jam shumë i
24 kënaq për krejt gjënat që keni bë e më keni pru qetu. Edhe që
25 na keni lanë me dalë në publik. Se e unë e kam lyp me dalë në

1 publik. Edhe unë e kam lyp me qetu. Jo polici e gjykata
2 speciale. Unë vetë kam ardhë qetu. Le ta dijnë.

3 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

4 Z. EMMERSON: [Përkthim] Përpara sesa të ngriheni në këmbë
5 të nderuar Gjykatës, ka një çështje që ka të bëjë me dëshminë
6 ka një problem që ka të bëjë me dëshminë e dëshmitarit të
7 radhës. Për këtë kërkojmë një urdhër të shkurtër. Duam që të
8 bëjmë parashtrime me gojë përpara sesa të sillet dëshmitari.

9 Kam përshtypjen që do të më duhet 10, 15 gjithsej jo më
10 shumë.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
12 çaktivizuar]. Kur të kthehemi pas pushimit të drekës do ta
13 trajtojmë këtë problem që ngritët.

14 Po ashtu do të jap një urdhër edhe për sa i takon
15 1D46MFI.

16 Kundërshtimi i ZPS-së rrëzohet. Pra, gjetjet e Trupit
17 Gjykues nuk kanë relevancë nuk kanë vlerë provuese, kështu që
18 ne nuk kemi pse marrim parasysh vendimin ose aktgjykimin e
19 gjykatave të tjera. Gjithsesi do japim një urdhër gojarisht më
20 vonë lidhur me këtë çështje.

21 Do bëjmë pushim deri në orën 2.30.

22 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.04

23 --- Seanca rifillon në orën 14.30

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Emerson,
25 e kuptojmë kërkesën. Do ta japim do ta miratojmë kërkesën po

1 ju lutem bëheni kërkesën për pesë minuta se kemi dëshmitar që
2 ka 16 orë të parashikuara.

3 Jemi në dijeni të mocionit tuaja e kemi parë emailin
4 sikurse mund ta dini unë në korrik e kam marrë një vendim të
5 ngjashëm kështu që s'ka asnjë gjë të re këtu.

6 Z. EMMERSON: [Përkthim] Faleminderit. E njoh, jam i
7 njohur me vendimin e korrikut, e 18 korrikut, sa i takon
8 dëshmisë së 02153, megjithatë doja që të merrej vendim për dy
9 gjëra. E para, për opinionet që japin dëshmitarët, provat
10 opinion, nuk ka vendim për këtë. Edhe nuk mund të jepen
11 opinione të cilat pastaj duhet t'i marrë -- nuk mund të merren
12 parasysh opinionet për të marrë vendime Trupi Gjykues. Se sa i
13 takon opinioneve të dëshmitarëve duhet parë njëherë ku është
14 baza e këtyre që thuhet.

15 Tani do kërkoj dhe një sqarim sa i takon dëshmitarit të
16 radhës çfarë ndikimi ka kjo në dëshminë e tij. Do ta them në
17 këtë formë, është thjesht dëshmi opinionesh.

18 Ka disa prova, ka një raport, po kjo është e bazuar në
19 dëshmitë personale takimet që ka pasë me personat në një rast
20 madje ka parë edhe se çfarë ka ndodhur pas një sulmi. Kjo ka
21 të bëjë me një masakër serbe në zonën e Drenicës dhe kjo është
22 e publikuar në raportin thuhet Një Javë Terrori në Drenicë
23 titulli i raportit.

24 Por shumica e dëshmimeve të tij janë opinione, s'kanë asnjë
25 lloj burimi. Dhe është e rëndësishme, duke pasur parasysh si

1 kanë vendosur trupat e tjera gjykues për këtë dëshmitar dhe
2 për raportet që dorëzon ky, përfshirë dhe disa nga raportet që
3 janë dorëzuar këtu, ai ka përdorur të njëjtat parime dhe uroj
4 që të keni parasysh kur të merrni vendim, vendimin që morët të
5 18 korrikut.

6 Dëshmitari jep një dëshmi të konsiderueshme, po që janë
7 opinionet e tija për strukturën e komandimit të UÇK-së,
8 mendimet e tij për kategoritë që mund të konsiderohen si
9 kolaboracionistë në momente të caktuara kohore, jep dëshmi për
10 një numër të pretenduar apo disa forma të ndryshme të
11 pretenduara krimesh. Edhe po ashtu mendimet e tij janë që disa
12 nga gjërat që ndodhin janë se janë thjesht politik e UÇK-së.
13 Dhe ai thotë, "Sikur të mos bëhej kjo, mund të mos kishte
14 ndodhur kjo".

15 Pra, në një rast pas sulmit pas qershorit 1999, vetë
16 raporti thotë ne nuk jemi në gjendje të tregojmë në qoftë se
17 ka qenë politik e UÇK-së apo kanë qenë grupe të caktuara
18 sporadike të UÇK-së këta që vepronin në mënyrë të izoluar.

19 Po ky është raporti. Edhe ai komenton për raportin e tij
20 vetë dhe tani ka ardhur në bankën e dëshmitarëve sepse ai ka
21 ndryshuar dhe opinionet pasi ka lexuar dhe raportin e Dick
22 Marty dhe sigurisht, që ky i fundit, nuk do të thërritet në
23 këtë proces gjyqësor.

24 Kështu që kemi disa vështirësi me këtë dëshmitar që nuk i
25 ka trajtuar as Prokuroria, qoftë për ta trajtuar ata vetë,

1 goftë për t'u përgjigjur parashtrimeve tona.

2 Trupi Gjykses duhet ta zgjidhë këtë problem, mund të
3 thotë nuk është Dëshmitari 154, raportet e tij nuk do të
4 pranohen automatikisht, prandaj duhet gjetur baza për çdo
5 pistë pyetjesh që do bëjmë. Edhe unë i qëndroj pozicionit,
6 qëndrimit që kam pasur dhe në vendimin e korrikut 2018, por ne
7 e dimë që ky dëshmitar nuk e ka të bazuar shumicën e gjërave
8 që thotë. Këtë e ka thënë në shënimin përgatitor, e ka thënë
9 në deklarata të ndryshme. Ai thotë: Nuk e di kush e ka thënë
10 këtë. Madje ai thotë, as nuk e kemi pasur mundësi t'i hetonim
11 krimet që pretendohet se kryheshin nga UÇK-ja dhe ai s'ka
12 pasur drejtpërdrejt asnjë përfshirje.

13 Ai mund të thotë këtë, në periudhën para qershorit 1999,
14 fokusi ynë ishte te krimet serbe edhe nuk janë marrë fare me
15 pretendimet e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Dhe pas
16 qershorit të 1999, po ashtu ishin të fokusoheshin të mbronin
17 pakicat kryesisht. Por në këtë periudhë, ama në këtë periudhë,
18 ata janë mbështetur në një organizatë tjetër, pra,
19 informacioni që u jepte një organizatë tjetër që ishte qendra
20 juridike humanitare dhe merrnin opinionet e tyre dhe i hidhnin
21 në një raport.

22 Pra, problemi është shumë herë më i ndërlikuar sesa
23 situata që patëm në dëshmitarët e korrikut.

24 Unë dua t'ju lexoj sesi është trajtuar kjo çështje nga
25 Trupi Gjykses në Milutinovic dhe të tjerë, që është prova me

1 numër IT-05-87-T, e 1 shtatorit 2006. Është aktgjykim në
2 paragrafin 22 deri në paragrafin 24. Aty janë fokusuar në një
3 raport të OSBE-së me titull "Sikurse është parë, Sikurse është
4 treguar" dhe një raport tjetër të Human Rights Watch dhe
5 dëshmia e këtij dëshmitarit. Është një raport "Një javë terror
6 në Drenicë" dhe shpjegohet qasja që kanë ndjekur ata, që është
7 zbatimi i parimeve që unë i përmenda pak më herët.

8 Më falni se s'kam kopje, po unë do ju lexoj tre paragrafë
9 për procesverbal. Paragrafi 22:

10 "Prezantimin në seksionin, hyrja e librit *Sikurse është*
11 *parë, Sikurse është treguar* përmban fakte që janë disa
12 pretendime që 'janë të mbështetura vetëm në ato që mendonte
13 një person i caktuar', informacione të tjera janë marrë nga
14 intervista dhe 'prova dytësore dhe nuk janë deklarata të
15 dëshmitarëve a të personave të përfshirë drejtpërdrejt', ka
16 'mospërputhshmëri mes detajeve që kanë dhënë të intervistuarit
17 për incidente të caktuara'. Këto janë problematika që prekin
18 drejtpërdrejt besueshmërinë e këtyre deklaratave dhe të cilat
19 mund të testohen apo mund të vërtetohen përmes pyetjeve
20 drejtpërdrejt në sallën e gjyqit. Në këtë situatë, në këto
21 rrethana, as raporti dhe as duke mos pasur mundësinë të
22 kundërpyeten autorët apo editorët e këtij raporti në këtë rast
23 bëhet fjalë për Abrahams -- më falni do ta lexoj dhe njëherë
24 atëherë:

25 "Në këto rrethana, nuk kemi mundësi të kundërpyesim asnjë

1 nga autorët e raportit edhe kjo nuk na jep mundësinë që të
2 vërtetojmë besueshmërinë e personave që kanë bërë këto
3 deklarata. Trupi Gjykues nuk ka material të mjaftueshëm për të
4 përmbushur kriterin e besueshmërisë së informacionit ku është
5 mbështetur ky raport.”

6 Pra, kjo është e vetëkuptueshme që raporti duhet të
7 pranojë por vetëm me një përjashtim.

8 Paragrafi 23:

9 “Këto përfundime vlejnë njësoj edhe për *Nën Urdhra*”.

10 Që është raporti i Human Right Watch që është pjesë e
11 provave që do t’i paraqiten Trupit Gjykues këtë pasdite.

12 “Pavarësisht skepticizmit të madh që ka pasur Human Right
13 Watch sa i takon hetimit, metodikave, kushteve në mënyrën sesi
14 është mbledhur informacioni lidhur me pretendimet mes marsit
15 dhe qershorit 1999, janë po ashtu të ngjashme, pra, situata
16 është e ngjashme me raporte të tjera të Human Right Watch edhe
17 këto shkaktojnë të njëjtat shqetësime sa i takon besueshmërisë
18 së informacioneve. Këto raporte diskutojnë specifikisht, për
19 shembull, në paragrafin 32. Për shembull, marrim një grupim
20 raportesh, marrim raportin “*Një javë terror në Drenicë:*
21 *Shkelja e të drejtave njerëzore në Kosovë, kjo është si*
22 *rezultat i vëzhgimeve personale*” nga dëshmitari “dhe
23 intervista intensive me më shumë se dy duzina persona që kanë
24 qenë të përfshirë...”

25 Që kanë parë masakrën që u ka ndodhur familjeve shqiptare

1 nga serbët, kur shkoi vetë në vendngjarje dhe bëri tamam hetim
2 të mirëfilltë.

3 "..."vrasjet e pretenduara të shumë anëtarëve të familjes
4 Delija në fshatin Obri e Epërme - ku z. Abrahams dhe kolegët e
5 tij ishin në vendngjarje ditën kur ndodhi incidenti.
6 Kohëzgjatja e hetimeve u përshkrua, që ka zgjatur me javës, sa
7 i takon *Nën Urdhrave*, nga ana tjetër z. Abrahams mendonte se
8 'këto intervista në disa raste ishin shumë të shpejta sepse
9 disa prej personave kalonin, vinin me traktor...' "

10 Ju keni parë dhe deklaratat e tij sesi refugjatët
11 shqiptarë kalonin kufirin, pra, ai e pranon se intervistat
12 ishin të shpejta, pra, në disa raste këto intervista ishin të
13 shpjeta sepse personat thjesht kalonin kufirin me traktor dhe
14 kishin mundësi ta pyesnin: Nga je? Ku jeton? Kaq mund të
15 bënin".

16 Prandaj Trupi Gjykues del në përfundimin se:

17 "Prova materiale P441", pra, *Një javë terror në Drenicë*,
18 "ka tregues të mjaftueshëm besueshmërie për t'u pranuar nga
19 Trupi Gjykues, por stafi i Human Right Watch në Shqipëri apo
20 në Maqedoni, nuk mendon, nuk e ka të gjithë informacionin e
21 bazuar për të përgatitur këto raporte, pra, e ka pasur të
22 qëndrueshëm, të pambështetshëm".

23 24:

24 "Prokurori propozon tre mënyra sesi mund të përdoren
25 raporte të cilat janë të kontestuara nga vendimi i Trupit

1 Gjykues “.

2 “(1) ‘një nga raportet vërteton’” thotë Prokuroria “‘se
3 natyra e shpërndarë dhe sistematike e krimeve për shkak se
4 japin dëshmi për aktivitetin që ka ndodhur në vendet e
5 krimeve’ dhe po ashtu (2) ‘raportet mund të mbështesin
6 dëshmitë e dëshmitarëve të drejtpërdrejtë për krimet e
7 ngritura në aktakuzë’ dhe (3) ‘raportet japin dëshmi se i
8 akuzuari ishte në dijeni të krimeve që kanë ndodhur në
9 periudhën e përmendur në aktakuzë’. Që raportet të jenë të
10 dobishëm në dy mënyrat e sapo përmendura, pra, përmbajtja e
11 tyre, Trupi Gjykues duhet të pranojë se fragmentet bazuar në
12 dëshmitë e dëshmitarëve kanë tregues të mjaftueshëm
13 besueshmërie për t’u pranuar për akuzat e ngritura, apo që ka
14 pasur elementë të caktuar të një krimi për të cilin janë
15 ngritur akuza për të akuzuarit, por nuk respektojnë kriteret”
16 për arsyet që sapo shpjeguar.

17 Sa i takon argumentit të tretë, raportet e kontestuar
18 japin dëshmi të tërthortë njoftimi dhe Prokuroria:

19 “Mbështetet në raportin e OSBE-së *Sikurse është parë,*
20 *Sikurse është treguar,* të cilat Prokuroria kërkon t’i dorëzojë
21 si dokument origjinalë”.

22 Pra, kjo ishte baza e tyre.

23 Unë, në fakt, dua t’ju them që kjo është qasja e duhur që
24 nuk është në këtë rast të themi: Një mendim, asnjë mendim.

25 Duhet të shohim me hollësi cilët raporte mund të citojmë dhe

1 cilët raporte nuk mund të citojmë. Se më është krijuar
2 përshtypja mua, që Prokuroria synon të zbulojë ç'të ketë
3 mundësi edhe ato që si ka parë dhe si ka dëgjuar dëshmitari
4 apo edhe dëshmi që dëshmitari i ka marrë në mënyrë të
5 tërthortë nga personat, çdo gjë të tillë ne do ta
6 kundërshtojmë. Në qoftë se do ndodhi kjo, mendoj që nuk është
7 mirë të ulem e të çohem unë gjatë gjithë kohës që t'i
8 kundërshtoj këto gjëra. Por ju duhet të merrni një vendim ë ne
9 duhet të na orientojë, po unë mendoj që do ta kundërshtojmë
10 shumicën e gjërave të dëshmitarit. Unë do të ndjek të njëjtën
11 qasje, siç ka pasur aktgjykimi në çështje e Milutinovic, me
12 konkretisht me raportin "Një javë terror në Drenicë".

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Tieger.

14 Z. KEHOE: [Përkthim] Sa i takon klientit tim ato janë
15 mendime, ai jep mendime të veta në raport dhe intervista që ka
16 pasur me dëshmitarët që janë krejt të kontestueshme. Kështu që
17 pajtohem me mendimin e kolegut tim, me parashtrimin e kolegut
18 tim edhe gjithashtu nuk pranojmë ne mendime të llojit, këto
19 janë mendime ky është mendimi im tani, ky është mendimi
20 pastaj. Nuk mund të funksionojë kështu.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kemi kaluar
22 kohën që kisha caktuar unë për këtë.

23 Z. Roberts?

24 Z. ROBERTS: [Përkthim] Pajtohem me kolegët.

25 Z. ELLIS: [Përkthim] Pajtohem me kolegët.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Tieger.

2 Z. TIEGER: [Përkthim] Faleminderit. Qartazi nuk e ndihmon
3 kjo Prokurorinë që të ketë mendime të pabaza apo të ftojë një
4 dëshmitar të cilët nuk e ndihmojnë vendimin e Gjykatës.
5 Prandaj unë e vlerësova emailin e mëhershëm dhe e mora
6 parasysh sa i takon pyetjeve që do të bëjmë.

7 Siç e bëri të qartë Trupi Gjykses në vendimin që ishte
8 objekti i emailit duke pasur parasysh natyrën e opinionëve,
9 fakteve, problematikave që ngrihen në gjykata ndërkombëtare
10 është një spektër ky sepse kjo varet nga natyra e dëshmitarit,
11 nga natyra e problematikës dhe nga pyetjet që ngrihen. Dhe unë
12 mendoj që ne sigurisht jemi brenda një spektri të lejuar sa i
13 takon këtij dëshmitari. Sa i takon mendimeve të gjykatave
14 ndërkombëtare sigurisht që edhe dëshmitë e opinionit të
15 mbështetura në fakte janë të rëndësishme kur të ndihmojnë të
16 zbulosh gjëra të caktuara.

17 Unë dua të shtoj vetëm këtë, është bërë një sugjerim që
18 Prokuroria në këtë periudhë nuk iu përgjigj parashtrimeve që i
19 janë bërë. E lexova emailin gjatë pushimit dhe mua mu duk
20 sikur thuhej që vendimi i Trupit Gjykses 17, 18 korrikut duhet
21 të kihet parasysh dhe të respektojë dhe asgjë më shumë, por
22 sot këto ishin ngritur çështje që nuk ishin parashtruar me
23 email. Këto janë gjëra të reja dhe Prokuroria sigurisht që nuk
24 ka ndërmend të marrë parasysh opinione personale të
25 dëshmitarit.

1 Nuk po flas për vendimet që janë marrë për parashtrimet e
2 mëhershme apo për raportet në tërësinë e tyre. Kanë qenë
3 çështje të tjera gjyqësore. As nuk kam pasur mundësi ta shoh
4 kontekstin e tyre. Sot u ngritën për herë të parë. Po kjo, unë
5 mendova që është një çështje që është trajtuar dhe që mund të
6 trajtohet duke e parë zhvillimin gjyqësor. Gjykatat herë pas
7 here kam parë që në rrethana të tilla ndodhin situata kur
8 dëshmitë mbështetura në opinion, në fakt, ndonjëherë janë në
9 themel kanë edhe faktet.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Laws, do
11 shtoni gjë?

12 Z. LAWS: [Përkthim] Jo.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duhet vënë re
14 se Gjykata, z. Emmerson, sigurisht duhet t'i them z. Emmerson,
15 që sipas z. Emmerson, ne duhet të ndalonim disa lloje të
16 caktuara dëshmish. Dhe në fakt, ne do të përpiqmi të bëjmë
17 diçka që do të shikojmë sesi do të jetë zhvillimi gjyqësor.
18 Gjykata nuk thotë në asnjë mënyrë, pra, që ky dëshmitar
19 përjashtohet.

20 Fillimisht vërejmë se dëshmitë të mbështetura në opinione
21 janë zbuluar në mënyrë të vazhdueshme nga çdo palë në këtë
22 formë, përfshirë madje edhe Mbrojtjen. Në këtë drejtim, Trupi
23 Gjyqësor thekson se dëshmitë të mbështetura në opinione nuk
24 duhet të merren nga dëshmitarët e faktit përveçse kur janë
25 bazuar, ku përveçse kur janë përcaktuar themelet apo baza për

1 një opinion të tillë.

2 Sigurisht, kjo është barra e z. Tieger, të cilën e di që
3 ai është dijeni.

4 Trupi Gjykues po ashtu rikujton se opinionin e një
5 dëshmitari sigurisht që nuk duhet të futet në themel të
6 çështjes, të thelbit. Dikush madje e përdori pikërisht kështu
7 në "Në zemër të çështjes". Nuk është kjo gjuha e përshtatshme.
8 Këto janë çështje që nuk mund të trajtohen sigurisht me
9 opinione.

10 Prandaj Trupi Gjykues i kujton ZPS-së, që në qoftë se ka
11 ndërmend të mbështete në opinione të tilla në këtë dëshmitar
12 duhet të vërtetojë bazën, të gjejë bazën ku e ka formuar ky
13 dëshmitar opinionin. Palët dhe pjesëmarrësit do të jenë në
14 gjendje ta kundërshtojnë një pistë të caktuar pyetjesh për
15 diçka që ata mendojnë se nuk është provuese në rastin tonë
16 konkret.

17 Ju faleminderit për parashtrimet tuaj.

18 Gjithashtu është çështja nëse dëshmitari mund të lidhet
19 me videolidhje.

20 Doni ta diskutoni këtë gjë apo i keni dhënë mendimet tuaj
21 në lidhje me intervistën me videolidhje. Keni nxjerrë të
22 gjithë opinionet tuaj në lidhje me këtë.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] S'e kuptova. Doni tani parashtrim
24 me gojë?

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, jo. Jua

1 caktova datën. Ua caktova datën. Më falni, gabimi im.

2 Trupi Gjykses po ashtu është informuar se dëshmitari i
3 radhës dëshiron të sjellë raportet e tij nën urdhra si
4 materiale referencash dhe dëshmitari do të udhëzohet nga Trupi
5 Gjykses.

6 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
7 këshillohen]

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tërhiqet
9 kërkesa. Tërhiqet kërkesa atëherë.

10 Jemi të gjithë gati për dëshmitarin?

11 Asistente mund të sillni dëshmitarin.

12 Gjërat ndryshojnë nga një minutë në tjetrën.

13 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ndërkohë që presim dëshmitarin, a
14 mund t'i kërkoj Trupit Gjykses të kërkojë konfirmim që
15 vërtetimi i bazës, pra, baza, pra, bazë a mund të gjejmë, pra,
16 fillimisht përpara se të jepet deklarata a mund të marrim
17 bazën e një informacioni se ndodh ndonjëherë që Prokuroria
18 fillimisht bën pyetjen pastaj bazën.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po,
20 fillimisht baza pastaj opinionin.

21 Z. TIEGER: [Përkthim] Do përpigem të veproj në këtë
22 mënyrë por ndonjëherë do përpigem që të marrë më shumë
23 informacion për bazën për diçka që është e pranueshme thjesht
24 për të sqaruar elementë të caktuar. Mund të ndodhi ndonjëherë
25 që do veprojë në këtë mënyrë.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull. E
2 kuptueshme është kjo, por si rregull përpiquni të zbatoni
3 parimin që sapo thashë, fillimisht të marrim bazën pastaj të
4 marrim opinionin e dëshmitarit.

5 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëdita,
7 Dëshmitar.

8 Përpara se të fillojmë me dëshminë tuaj, duhet të lexoni
9 deklaratën tonë solemne të cilën duhet ta merrni në përputhje
10 me rregullën 141(2). Lexojeni me zë të lartë.

11 DËSHMITARI: [Përkthim] I ndërgjegjshëm për rëndësinë e
12 dëshmisë sime dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj
13 solemnisht se do them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm
14 të vërtetën dhe nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të cilën
15 kam dijeni.

16 DËSHMITARI: W04408

17 [Dëshmitari përgjigjet përmes përkthimit]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A e kuptoni
19 këtë detyrim?

20 DËSHMITARI: Po, e kuptoj.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E pranoni?

22 DËSHMITARI: Po.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund t'ia
24 jepni sërish Asistentes dhe mund të uleni tani.

25 Dëshmitar, sot fillojmë dëshminë tuaj që mendohet se do

1 zgjasë rreth katër ditë. Sikurse mund ta dini, fillimisht
2 pyetjet do ua bëj Prokuroria, pastaj Mbrojtësi i Viktimave.
3 Pasi të mbaroj kjo pjesë atëherë ka të drejtën Mbrojtja t'ju
4 bëj pyetje dhe më pas Trupi Gjykues mund të ketë disa pyetje
5 shtesë.

6 Prokuroria parashikon dy orë për t'ju marrë në pyetje.
7 Mbrojtja parashikon 16 orë për t'ju marrë në pyetje. Shpresoj
8 që të gjitha palët të jenë të kujdesshëm dhe efikas në
9 përdorimin e kohës. Trupi Gjykues mund të lejojë pyetje shtesë
10 nëse plotësohen kushtet përkatëse.

11 Dëshmitar, ju lutem përgjigjuni pyetjeve qartë me fjali
12 të shkurtra. Në qoftë se nuk e kuptoni pyetjen lirisht kërkoni
13 që pala apo pjesëmarrësit ta përsërisë pyetjen ose thjesht
14 thoni që nuk e kuptoni dhe ata do ta sqarojnë pyetjen për ju.

15 Gjithashtu na thoni ku e bazoni dijeninë tuaj lidhur me
16 faktet dhe me rrethanat për të cilat do t'ju bëjnë pyetje.

17 Në qoftë se Prokuroria thotë të pohoni disa nga
18 korrigjimet që keni bërë në deklaratat tuaja, ju kujtojmë që
19 duhet të konfirmoni për procesverbal që korrigjimet me shkrim,
20 përfshirë deklaratat tuaja, përfshirë korrigjimet që keni
21 bërë, janë deklarata juaj e saktë.

22 Flisni në mikrofon, prisni pesë sekonda para se t'i
23 përgjigjeni pyetjes sepse kemi dhe përkthim që vazhdon
24 njëkohësisht, t'ju japim mundësinë dhe përkthyesve t'ju
25 ndjekin.

1 Gjatë ditëve që do jepni dëshmi në sallën e gjyqit, nuk
2 duhet të diskutoni me askënd përmbajtjen e dëshmisë suaj
3 jashtë Gjykatës. Nëse ju bën dikush pyetje jashtë sallës së
4 gjyqit lidhur me dëshminë tuaj, na bëni menjëherë me dijeni.

5 Trupi Gjykues e kupton që keni sjellë një kopje fizike.
6 Më falni. Është tërhequr kërkesa, u tërhoq kërkesa.

7 Dhe diçka tjetër, në qoftë se të kërkoj të mos flasësh,
8 të lutem ndalo ose në qoftë se ngre dorën sepse kjo do të
9 thotë që unë duhet të jap udhëzime të mëtejshme. E kuptuat?

10 E gjithashtu në qoftë se keni nevojë për pushime, na
11 njoftoni dhe do të përpiqemi t'ua plotësojmë kërkesën.

12 Fillojmë me pyetjet nga Prokuroria. Z. Tieger, në të
13 majtën tuaj do të filloj me pyetjet.

14 Vazhdoni, z. Tieger.

15 Z. TIEGER: [Përkthim] Faleminderit.

16 Pyetje nga Z. Tieger:

17 PY. Mirëdita. Mund të fillojmë fillimisht me emrin dhe me
18 mbiemrin tuaj?

19 PË. Frederick C. Abrahams.

20 PY. Datëlindja?

21 PË. 2 nëntor 1967.

22 PY. Kombësia?

23 PË. Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

24 PY. Çfarë profesioni keni?

25 PË. Jam drejtor programi i Human Right Watch.

1 PY. Në cilësitë që sapo përshkruat, çfarë funksionesh kryeni?

2 PË. Mbikëqyr një sërë ekipesh pranë organizatës që janë
3 divizionet apo grupet e krizës dhe të konfliktit që kanë qenë
4 dikur në kohën e konfliktit quhej si divizioni i emergjencës.
5 Po ashtu mbuloj divizionin e teknologjisë dhe të drejtave të
6 njeriut, të armëve dhe laboratorët të hetimeve digjitale që
7 janë teknikat që përdoren për të bërë hetimet situatave për të
8 drejtat e njeriut.

9 Po ashtu jam përgjegjës për të mbikëqyrur trajnimin e
10 stafit që merret me hulumtimet dhe po ashtu merrem me
11 metodikat.

12 PY. Sa kohë keni që punoni për Human Right Watch?

13 PË. Qysh prej 1993.

14 PY. A mund t'i tregoni Trupit Gjykues pak a shumë çfarë bën
15 Human Right Watch, çfarë misioni ka dhe çfarë funksionesh ka?

16 PË. Sigurisht. Mandati ynë është të monitorojmë,
17 dokumentojmë, të ekspozojmë, të publikojmë rastet e shkeljeve
18 të të drejtave të njeriut në gjithë botën, pavarësisht
19 politikës apo fesë, etnisë. Ne punojmë në shumë shtete në
20 gjithë botën edhe përpigëmi të promovojmë politika që
21 minimizojnë rastet e abuzimit të të drejtave të njeriut.

22 Dhe gjithashtu punojmë në zona ku ka konflikte të
23 armatosura. Në këto raste, ligjet në fuqi, pra, e drejta
24 ndërkombëtare humanitare, që ka qenë edhe fusha ime kryesore.
25 Po ashtu punojmë në zona ku ka konflikte në gjithë botën, në

1 shumë kontinente, në mënyrë që t'i minimizojmë konfliktet edhe
2 palët e përfshira në këto konflikte të japin llogari për
3 përfshirjen e tyre.

4 Pra, ne përpiqemi të gjitha palët e përfshira në një
5 konflikt të jenë të japin llogari për veprimet e tyre.

6 PY. Përmendët vitin 1993. Gjatë viteve 1990, pra, nga viti
7 1993 deri afërsisht në 2001, a keni mbuluar ndonjë krahinë
8 gjeografike të caktuar?

9 PË. Përgjegjësitë e mia kanë ndryshuar me kalimin e kohës. Në
10 fillim fare kam filluar punën me Evropën lindore dhe menjëherë
11 u përfshiva me Ballkanin. Kam punuar në Shqipëri në vitin 1993
12 dhe e kam filluar punën time me Human Right Watch në atë kohë
13 edhe sot e kësaj dite jam i përfshirë me punët me Shqipërinë.
14 Dhe kjo më ka çuar që të bëj raportimin e Human Right Watch në
15 Kosovë dhe në Maqedoni, gjithashtu edhe në Serbi.

16 Pra, thelbi i punës time që prej vitit 1995 në fakt që
17 prej 1993, pra nga 1993 e deri në 2000 ka qenë Ballkani jugor
18 PY. Gjatë kësaj periudhe kohe, a keni qenë i përfshirë në
19 prodhimin dhe në botimin e raporteve që trajtonin shkelje të
20 pretenduara të të drejtave të njeriut, a keni shkruar vetë ju
21 raporte, keni qenë autori i këtyre raporteve, bashkautor,
22 redaktor, kërkues çfarë mund të na thoni në lidhje me këtë
23 pyetje?

24 PË. Po. Unë jam përfshirë në shkrimin e shumë raporteve gjatë
25 kësaj periudhe kohe, kam parë aspekte të ndryshme të

1 situatave. Sigurisht që kam punuar në Shqipëri, sikurse e
2 thashë dhe kam botuar raporte që kanë qenë goxha kritikë sa i
3 takon aspekteve të të drejtave të njeriut në momente kur ka
4 pasur qeveri të ndryshme në pushtet. Kam bërë të njëjtën gjë
5 dhe për Maqedoninë si përpara edhe konfliktit të shkurtër që
6 ka ekzistuar në atë vend. Si dhe kam bërë një punë të
7 konsiderueshme në Kosovë, kam shkruar ose vetë unë apo kam
8 hetuar, shkruar ose botuar, në fakt, botimin e ka bërë
9 organizata për të cilën punoja, pra, kam kontribuar në mënyra
10 të ndryshme për shumë raporte në veçanti lidhur me shkeljen,
11 me shkeljet e kryera nga forcat jugosllave dhe nga shteti serb
12 dhe jugosllav.

13 PY. Për t'i ndihmuar Trupi Gjykses për të ditur diçka më
14 tepër lidhur me numrin e raporteve për të cilat keni
15 kontribuar, a do ishte e drejtë të thuhet se bëhet fjalë
16 mesatarisht për tetë raporte që kishin të bënin me Kosovën
17 gjatë asaj kohe, domethënë, që kishte të bënte me
18 "Persekutimin me shkeljen e të drejtave të njeriut në 1996 në
19 Kosovë", duke përfshirë këtu edhe raportin "Nën Urdhra" të
20 2001 dhe pastaj raporte të tjera në periudhën 1999 dhe në
21 vijim?

22 PË. Po. Duhet ta kontrolloj në qoftë se numri është i saktë,
23 por pak a shumë këto kanë qenë raportet. Raporti i parë është
24 nga misioni i parë që kam bërë në 1996 në Kosovë dhe ka ardhur
25 si rezultat i këtij misioni timin. Ndërkohë që vitin 2001 ka

1 qenë kulmi i punës time, që është pasuar me botimin e raportit
2 "Nën Urdhra" që është tema kryesore për të cilën jam thërritur
3 për të dhënë dëshmi këtu përpara Trupit Gjykues sot.

4 PY. A keni dhënë dëshmi në TPNJ në disa çështje gjyqësore,
5 për shembull, në çështjen kundër Milutinovic, Milosevic dhe
6 Djordjevic për sa i takon krimeve të kryera në Kosovë?

7 PË. Po. Kam qenë dëshmitar i Prokurorisë në çështjen kundër
8 Milosevic, Milutinovic dhe të tjerët, kam përshtypjen se
9 kështu ishte emërtimi i çështjes gjyqësore dhe në çështjen
10 kundër Djordjevic. Kam dhënë dëshmi gjithashtu edhe në një
11 çështje të brendshme në Suedi që kishte të bënte me krimet e
12 luftës dhe që përfshinte një anëtar të forcave të posaçme,
13 forcave speciale të Serbisë. Nuk më kujtohet tani sesi e
14 kishte emrin ekzaktësisht njësia, por bëhej fjalë për një
15 person i cili akuzohej se kishte kryer krime lufte në dhe
16 rreth fshatit, një fshati në Serbi në maj 1999.

17 PY. Këto janë dy periudha të ndryshme për të cilët ju keni
18 dhënë dëshminë tuaj në TPNJ si analist kërkimor, apo jo?

19 PË. Po.

20 PY. Pra, keni shkruar artikuj, keni shërbyer gjithashtu edhe
21 si reaktor i artikujve të shkruar nga të tjerët, keni dhënë
22 gjithashtu edhe dëshmi përpara Kongresit Amerikan sa i takon
23 gjendjes së përgjithshme të Ballkanit jugor lidhur me të
24 drejtave të njeriut?

25 PË. Po. Ka qenë pjesë e përgjegjësive të mia, domethënë, ka

1 qenë pjesë e përgjegjësive të mia si punonjës i Human Right
2 Watch që të jap opinione, të shkruaj raporte, por të jap
3 gjithashtu edhe mendimet e mia përpara Kongresit Amerikan ndër
4 të tjera.

5 PY. Puna Human Right Watch dhe puna juaj personale në veçanti
6 në lidhje me Kosovë a është rritur në vitin 1998?

7 PË. Po. Pa diskutim që po, sepse në shkurt, në fund të
8 shkurtit në fillim të marsit të 1999, ka pasur raste
9 domethënëse që përfshinin shkelje të rënda të ligjeve të
10 luftës në zonën e Drenicës, në rajonin e Drenicës. Më
11 konkretisht, në tri fshatra, për të qenë më i saktë. Dhe që
12 prej këtij momenti, ne ishim të vendosur si organizatë së
13 bashku me juristët tanë, që ishin pjesë e organizatës. Pra,
14 ishim të vendosur prej atij momenti që për ne ishte një sinjal
15 i qartë që ishte fillimi i një konflikti të armatosur të
16 brendshëm sipas të drejtës ndërkombëtare. Dhe prej që atij
17 momenti ne e përshpejtuam dhe i mblodhëm forcat në mënyrë të
18 tillë që të mund të bënim një dokumentim të qartë të shkeljeve
19 të kryera në Kosovë gjatë asaj periudhe kohe.

20 PY. [Mikrofoni çaktivizuar].

21 PË. Ndizni mikrofonin, ju lutem

22 PY. Faleminderit. Human Right Watch a vazhdoi që të ishte e
23 pranishme edhe pas kësaj periudhe në Kosovë?

24 PË. Po. Nuk ka qenë prani e qëndrueshme. Unë kam bërë
25 udhëtime pune të vazhdueshme disa prej tyre. Për shembull,

1 kujtoj që udhëtimi i parë është bërë diku rreth nga maji,
2 qershori i vitit 1999. Dhe me siguri që kam kryer edhe tre apo
3 katër udhëtime të tjera deri në momentin kur erdhën
4 bombardimet e NATO-s në mars të 1998, domethënë, deri më pas
5 në 1999. Megjithatë, më lejoni të them, që nuk kemi qenë në
6 mënyrë të vazhdueshme në mënyrë permanente aty. Kemi shkuar
7 për një udhëtim pune, kemi qëndruar dy-tre javë dhe pastaj
8 jemi kthyer, keni qëndruar ca kohë dhe pastaj kemi shkuar
9 përsëri. Kështu ka qenë pak a shumë.

10 PY. Për t'u siguruar që e kemi të qartë procesverbalin, më
11 duhet të sqaroj diçka. Kur thua që "Udhëtimi i parë ka qenë
12 rreth nga maji, qershori 1999" e kishe fjalën për 1998, apo
13 jo?

14 PË. Po. E saktë, e kisha fjalën për 1998.

15 PY. Gjatë këtyre vizitave, ndër të tjera a keni takuar dhe a
16 keni intervistuar viktimat dhe dëshmitar të shkeljeve të
17 pretenduara?

18 PË. Po. Gjerësisht. Masivisht. Metoda kryesore e Human Right
19 Watch është që të takohemi me persona që pasqyrojnë faktet në
20 terren sa më qartë të jetë e mundur dhe në qoftë se është e
21 mundur të bisedojmë me ata të civilët i kanë parë me sytë e
22 veta ose që kanë njohuri të dorës së parë. Që mund të ishin në
23 rastin në fjalë dëshmitarë të shkeljeve, që kanë qenë persona
24 që kanë qenë të pranishëm kur janë kryer shkeljet apo personat
25 të cilët janë të lidhur me situatën që mund të jenë, për

1 shembull, anëtarë të familjes, kolegë, punëdhënës, mjekë,
2 juristë e të tjerë. Do përfshija këtu edhe - kur është e
3 mundur - ne jemi përpjekur që të mund të bisedonim edhe me
4 autorin ose kryesin e pretenduar në mënyrë të tillë që të mund
5 të kishim të gjithë historinë, pra, të dëgjonim dhe palën
6 tjetër.

7 Këto intervista në vetvete përbëjnë shtyllat kryesore të
8 punës tonë, megjithatë, ne nuk e marrim një intervistë si
9 burim të besueshëm. Gjithmonë përpigemi që të marrim disa
10 intervista përpigemi që të verifikojmë informacione që ta
11 mbështesim atë nga dëshmia e tjetrit të bëjmë dhe përdorimin e
12 informacionit ose materialit mbështetës që mund të jenë, për
13 shembull, raporte autopsie, mund të jenë dokumente ligjore,
14 mund të jenë vendime gjykate apo mund të jenë materiale të
15 tjera të cilat ne i verifikojmë dhe të cilat mund të na
16 ndihmojnë ne që të ndërtojmë një çështje që është e
17 dokumentuar dhe që ja vlen të reflektohet si shkelje e të
18 drejtave të njeriut.

19 PY. Më herët kur po përshkruanit mandatin e Human Right Watch
20 ju përmendët që keni bërë përpjekje për të identifikuar, për
21 të ekspozuar, për të dokumentuar dhe për të botuar dokumente
22 që kishin të bënin atëherë me shkeljet e të drejtave të
23 njeriut. A ishte kjo pjesë e këtij aspekti të mandatit tuaj?
24 PË. Po. Edhe raportimi publik dhe mbështetja, avokacia apo
25 bërja e ditur e raporteve tona ishte pjesë e punës tonë, sepse

1 qëllimi kryesor ishte që të lehtësoheshin abuzimet dhe të
2 mbroheshin civilët, do thoja që mbështetja, mbrojtja e
3 civilëve ishte aspekt kryesor i punës tonë, pra, që të
4 mbroheshin civilët nga tragjeditë e luftës dhe shkeljet e
5 ligjeve të luftës në veçanti duke inkurajuar dhe duke i bërë
6 thirrje palëve që të respektonin detyrimet e ligjeve të
7 luftës.

8 PY. Kur nxirreshin raportet, çfarë bëhej me ta më pas, çfarë
9 ndodhte me këto raporte më pas? Me fjalë të tjera, si e
10 përdornit aspektin mbas prodhimit ose mbas nxjerrjes së
11 raporteve për përmbushjen e aspekteve të punës tuaj?

12 PË. Kishte faza të ndryshme për pas prodhimit ose pas
13 nxjerrjes për të përdorur termin që përdorët juve. Së pari
14 ishte botimi. Domethënë, çështja ishte që ne mundoheshim që ta
15 shpërndanim raportin sa më gjerë të jetë e mundur ta botonim
16 on-line, tua jepnim medias ose t'ua dërgonim zyrtarëve që
17 ishin në fuqi, t'ia dërgonim organizatave ndërkombëtare,
18 qeverive të ndryshme dhe të përpiqeshim që të informonim sa më
19 gjerësisht që të ishte e mundur.

20 Përveç kësaj, vinim kontakte dhe me median. Për shembull,
21 unë personalisht ose kolegë të mi flisnim me median në qoftë
22 se e ndjenim që kjo ishte e dobishme ose si vlente për të
23 informuar më tej publikun dhe politikbërësit. Përveç kësaj,
24 kur ishte e mundur, raportet tona i shpërndanim dhe në mënyrë
25 të drejtpërdrejtë për shenjëstruesit ose objektet, le të

1 themi, të hetimeve tona ose të atyre personave që ne mendonim
2 që ishin përgjegjës për aktet e dhunshme që ose e kishin vetë
3 këto akte ose që kishin kryer vetë këto akte ose që kishin
4 detyrimin që të hetonin për këto krime të kryera.

5 Këtë e kemi bërë në shumë raste në anën serbe dhe
6 jugosllave. Në fakt, një prej subjekteve të dëshmisë time në
7 çështjen kundër Milosevic dhe në çështjen Milutinovic dhe të
8 tjerët ishte që unë kam dëshmuar që ju kemi dërguar raporte
9 dhe autoriteteve serbe dhe jugosllave duke i informuar ata për
10 konstatimet për gjetjet që kishim bërë ne si organizatë
11 PY. Në këtë aspekt, pra, dërgimi i gjetjeve i konstatimeve
12 për zyrtarët qeveritarë a mund t'ju them që në përgjithësi kjo
13 ishte praktika dhe sa i takon një grupi të armatosur në një
14 konflikt që nuk është se kishin një përfaqësi ose nuk është se
15 kishin një qeveri formale zyrtare, a ishte kjo rruga që
16 ndiqnit edhe në një rast të tillë?

17 PË. Po. Me aq sa mundeshim ne përpiqeshim deri në maksimum që
18 të informonim palët pjesë e konfliktit, pra, ne mundoheshim që
19 të informonim të gjithë palët në konflikt. Në rastin e
20 Kosovës, në qoftë se më lejoni që ta vazhdoj më tej, pra, në
21 rastin e Kosovës nuk është se ishte gjithmonë e thjeshtë me
22 Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës sepse ata nuk është se kanë
23 pasë praninë e tyre haptas, nuk e dinin të gjithë praninë e
24 tyre deri vonë gjatë konfliktit. Ndonjëherë, nuk i kishim
25 marrëdhëniet në mënyrë të tillë që të mund t'i informonim ata

1 në mënyrë të drejtpërdrejtë deri vonë gjatë luftës, me ca
2 përjashtime të vogla.

3 Megjithatë, besoj, se raportet tona mbuloheshin nga
4 media, po ashtu transmetoheshin apo mbuloheshin nga media
5 shqiptare dhe konstatimet tona ishin të botuara goxha
6 gjerësisht në kontekstin e Kosovës.

7 PY. Më lejoni t'ju bëj disa pyetje lidhur me këtë. Së pari,
8 na thatë që raportet kishin jehonë në median shqiptare. Human
9 Right Watch çfarë bënte ia dërgonte raportet konkretisht
10 burimeve mediatike shqiptare?

11 PË. Po, po, ashtu bënim. Ne kishim një listë të gjatë të
12 medias shqiptare, të cilave ua dërgonim raportet tona.

13 PY. Në muajt e parë të vitit 1998 dhe në pranverës së 1998,
14 besoj, që e nënkuptuat këtë, megjithatë më lejoni t'ju bëj
15 pyetjet drejtpërdrejt, a kishte UÇK-ja një zyrë të njohur
16 përfaqësuese ku ju mund të dërgonit këto raportet tuaja?

17 PË. Mendoj që në fillim të 1998 jo. Është hapur një zyrë diku
18 më vonë gjatë vitit 1998. Nuk është se më kujtohet tamam koha.
19 Nuk më kujtohet se çfarë muaji ka qenë. Megjithatë në shtator
20 kur unë shkova në Kosovë ajo zyrë ishte funksionale.

21 PY. Ku ishte kjo zyra?

22 PË. Në Prishtinë. Nuk më kujtohet adresa apo lagja por e di
23 që ishte në Prishtinë.

24 PY. A i ishte një person që ishte përgjegjës për të?

25 PË. Po. Përfaqësuesi ishte Adem Demaçi ishte një aktivist i

1 të drejtave të njeriut që e njihja prej shumë kohësh,
2 domethënë, ishte përfaqësuesi politik i UÇK-së në Prishtinë në
3 atë kohë.

4 PY. A i keni dhënë kopje të raporteve apo të materiale të
5 Human Right Watch zyrës së Demaçit?

6 PË. Po, me sa më kujtohet mua po.

7 PY. Tani le të kalojmë tek lloji i informacionit që ju
8 përdornit për të shkruar raportet tuaja. Besoj se na e
9 shpjeguat deri në një farë hollësie të caktuar deri tani
10 përpjekjet për të marrë informacion që vinte nga dora e parë,
11 pra, përmes intervistave, punës tuaj në terren, është e saktë
12 kjo?

13 PË. Po, e saktë është.

14 PY. Po ashtu nënkuptuat edhe hapa të tjerë të cilët merrnit
15 në lidhje me këtë veprimtari tuajën. Ju lutem a mund të na e
16 shpjegoni shkurtimisht të gjitha këto hapa?

17 PË. E keni fjalën për materialet mbështetëse të pistave tona?

18 PY. Po.

19 PË. Varej nga konteksti. Por zakonisht ajo çfarë bënim ishte
20 që kërkonim dokumente që të na ndihmonin ne për ta kuptuar më
21 mirë situatën për të cilën bëhej fjalë. Dhe këto, për
22 shembull, mund të ishin dokumente gjykate, mund të ishin
23 raporte të mjekëve, mund të ishin raporte autopsie në qoftë se
24 personi kishte vdekur. Dhe ky informacion ishte i vlefshëm,
25 ishte i dobishëm për të gjithë punën tonë dhe merrej parasysh

1 si pjesë e procesit të hetimit.

2 PY. Sa i takon përpjekjes për të marrë informacion të dorës
3 së parë, a keni pasur mundësi që ta merrni këtë informacion në
4 Kosovë duke marrë parasysh, pra, të gjitha shkeljet e të
5 drejtave të njeriut nga të gjitha palët?

6 PË. Ka qenë një situatë e ngatërruar, ka qenë një situatë e
7 përzier. Sepse ka pasur kohë kur ne kemi pasur mundësi që të
8 marrim dokumentet e institucioneve, për shembull, nga një
9 gjykatë që lidhej me një person, me një shqiptar që ishte
10 ndaluar në mënyrë arbitrare në paraburgim dhe që ishte akuzuar
11 për krime me motivin me politike dhe krime të kësaj natyre
12 kishte shumë. Kështu që ndonjëherë ishte e mundur që mund të
13 siguroheshin dokumentet e gjykatës. Ndonjëherë mund të gjenim
14 dhe raportet e autopsisë, po jo kaq shpesh. Dhe kishim
15 vështirësi të shumta sa i takon marrjes së informacionit
16 zyrtar nga zyrtarë ose nga burime zyrtare serbe dhe
17 jugosllave. Zakonisht retorikën ata e kishin të madhe por
18 provat apo dokumentet i kishin të pakta.

19 Përndryshe, më duhet që të mendoj pak më tepër në qoftë
20 se keni nevojë për shembuj të tjerë.

21 PY. Dua t'ju pyes konkretisht për intervistat, e kam fjalën
22 për intervistat me personat që mund të ishin burim ose mund të
23 kishin informacion për shkeljet e pretenduara dhe në këtë
24 rast, domethënë, dhunime që mund të kryheshin nga UÇK-ja?

25 PË. Në këtë rast më duhet të them që intervistat ishin burimi

1 kryesor ose më i rëndësishëm i yni, si në rastet e hetimeve të
2 tjera dhe në këtë rast, ne përpiqeshim që të merrnim mendimet
3 dhe të merrnim dëshmitë e personave dhe zakonisht kryenim
4 intervista të gjata dhe bënim pyetjet të shumta, i merrnim në
5 pyetje qoftë edhe me një individ të vetëm.

6 Kështu që në këtë rast, intervistat zakonisht ishin burim
7 shumë i rëndësishëm -- ju kërkoj ndjesë se po ju ndërpres më
8 duket. Megjithatë më lejoni të theksoj se në rastin e hetimit
9 të shkeljeve të bëra nga UÇK-ja intervistat ishin të vështira
10 sepse ekzistonte një lloj hezitimi i përgjithshëm dhe do
11 shtoja që edhe frikë për të folur haptazi për këtë çështje.
12 PY. Ju vetë gjatë punës tuaj, gjatë ushtrimit të detyrave
13 tuaja a jeni takuar, a jeni ndeshur me persona që kanë
14 shprehur frikë për të folur për shkelje të pretenduara të bëra
15 nga UÇK-ja?

16 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë që ju ndërpres,
17 por do ishte me dobi për të gjithë nga ne besoj që së pari do
18 ishte e rëndësishme që të pyetet dëshmitari në qoftë se ka
19 kryer hetime lidhur me krimet të cilat pretendoi që të jenë
20 kryer nga UÇK-ja.

21 Z. TIEGER: [Përkthim] Mendova se e tejkaluam këtë pyetje.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
23 duhet që ta thotë në vetë të parë dhe jo "ne".

24 Z. TIEGER: [Përkthim] Kështu që do ju kërkoja që t'i
25 jepnit përgjigje ti vetë si individ a ke bërë përpjekje, je

1 orvatur që të mund të merrni informacion nga burimi i parë,
2 domethënë, nga dora e parë për individë të cilët kishin pësuar
3 shkelje nga UÇK-ja?

4 PË. Po. Megjithëse më duhet të them që disa prej raporteve
5 lidhur me këtë temë, kryesisht, janë shkruar nga kolegët e mi
6 dhe në ato raste unë e njihja mirë metodologjinë e përdorur
7 prej tyre dhe kam qenë në konsultim të vazhdueshëm me ta
8 ndërkohë që ata e kanë shkruar raportet. Por, në përgjigje të
9 pyetjes tuaj, po, ka pasur raste kur unë kam bërë vetë
10 intervista me viktime ose me dëshmitarë.

11 PY. Pyetja pasuese pastaj është që ju vetë personalisht a
12 jeni përballur, a jeni hasur me njerëz që kanë shprehur frikë
13 lidhur me dhënien e përgjigjeve të pyetjeve që përfshinin
14 shkeljet e pretenduara të UÇK-së?

15 PË. Po.

16 PY. Ju përmendët kolegë që kanë qenë të përfshirë në të
17 njëjtën punë në të njëjtat detyra, po kolegët tuaj a ju kanë
18 thënë gjatë punës tuaj që janë ndeshur, janë hasur me persona
19 të cilët kanë shprehur frikë për t'u përgjigjur për pyetjet që
20 kishin të bënin për shkelje të pretenduara të UÇK-së?

21 PË. Po. Më duhet të them që kjo është një temë e diskutuar
22 shpesh sepse prej perspektivës metodologjike, ne mundoheshim
23 që të mblidhnim informacionin më të mirë të mundshëm,
24 domethënë, kur bëhej fjalë për një klimë të përgjithshëm frike
25 dhe për kur kishte një mungese dëshire e njerëzve për të folur

1 "keq" për anën e tyre, për njerëzit e tyre.

2 Kjo është një situatë e cila nuk është unike, nuk është
3 vetëm e vërtetë për Kosovën por është një vështirësi e
4 përgjithshme në të gjithat zonat ku ka konflikte të armatosura
5 në të gjithë botën.

6 PY. Përveç informacionit që keni marrë si nga përvoja juaj
7 vetjake dhe nga përvoja e kolegëve të tu lidhur me personat që
8 shprehin frikë dhe që ndiheshin të frikësuar për të diskutuar
9 për shkelje të UÇK-së -- ta formuloj ndryshe. Ju kërkoj
10 ndjesë, sepse më duhet që të përcaktoj bazën e kësaj pyetjeje.

11 Së pari, do bëj një hap pas dhe do t'ju bëj këtë pyetje.
12 Sa i takon frikës së shprehur prej njerëzve, ishte frikë për
13 çfarë? Nga se kishin frikë njerëzit, thonin, për shembull, që
14 kishin frikë të flisnin me ju lidhur me atë çfarë kishte
15 ndodhur, goftë me ju apo me ndërkombëtarë të tjerë sa i takon
16 shkeljeve të pretenduara të UÇK-së?

17 PË. Unë e kuptoja dhe besoja frikën si frikë që njerëzit mund
18 të kishin frikë prej pasojave që mund të kishte ky qëndrim i
19 personave.

20 Z. KEHOE: [Përkthim] Kundërshtoj, Gjykatës. Ky është një
21 përfundim që e nxjerr vetë nga përvoja vetjake, nga mendja e
22 vetë dëshmitari.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni me
24 pyetjet.

25 Z. TIEGER: [Përkthim] Një sekondë sepse mu fik monitori.

1 Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

2 PY. Ju thoni që besoj dhe e kuptova që frika donte të thoshte
3 që njerëzit kishin frikë se mund të kishin pasoja. Si
4 mbërritët ju në këtë lloj përfundimi? Nga biseda me individë
5 të caktuar? Nga bisedat me kolegët? Na e thuaj pak të lutem si
6 ju krijua kjo përshtypje.

7 PË. Kjo është pikëpamja ime, kjo është përshtypja ime e
8 krijuar mbështetur në qindra intervista të bëra jo vetëm
9 lidhur me këtë temë por edhe me tema të tjera dhe duke qenë
10 edhe se flisja shqipen si gjuhë deri në një fare mase jo
11 shkëlqyeshëm. Megjithatë pas ca përvoje pune në Kosovë dhe nga
12 pozicionimi im, nuk ka absolutisht asnjë lloj pikëpyetje në
13 mendjen time që ndonjëherë njerëzit kishin frikë për të folur
14 për krimet e kryera nga UÇK-ja. Dhe njerëzit ishin të
15 shqetësuar për pasojat që mund të kishte të folurit ose le të
16 themi ekspozimi i krimeve.

17 Më duhet të them që kjo është një temë e komplikuar dhe
18 nuk mund ta përgjithësosh situatën për të gjithë njerëzit. Ka
19 shumë njerëz të cilët thjesht e ndjenin që nuk donin të
20 flisnin për këtë gjë sepse kauza ishte më e madhe. Dhe
21 shqiptarët kanë një fjalë të bukur për këtë është çështja e
22 shqiptarëve ose lëvizja e shqiptarëve, kauza e shqiptarëve.
23 Dhe e kishin të blujtur në mendjen e tyre që do të flasim për
24 krimet e jugosllavëve dhe të serbëve po jo për anën tjetër.

25 Këtë, në fakt, ne e kemi hasur shpesh kur shihnim

1 shkeljet serbe dhe jugosllave, pra, kur dokumentonim shkelje
2 serbe dhe jugosllave vinim re që disa dëshmitarë thonin që nuk
3 kishte prani të UÇK-së në atë zonë atëherë. UÇK-ja nuk ishte
4 asgjekundi. Forcat jugosllave dhe serbe kishin ardhur dhe
5 kishin kryer këto krime. Dhe ndonjëherë ne e dinim që nuk
6 ishte kështu në fakt sepse kishim informacion që UÇK-ja ishte
7 e pranishme në një kohë të caktuar që lidhej me një krim të
8 caktuar.

9 Dhe kjo nuk justifikon në asnjë mënyrë shkeljet apo
10 krimet e forcave serbe. Nuk po e them këtë as për një çast të
11 vetëm, por kjo ishte pjesë e realitetit. Mund të më ndërprisni
12 në qoftë se mendoni se e morët përgjigjen.

13 PY. E kuptoj. Faleminderit. Faleminderit për atë çfarë thatë,
14 për shpjegimin dhe dua që të përqendrohemi tani tek njerëzit të
15 cilët kishin frikë dhe njerëzit që e tregonin e thonin që
16 kishin frikë. Të përqendrohemi këtu tani. Ata kishin frikë nga
17 pasojat që mund të pësonin nga kush, nga pasojat nga kush?

18 PË. Besoj se ishin të shqetësuar, ishin të frikësuar që do të
19 kishin pasoja. Do të duhet që të vuanin pasoja nga pjesëtarë
20 të UÇK-së për faktin se do flisnin për keqsjelljen e tyre ose
21 atë çfarë ata e quanin ose e konceptonin si keqsjellje të
22 tyre.

23 PY. Përveç informacionit që përshkruat, në mënyrën që ju e
24 përshkruat dhe sa i takon rrezikut të njerëzve si e
25 perceptonin ata lidhur me dhënien e informacionit për UÇK-në,

1 a keni mësuar për lloje ose forma të tjera veprimtarish apo
2 pozicionesh të cilat mund të çonin në të njëjtin rrezik ose në
3 të njëjtin shqetësim?

4 PË. Nuk e kuptova pyetjen.

5 PY. Sapo thatë, në qoftë se e kuptova drejtë, që njerëzit
6 kishin frikë të raportonin shkeljet e pretenduara të UÇK-së se
7 kishin frikë se mos hakmerreshin të tjerët ndaj tyre?. A
8 kishte gjëra të tjera të cilat çonin në frikëra për të njëjtin
9 rrezik?

10 Z. EMMERSON: [Përkthim] Kjo kërkon opinione, është
11 hamendeshim i qartë dhe është një pyetje që edhe dëshmitari
12 vetë po e ka të vështirë që ta kuptojë

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Së pari, të
14 presim që të përgjigjet dëshmitari: Në qoftë se ka raste të
15 tjera që mund të identifikoj të lidhura me këtë?

16 DËSHMITARI: Po. Ka pasur, gjithashtu edhe shumë shkelje
17 të tjera gjatë asaj kohe të dokumentuara, të raportuara, të
18 shkruara nga burime të shumta.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
20 çaktivizuar].

21 Po ju pyesja në qoftë se ka pasur raste të tjera.

22 Ndërkohë që z. Tieger do vazhdojë me pyetjet e veta.

23 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, po e
24 parashikova këtë përpara sesa të hynte dëshmitari në sallën e
25 gjyqit. Në qoftë se do të dëgjojmë këto lloj dëshmish, do të

1 duhet që të përcaktohet baza, pra, duhet që të përcaktohet se
2 ku është baza mbi të cilin e mbështet dëshmitari, jo çfarë
3 mendon thjesht dëshmitari, çfarë opinionit ka dëshmitari.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Prandaj edhe
5 e ndërpreva dëshmitarin. Desha që z. Tieger të vazhdojë dhe ta
6 bëjë pikërisht këtë që po thoni ju z. Emmerson.

7 Z. TIEGER: [Përkthim]

8 PY. Pyetja e parë. Dhe do të përpiqem që të parashtroj bazën
9 sikurse më është kërkuar.

10 Ju përmendët shkeljet që ishin kryer në atë kohë dhe për
11 të cilat ju mësuat. Dhe do t'ju kthehem atyre. Ndër to ishin
12 edhe shkeljet e kryera nga UÇK-ja e cila vinte në shënjestër
13 njerëzit që përpiqeshin të jepnin informacion lidhur me
14 shkeljet e pretenduara të UÇK-së.

15 Z. EMMERSON: [Përkthim] Kërkoj ndjesë që po e ndërprej,
16 por kjo nuk është mënyra sesi të vazhdohet me pyetjet e
17 drejtpërdrejta për këtë dëshmitar.

18 Dëshmitari tha që kishte krijuar përshtypjen se disa
19 njerëz me të cilët kishte biseduar nuk kishin dëshirë apo
20 hezitonin që të bashkëpunonin për shkak të frikës.

21 Dhe tani kemi një pyetje ku thuhet se: Njerëzit kishin
22 frikë nga hakmarrjet, diçka që s'e ka përmendur dëshmitari.
23 Kjo duhet të vlerësohet nga dëshmitari.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitari
25 tha që ka intervistuar me qindra, qindra dëshmitarë dhe se mbi

1 dëshmitë e tyre mund të mbështet.

2 Z. EMMERSON: [Përkthim] Por jo në lidhje me krimet e UÇK-
3 së. Ai kishte intervistuar me qindra dëshmitar të cilat
4 kryesisht përqendroheshin në krimet e kryera nga autoritet
5 serbe.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni, z.
7 Tieger.

8 Z. TIEGER: [Përkthim] Mendoj që kjo po ndërlikohet pa
9 nevojë. Do t'i kthehem dëshmitarit me një pyetje tjetër për të
10 krijuar bazën për pyetjen që do të vijoj.

11 PY. Dëshmitar, a keni dëgju për termin bashkëpunëtor,
12 kolaboracionist?

13 PË. Po.

14 PY. Po si e mësuar apo hasët në këtë term, nëpërmjet cilave
15 burime?

16 PË. Nga vizita ime e parë në Kosovë në vitin 1996. Kur bëra
17 hetimin e parë të Human Right Watch. Nga ajo kohë tashmë
18 ekzistonte një nocion i asaj që shqiptarët e quajnë shqiptarë
19 të ndershëm dhe të pandershëm.

20 Kështu, për shembull, shqiptarë kosovarë që punonin për
21 shtetin, nga bisedimet që kisha në atë kohë me njerëz që i
22 kisha intervistuar më parë, po edhe nga komunikimet jo formale
23 që i bëja në atë kohë, këta njerëz konsideroheshin si të
24 pandershëm.

25 Në krye të këtyre ishin njerëzit që ishin në shërbimit në

1 polici, shqiptarë etnik që punonin për policinë, por
2 gjithashtu edhe nëpër universitete, universitete që
3 dominoheshin nga shteti, ku gjuha shqipe ishte e ndaluar dhe
4 të cilët nuk punonin në instancat paralele që kishin krijuar
5 shqiptarët. Dhe këta njerëz dyshoheshin në atë kohë dhe me
6 kalimin e konfliktit me intensifikimin e konfliktit ky aspekt
7 u bë edhe më intensivë. Mendoj që termi kolaboracionist,
8 bashkëpunëtor, përdorej për t'i kundërshtuar apo për t'i
9 etiketuar njerëzit. Në vitin 1998 dëgjohej më shpesh si term.
10 Me këtë term kundërshtoheshin njerëzit që e vinin në
11 pikëpyetje kryengritjen e armatosur.

12 PY. Na jepni sa të mundeni informacion por përsëri na thoni
13 se mbas të çkahit e krijuat këtë mendim se kjo përdorej për
14 njerëz që pretendohet se ishin bashkëpunëtorë?

15 Z. EMMERSON: [Përkthim] Që mendoheshin prej kujt dhe për
16 çfarë qëllimi? Në qoftë se dëshmitari po përpiqet që t'i
17 atribuojë disa elemente të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës
18 këtij definicioni atëherë duhet të sqarojë pozitën e vetë.

19 Mirëpo në qoftë se është kjo në terma të përgjithshëm
20 atëherë vetëm që po ia marrim kot kohën Gjykatës.

21 Z. TIEGER: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, më lejoni që
22 ta bëj pyetjen.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtimi
24 i z. Emmerson hidhet poshtë.

25 Vazhdoni, z. Tieger.

1 Z. TIEGER: [Përkthim]

2 PY. Dëshmitar, në atë kohë a keni marrë informacion, pra
3 gjatë asaj periudhe të kohës në qoftë se UÇK-ja i etiketonte
4 apo i shënjestronte njerëzit si bashkëpunëtor?

5 PË. Po.

6 PY. Nga çfarë burimesh dhe mbi çfarë informacioni?

7 PË. Njërin prej burimeve ishin ndërkombëtarët që po punonin
8 në Kosovë në atë kohë. Vetëm të jem i qartë për cilën periudhë
9 kohore e keni fjalën?

10 PY. E kam fjalën për periudhën 1998, 1999.

11 PË. Në rregull. Sepse nëse flasim për 1999, periudhën mbas
12 qershorit apo para qershorit, se ka një dallim.

13 PY. Ju e bëtë këtë dallim dhe mund të na e shpjegoni.

14 PË. Në qoftë se flasim për periudhën mbas qershorit të vitit
15 1999, një prej burimeve të këtij informacioni ishin
16 ndërkombëtarët që punonin për Kombet e Bashkuara madje edhe
17 KFOR-i, Forcat NATO-s ose OSBE-ja, të tre këto organizata
18 kishin një prani të madhe nëpër gjithë Kosovën në atë kohë.
19 Dhe ne kishim kontakte me individë, persona, të cilët bënë
20 vëzhgimin, monitorimin e situatës me të drejtat e njeriut dhe
21 këtë informacion e ndanin me ne. Dhe raportimet e tyre kishin
22 të bëjnë me ata persona që ishin synuar për shkak të
23 pretendimit për bashkëpunim.

24 Gjatë periudhës përpara qershorit, burimi kryesor i
25 informacionit kanë qenë përsëri ndërkombëtarët. Por kam

1 zhvillu në atë kohë biseda edhe me organizata tjera për të
2 drejtat e njeriut të cilët e bënë këtë punë. Në këtë kuadër
3 do ta kisha përmendur Qendrën e të Drejtës Humanitare, që
4 ishte me seli në Beograd si organizatë dhe e cila i
5 dokumentonte këto raste duke i intervistuar personat e ndryshëm.
6 Dhe ne, si organizatë, gjithashtu, kemi intervistuar anëtarë të
7 familjes të cilët pretendonin se anëtarë të familjeve tyre
8 ishin rrëmbyer apo ishin shenjësuar për shkak se ishin
9 perceptuar si bashkëpunëtorë.

10 Z. EMMERSON: [Përkthim] Me përjashtim të fjalisë së
11 fundit, ajo që e përshkruajti dëshmitari në përgjigjen e
12 fundit ishte është thjesht jehonë e të gjitha organizatave
13 ndërkombëtare që e kanë përshkruar punën e tyre në atë kohë në
14 Kosovë. Pyetja është: Sesi ky dëshmitar e dinë këtë?

15 Nuk mund të hetosh një person që jep deklaratën pa e
16 ditur se kush është ai person dhe mbi çfarë bazash jep atë
17 informacion. Më vjen shumë keq që po ndërhyjë dhe është shumë
18 e qartë mënyra sesi e ka përgatitur z. Tieger këtë dëshmitar
19 dhe mënyra sesi i bën pyetjet. Me këtë ai po i shkel të gjitha
20 parimet që ju si Trup Gjykesues i keni caktuar.

21 Jemi në një situatë kur kemi ndëgjuar këto dëshmi dhe aty
22 kemi vetëm një segment të vogël kur thuhet se janë intervistuar
23 anëtarë të familjes, këto janë përshtypje të përgjithshme. Nuk
24 është dëshmi me plot kuptimin e fjalës.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Emerson,

1 të gjithë personat apo organizatat që u i përmendni nuk i kanë
2 ndalu këta njerëz për t'ju thënë mos jeni deklaratat, por kanë
3 bë punën që për të bë një farë vlerësimi të mirëfilltë dhe për
4 t'ia dhënë peshën e duhur dëshmime të tyre. Ju padyshim që
5 mund t'i bëni pyetje këtij dëshmitari dhe sigurisht që e dini
6 se ne do t'ia japim peshën e duhur ashtu siç mendojmë ne
7 dëshmisë së këtij dëshmitari.

8 Z. EMMERSON: [Përkthim] Më falni që po insistoj në lidhje
9 me këtë aspekt, mirëpo në një gjykim tjetër Trupi Gjykses, në
10 fakt, në gjyqin e Milutinovic refuzoi që ta pranonte një
11 dëshmi të këtillë. Ne thjesht po dëgjojnë pyetje të cilat janë
12 të dizajnuara në një mënyrë që të nxjerrin dëshmi të
13 papranueshme.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po dëgjojmë
15 pyetje me të cilat po parashtrohet baza e dijenisë së këtij
16 dëshmitari.

17 Po, z. Kehoe.

18 Z. KEHOE: [Përkthim] Unë thjesht dua që për
19 procesverbalin të regjistrohet kundërshtimi im. Unë pajtohem
20 me kolegun tim.

21 Z. TIEGER: [Përkthim] Nuk është ky kundërshtim. Por është
22 thjesht një argument. Dhe unë do të përgjigjem me një
23 kundërarargument dhe do të kaloj tek pyetjet e mia për
24 dëshmitarin

25 PY. Dëshmitar, a erdhi ndonjë moment kur ju mësuat për

1 ndalimet nga ana e UÇK-së të dy gazetarëve të Tanjug-ut?

2 PË. Po.

3 PY. A ju kujtohet se ku ndodhi kjo?

4 PË. Dikund në nëntor apo tetor të 1998.

5 PY. Po ju apo ndonjë përfaqësues tjetër i Human Right Watch a
6 u angazhua, a bëtë përpjekje për të konfirmuar në qoftë se
7 këta gazetarë ishin në fakt marrë e ndaluar nga UÇK-ja?

8 PË. Po.

9 PY. A ju kujtohet se çfarë bëtë ju?

10 PË. Po. Mesa më kujtohet ndërmorëm dy hapa. Hapi i parë ishte
11 që të konsultohemi me Kryqin e Kuq Ndërkombëtar i cili na
12 konfirmoi se kishte dijeni për ndalimin. Dhe gjithashtu e
13 ngritëm këtë çështje me z. Demaçi në Prishtinë.

14 Z. TIEGER: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dua që të
15 paraqes provën materiale IT-03-66 P212.7.

16 PY. Dëshmitar, besoj që në ekran e shihni një dokument me
17 titullin "Dënohet ndalimi i gazetarëve serbë" më datë tetor
18 1998 dhe fillon me fjalët:

19 "Human Right Watch ka shprehë shqetësimet e veta të
20 mëdhaja në lidhje me ndalimin e gazetarëve serbë nga grupi i
21 armatosur që lufton për pavarësinë e Kosovës, Ushtria
22 Çlirimtare e Kosovës".

23 A më ndiqni?

24 PË. Po.

25 PY. Pastaj në paragrafin e tretë që është më i shkurtër

1 thuhet se:

2 "Përfaqësuesi politik i UÇK-së, Adem Demaçi, Komiteti
3 Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, kanë konfirmuar se dy personat
4 mbahen nga UÇK-ja".

5 A është kjo referencë pra, konfirmimin që bëtë ju si
6 organizatë Human Right Watch në lidhje me ndalimin e këtyre
7 personave?

8 PË. Po.

9 PY. Dhe ky dokument është lëshuar nga Human Right Watch?

10 PË. Po, ky është një njoftim për shtypin.

11 PY. Paragrafi i fundit në faqen e parë, thotë se:

12 "Këta dy persona nuk janë gazetarët e parë që janë marrë
13 nga UÇK-ja. Por afër Rahovecit, një punonjës i Radio
14 Prishtinës dhe shoferi i tij Ranko Perinic, gjithashtu u morën
15 nga UÇK-ja".

16 Po ky rast i dytë që përmendet në këtë njoftim për shtyp,
17 a është shprehje e shqetësimeve të Human Right Watch në lidhje
18 me ndalimin edhe të gazetarëve të Tanjug?

19 PË. Po. Dhe ky rasti i z. Slavuj dhe Perinic zmadhoi dhe ma
20 shumë shqetësimet e tona.

21 Z. TIEGER: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që këtë
22 dokument ta paraqes si provë.

23 Z. KEHOE: [Përkthim] Kundërshtim.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] IT-03-66
25 pranohet si provë. T'i jepet numri ju lutem.

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Numri i provës që do
2 t'i jepet është P375.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

4 Z. TIEGER: [Përkthim] A mund ta shfaqim dokumentin P300
5 tani. Besoj se është i renditur, të paktën një prej
6 dokumenteve në P341 që është numri që ka pasur përpara se të
7 ndërroheshin numrat. P300 është dokumenti që duam ne.
8 PY. Z. Dëshmitar, këtu në ekran shihet një dokument me
9 titullin "Drejtoria e policisë ushtarake dhe Ushtria
10 Çlirimtare e Kosovës për mediat, Deklaratë numër 3, Kumtesë
11 numër 3". Ju kërkoj që t'i hidhni një shikim të shpejtë.

12 Këtu deklaron që:

13 "Të dielën më 18 tetor të këtij viti rreth orës 15.00,
14 patrulla e policisë ushtarake e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës
15 ka hasur në veturën e tipit Yugo Florida me regjistrimin të
16 Beogradit ... pa shenja të 'Press' me shofer dhe bashkudhëtar
17 Vladimir Dobricic, Nebojsa Radosevic".

18 Shpjegon që u është bërë shenjë që të ndalojnë. Janë
19 ndaluar me vonesë, duke u munduar pastaj të fshehin
20 identitetin e tyre, ka ngritur dyshime kjo për identitetin e
21 tyre. Dhe kjo ka bërë që të dyshohet në identitetin e tyre ose
22 mos ndoshta nuk janë gazetarë dhe qëllimi i ardhjes së tyre
23 është spiunazh dhe janë ndaluar dhe u caktua paraburgim me
24 qëllim që të hetohet arsyeja e saktë dhe qëllimi i udhëtimit
25 të tyre.

1 Në fund, siç e shihni, data 29 tetor 1998, Zëri i
2 Kosovës.

3 Së pari, Dëshmitar, a ju kujtohet, a e keni parë këtë
4 dokument në atë kohë?

5 PË. Më kujtohet dokumenti, më kujtohet që e kam parë atë. Nuk
6 jam në gjendje t'ju them kur saktësisht e kam parë atë.

7 PY. Informacioni në këtë dokument a ishte, përputhej me
8 informacionet apo nuk përputhej me informacionet që ju kishit
9 në atë kohë për qëndrimin e UÇK-së lidhur me këtë ndalim?

10 PË. Tani nuk jam i sigurtë sepse nuk më kujtohet saktësisht
11 kur e kam parë këtë kumtesë. Nuk më kujtohet si e kam
12 interpretuar në atë kohë, por duke e lexuar tani është në
13 përputhje me atë që unë di për këtë rast.

14 PY. Ju shpjeguat që një prej mënyrave në bazë të cilave keni
15 konfirmuar që UÇK-ja i mbante të ndaluar këta gazetarë ishte
16 përmes Adem Demaçit, e saktë?

17 PË. E saktë.

18 PY. A mund të na thoni kush ishte Adem Demaçi?

19 PË. Ai ishte figurë e rëndësishme në shoqërinë shqiptare të
20 Kosovës. Aktivist i të drejtave të njeriut shumë i njohur dhe
21 i respektuar, kishte kaluar shumë vite në burgjet jugosllave
22 si i burgosur politik. Besoj që, por duhet ta konfirmoj këtë,
23 besoj që edhe janë dhënë medalje, është nderuar nga Human
24 Right Watch përpara aktiviteteve të tija të fundit.

25 Pra, e njohim, e kam njohur edhe personalisht. Kisha

1 respekt për të. Kam shkuar e kam takuar jo vetëm për këtë
2 çështje, por edhe për arsye të tjera, arsye tjera për të cilat
3 e kam takuar dhe kam biseduar me të.

4 PY. Pse e keni kontaktuar atë dhe si e keni kuptuar dhe cili
5 ishte qëndrimi i tij lidhur me këtë?

6 PË. Në atë kohë, z. Demaçi ishte emëruar, më duket, që
7 titulli ka qenë përfaqësues politik. Megjithatë nuk jam i
8 sigurt për titullin zyrtar. Por ka vepruar në Prishtinë,
9 kishte një prani publike në Prishtinë, bisedonte, komunikonte
10 me mediat dhe ndërvepronte me organizata, siç është edhe
11 organizata të cilës i përkisja unë.

12 PY. Kur shkuat ta takonit, a kuptove qëndrimin e tij,
13 pozicionin e tij për sa i përket autoritetit brenda UÇK-së?

14 PË. Po.

15 Z. KEHOE: [Përkthim] Kundërshtim. Kjo është pyetje për të
16 cilën duhet të parashtrohet baza për sa i përket pozicionit të
17 pozitës së z. Demaçi.

18 Z. TIEGER: [Përkthim]

19 PY. Përpara se të na jepni këtë mendim, në çfarë e bazonit
20 këtë mendim?

21 PË. Po. Janë disa faktorë. Një element i rëndësishëm ishte
22 fakti se z. Demaçi lejohej të vepronte në Prishtinë nga
23 autoritet serbe pra dhe kjo në mënyrë publike. Unë menjëherë e
24 interpretova dhe e kuptova që këtë që ndikimi i tij me krahun
25 e armatosur dhe ata që ishin të angazhuar në veprime

1 armiqësore ishte i kufizuar sepse nuk mendoja në atë kohë që
2 shteti serb dhe forcat e tij të fuqishme dhe aq abuzuese do ta
3 kishin toleruar aktivitete të hapura të ndonjë anëtari,
4 pjesëtari të UÇK-së që ishte angazhuar në luftë të armatosur.

5 Dhe gjithashtu kuptova profilin e z. Demaçi në shoqërinë
6 shqiptare të Kosovës që ishte i bazuar në respekt për mendimet
7 e tija të thëna qartazi dhe vuajtjet që ai kishte pësuar për
8 shkak të shprehjes së këtyre mendimeve, përmes shumë viteve të
9 kaluara në burg. Pra, ai kishte një autoritet të lartë moral
10 në shoqëri.

11 Njëkohësisht, kam besuar gjithmonë, bazuar në njohuritë e
12 mia të situatës, se ndikimi i tij në vendimmarrje ishte i
13 kufizuar. Edhe këtu, të kthehemi tek pika e parë, dikush që
14 kishte lidhje të drejtpërdrejta me luftën e armatosur nuk do
15 të ishte toleruar aty, do të ishte ndjekur penalisht dhe me
16 siguri do të ishte dhe keqtrajtuar, por gjithsesi nuk do të
17 ishte lejuar të vepronte aty.

18 PY. A keni patur bisedime me z. Adem Demaçi pas emërimit në
19 këtë pozitë në lidhje me UÇK-në?

20 PË. Mund ta përsërisni këtë?

21 PY. A keni patur bisedime me z. Demaçi pas emërimit të tij
22 lidhur me atë që ai bënte, cili ishte roli i tij?

23 PË. Po. Sigurisht. Kam qenë aty, kam shku tek ai të paktën
24 një herë, jo shpesh, jo rregullisht. Nuk më kujtohen hollësitë
25 e bisedave tona. Por më kujtohet që në këtë rast ai pohoi

1 mbajtjen në ndalin.

2 PY. Gjatë bisedave të pakta që keni patur me z. Demaçi a ju
3 ka thënë ai ndonjëherë ndonjë gjë juve që ju ka bërë të
4 mendoni ndryshe nga ajo që thatë më parë, domethënë, që kishte
5 autoritet të kufizuar?

6 PË. Jo. Jam larguar gjithmonë nga këto biseda me bindjen se
7 ndikimi i tij tek ata që ishin të angazhuar në luftën e
8 armatosur ishte i kufizuar.

9 PY. Pasi që pohuat që gazetarët ishin të ndaluar në ndalim
10 nga UÇK-ja, a kërkoi Human Right Watch u përpoq të bënte diçka
11 më shumë lidhur me këtë gjendje situatë?

12 PË. Po. Kërkuam takim me përfaqësues të UÇK-së për të
13 diskutuar këtë mes çështjeve të tjera.

14 PY. Së pari, kujt ia drejtuat këtë kërkesë për takim, që të
15 takoheshit?

16 PË. Ne kërkuam të takoheshim me individë të cilët duhet të
17 ishin të përgjegjës apo të autorizuar të bisedonim për çështje
18 që kishin të bënin me të drejtat e njeriut dhe ligjin
19 humanitar ndërkombëtar. Nuk kemi bërë kërkesë që të bisedojmë
20 me dikë në veçanti.

21 PY. Kujt ia drejtuat këtë kërkesë apo si u përpoqët ta
22 organizonit këtë?

23 PË. Përmes një ndërmjetësi të cilin e njihnim në Kosovë.

24 PY. A patët sukses në organizimin e këtij takimi me
25 përfaqësues të UÇK-së të cilët ishin të autorizuar për të

1 folur për këtë ndalim?

2 PË. Po.

3 PY. U bë ky takim?

4 PË. Po.

5 PY. Dhe ku u bë ky takim?

6 PË. Ku ishte takimi?

7 PY. Po.

8 PË. Tani takimi u bë në nëntor. Besoj që ka qenë më 10
9 nëntor. Në atë kohë nuk e dija saktësisht ku u bë. Neve na u
10 kërkua, u udhëzua që të shkonim me makinë në një zonë, besoj
11 që ishte afër Malishevës, Malishevën shqip, ku u takuam, u
12 shoqëruam pastaj, na shoqëruan në një që unë e përshkruaj si
13 fermë të cilën më vonë mësova që ishte në një fshat që quhej
14 Banja, po në atë kohë nuk e dija.

15 PY. Po ju thatë "ne". Me kë ishit juve?

16 PË. Me kolegun tim Peter Bouckaert.

17 PY. Dhe kur në momentin që arritët në atë vend a ishit ju të
18 parët që arritët apo përfaqësuesit e UÇK-së ishin aty?

19 PË. Ne ishim të parët, arritëm të parët. Pritëm për një kohë
20 të shkurtër.

21 PY. Kur erdhën përfaqësuesit e UÇK-së a u prezantuan ata?

22 PË. Po, por e bënë këtë pasi hymë në fermë u ulëm, pimë çaj
23 dhe pastaj filluam bisedën.

24 PY. Në çfarë gjuhe u zhvillua takimi?

25 PË. Në shqip.

1 PY. A kishit përkthyes me vete?

2 PË. Po.

3 PY. Kur erdhën përfaqësuesit e UÇK-së, po e përsëris pyetjen
4 po a u prezantuan?

5 PË. Po.

6 PY. Si u prezantuan?

7 PË. Njëri besoj zëdhënësi kryesor aty ishte z. Hashim Thaçi,
8 që ishte përfaqësuesi politik i Shtabi i Përgjithshëm. Dhe
9 zotëria tjetër që u prezantua me nofkën e tij të luftës
10 komandant Çeliku.

11 PY. E zbulove pastaj gjatë takimit se kush ishte emri i
12 vërtetë i komandant Çelikut?

13 PË. Po.

14 PY. Si ishte emri i tij?

15 PË. Emri Fatmir Limaj.

16 Z. TIEGER: [Përkthim] Z. Gjykatës, po konstatoj kohën.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të
18 përfundojmë seancën këtu. Vazhdojmë nesër në orën 9.00 të
19 mëngjesit. Faleminderit për pjesëmarrjen sot. Ju kujtoj që nuk
20 jeni të lejuar të flisni për këtë jashtë sallës së gjyqit.
21 Sekretarja do t'ju shoqërojë jashtë. Shihemi nesër.

22 DËSHMITARI: Faleminderit.

23 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Seanca
25 ndërpritet deri nesër në orën 9.00 në mëngjesit.

1 --- Seanca mbyllet në orën 16.02

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25